



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
**Opština Orahovac/Municipality Rahovec**  
**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**



**01 Nr. 04/21**  
**Rahovec, 21.04.2021**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më  
**29 prill 2021 (e enjte )** me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

**R E N D D I T E**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i Raportit finansiar janar – mars 2021;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për bartjen e rezervave të investimeve kapitale të vitit 2021;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënen e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 05864-0 Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënen e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 07111-1 Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënen e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 02352-0 Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënen e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P-00251-0 Çifllak;
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për vënie në debat publik të Draft Strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal për Komunën e Rahovecit 2021 – 2025;
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2020;



2021



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E RAHOVECIT

# DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E RAHOVECIT 2021-2025

Shkurt, 2021





# DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL

## 2021-2025

Shkurt, 2021



Përgatitja e këtij dokumenti është bërë nga ALBO GROUP në partneritet dhe financuar nga Komuna e Rahovecit

Autoriteti kontraktues: Komuna e Rahovecit

Hartoi: ALBO GROUP

Kontribuesit:





# PËRMBAJTJA

---

Listat e tabelave .....	ix
Listat e grafikëve .....	x
Listat e figurave .....	xi
Listat e shkurtesave.....	xii
<i>Hyrje</i> .....	13
1. Metodologjia .....	15
2. Analiza e gjendjes aktuale dhe sfidat.....	17
Pozita dhe veçoritë gjeografike .....	17
Popullsia .....	18
Vendbanimet.....	22
Migrimi .....	26
Arsimi.....	27
Shëndetësia.....	31
Mirëqenia sociale .....	33
Tregu i punës.....	36
Shërbimet administrative .....	37
Infrastruktura.....	37
Telekomunikacioni .....	40
Rrjeti energjetik.....	43
Ndriçimi publik.....	43
Furnizimi me ujë.....	44
Kanalizimi .....	45
Mbeturinat.....	46
Kultura .....	47
Profili ekonomik i komunës së Rahovecit.....	48
Buxheti komunal .....	56
3. Analiza SWOT .....	60
4. Vizioni, qëllimet dhe objektivat për zhvillim ekonomik.....	62

Vizioni, misioni dhe vlerat kyçë .....	62
Qëllimet strategjike dhe objektivat specifike .....	64
Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të strategjisë.....	73
Ndikimi finansiar i zbatimit të strategjisë .....	73
<i>Shtoja 1</i> .....	74
<i>Shtoja 2</i> .....	86
<i>Shtoja 3</i> .....	87

## **Lista e tabelave**

---

<b>Tabela 1.</b> Popullsia e komunës së Rahovecit sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare.....	23
<b>Tabela 2.</b> Klasifikimi i vendbanimeve në komunën e Rahovecit sipas kategorizimit në figurën 4a .....	24
<b>Tabela 3a.</b> Migrimi kombëtar në komunën e Rahovecit, periudha 2017-2019.....	26
<b>Tabela 3b.</b> Migrimi ndërkombëtar në komunën e Rahovecit, periudha 2017-2019 .....	26
<b>Tabela 4.</b> Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe shuara sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike, 2019 .....	50
<b>Tabela 5.</b> Burimet e financimit në komunën e Rahovecit (€), periudha 2021-2023.....	57
<b>Tabela 6.</b> Struktura e të hyrave vetanake në komunën e Rahovecit (€), viti 2020 .....	58
<b>Tabela 7.</b> Struktura e shpenzimeve buxhetore në komunën e Rahovecit (€), viti 2020.....	59

# **Lista e grafikëve**

---

<b>Grafiku 1.</b> Popullsia në komunën e Rahovecit sipas regjistrimeve, periudha 1948- 2011 .....	19
<b>Grafiku 2.</b> Shtimi natyror në komunën e Rahovecit, periudha 2017-2019.....	20
<b>Grafiku 3.</b> Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Rahovecit.....	20
<b>Grafiku 4.</b> Struktura etnike e popullsisë në komunën e Rahovecit.....	21
<b>Grafiku 5.</b> Struktura religioze e popullsisë në komunën e Rahovecit .....	21
<b>Grafiku 6.</b> Struktura moshore e popullsisë në komunën e Rahovecit .....	22
<b>Grafiku 7.</b> Kategorizimi i vendbanimeve në komunën e Rahovecit .....	24
<b>Grafiku 8.</b> Regjistrimi i popullsisë sipas vendbanimeve, 1948-2011 .....	25
<b>Grafiku 9.</b> Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2017-2020 .....	29
<b>Grafiku 10.</b> Krahasim i numrit të vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas kategorive, 2018-2019 .....	33
<b>Grafiku 11.</b> Statistikat e tregut të punës, 2019 .....	36
<b>Grafiku 12.</b> Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit .....	38
<b>Grafiku 13.</b> Ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet në komunën e Rahovecit.....	42
<b>Grafiku 14.</b> Furnizimi me ujë në komunën e Rahovecit .....	44
<b>Grafiku 15.</b> Qasja në sistem të kanalizimit në komunën e Rahovecit .....	45
<b>Grafiku 16.</b> Shfrytëzimi i tokës (%) në komunën Rahovecit .....	48
<b>Grafiku 17.</b> Numri i ndërmarrjeve të regjistruara për periudhën 2000-2018, në komunën e Rahovecit .....	50
<b>Grafiku 18.</b> Vreshtat sipas kategorisë në Komunën e Rahovecit .....	53
<b>Grafiku 19.</b> Sipërfaqja e tërësishme pyjore sipas kategorive në komunën e Rahovecit.....	55
<b>Grafiku 20.</b> Mesatarja e burimeve të financimit në komunën e Rahovecit (%), periudha 2021-2023 .....	57
<b>Grafiku 21.</b> Struktura e shpenzimeve në komunën e Rahovecit (%), viti 2020 .....	59

---

## **Lista e figurave**

---

<b>Figura 1.</b> Struktura e përmbledhur organizative e komunës së Rahovecit .....	12
<b>Figura 2.</b> Metodologjia e punës.....	15
<b>Figura 3.</b> Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit .....	17
<b>Figura 4.</b> Pamje e qytetit të Rahovecit .....	23
<b>Figura 5.</b> Sahat Kulla, Rahovec .....	47

## **Lista e shkurtesave**

---

<b>AMF</b>	Ambulanca të Mjekësisë Familjare
<b>AMMK</b>	Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës
<b>ART</b>	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>Ha</b>	Hektarë
<b>KABK</b>	Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale
<b>km</b>	Kilometër
<b>KMDK</b>	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
<b>KRU</b>	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
<b>kv</b>	Kilovat
<b>m</b>	Metër
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim – Asocimit
<b>NVM</b>	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
<b>PSAK</b>	Planit Strategjik i Arsimit në Kosovë
<b>QKMF</b>	Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare
<b>QMF</b>	Qendër e Mjekësisë Familjare
<b>QPS</b>	Qendra për Punë Sociale
<b>SWOT</b>	<b>Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats</b>
<b>SZHEL</b>	Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal
<b>TM</b>	Tremujor



## Fjala e kryetarit


---

\*Opcionale



# Struktura organizative e komunës së Rahovecit

Fig. 1 Struktura e përbledhur organizative e komunës së Rahovecit\*



\* Strukturën e detajuar organizative e gjeni në shtojcën 2.



## Hyrje

Pa dyshim, komunitetet preken mjaft shumë nga çështjet makro-ekonomike të globalizimit, decentralizimit dhe liberalizimit të tregut. Këto çështje makro-ekonomike ofrojnë mundësi si dhe sfida, veçanërisht për komunat më të vogla dhe më të varfra.

Sidoqoftë, udhëheqësit komunalë duhet të kuptojnë ndikimin që këto çështje mund të kenë në mikro-ekonomitë, ose përpjekjet e zhvillimit ekonomik lokal, si dhe se cilat politika dhe strategji janë të mundshme për të drejtuar zhvillimin ekonomik në nivelin lokal. Ndryshimi më i madh mund të bëhet në nivelin lokal për të adresuar sfidat makro dhe mikro dhe të arrihen rezultate të menjëhershme. Andaj, qëllimet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal janë: krijimi i pasurisë, përkrahja e NVM-ve ekzistuese dhe atyre të reja, gjenerimi i vendeve të reja të punës, rritja e eksportit, rritja e të ardhurave dhe rrjedhimisht zvogëlimi i varfërisë dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët e saj.

Ky plan strategjik është hartuar bazuar në dokumentin udhëzues “Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023” përgatitur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Qeverisja lokale, e cila tani po kalon në vetëqeverisje me tendenca konsolidimit të autonomisë lokale për komunat dhe thellimit të reformave në sistemin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, po hyn në fazën më të rëndësishme të funksionalizimit të saj. Në kuadër të strategjisë për vetëqeverisje lokale janë paraparë gjithsej 5 objektiva, e para nga to është *fuzionimi i rolit të komunave si akterë kryesorë në zhvillimin ekonomik lokal*<sup>1</sup>.

Plani strategjik për zhvillimin ekonomik lokal në komunën e Rahovecit (2021-2025) është korniza kryesore strategjike që drejton vendimmarrjen brenda komunës dhe ndihmon në përqendrimin e përpjekjeve të komunës për të bërë realitet vizionin e saj.

Rrjedhimisht, kjo përcakton një standard shumë të lartë të pritjeve dhe parametrave të qeverisjes brenda të cilave komuna duhet të ofrojë shërbime në mënyrë sa më efikase dhe efektive. Prandaj, të gjitha përpjekjet janë drejtuar drejt optimizimit të efikasitetit të biznesit, zhbllokimit të

<sup>1</sup> Strategjinë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 6.



potencialit të të ardhurave, shfrytëzimit të pikave të forta të kapitalit njerëzor për qeverisje efikase, arsim cilësor, mjedis të pastër, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, ambient të përshtatshëm për biznes dhe bujqësi të zhvilluar. E gjithë kjo synon ngritjen e cilësisë së jetesës në komunën e Rahovecit për një periudhë pesë-vjeçare.



# 1. METODOLOGJIA

Në procesin e hartimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal (tash e tutje mund ta gjeni si shkurtesë SZHEL) të komunës së Rahovecit për periudhën 2021-2025, janë përfshirë: sektori publik, më konkretisht zyrtarë të të gjitha drejtorive të komunës, pastaj bizneset dhe shoqëria civile. E gjithë kjo për të krijuar kushte më të mira për rritjen ekonomike dhe gjenerimin e punësimit në komunën e Rahovecit.

Andaj, qëllim parësor i kësaj strategjie është ndërtimi i kapacitetit ekonomik të komunës së Rahovecit për të përmirësuar të ardhmen e saj ekonomike dhe cilësinë e jetës për të gjithë. Rrjetimisht, të identifikojë resurset që posedon komuna e Rahovecit dhe shfrytëzimi i tyre për rritje ekonomike.

Po ashtu, SZHEL për komunën e Rahovecit përqendrohet në rritjen e konkurrencës, duke siguruar rritjen e qëndrueshme dhe që ajo të jetë gjithëpërfshirëse.

Ky dokument, po ashtu bazohet në politikat strategjike për zhvillim ekonomik lokal si:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021
- Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026
- Programin Kombëtar për Zbatim të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MS)
- Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) dhe
- Strategjitet e Veprimit në Nivel Lokal

Në vijim është përbledhur dhe paraqitur në mënyrë grafike metodologjia e punës përgjatë hartimit të SLEZH-it.

**Fig. 2 Metodologjia e punës**





Duhet theksuar se gjatë procesit të hartimit të kësaj strategjie, janë realizuar takime të rregullta pune me komunën e Rahovecit dhe institucione të tjera përkatëse. Në këtë mënyrë janë identifikuar akterët kryesorë nëpërmjet analizës përkatëse dhe përfaqësues nga ta janë përfshirë në ekip. Pastaj është bërë planifikimi i procesit të hartimit të SZHEL. Më tutje është vazhduar me mbledhjen e të dhënavë nga burimet dytësore mbi të dhënat gjeografike dhe demografike, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, tregun e punës, shërbimet administrative të komunës, infrastrukturën, telekomunikacionin, rrjetin energetik, furnizimin me ujë të pijshëm, kulturën dhe profilin ekonomik lokal të komunës së Rahovecit. Të dhëna të nevojshme plotësuese janë mbledhur edhe nëpërmjet burimeve parësore si intervistave të strukturuara dhe jo strukturuara si dhe nëpërmjet fokus grupeve.

Duke pasur për bazë rëndësinë e të këshilluarit me bizneset për mbledhjen e të dhënavë, jemi këshilluar me ta dhe kemi pranuar një perceptim të qartë të faktorëve lehtësues dhe pengues në të bërit biznes. Kjo gjë ka kontribuar që komuna të ketë një pasqyrë më të qartë të asaj që nevojitet për të inkurajuar rritjen e bizneseve. Rrjedhimisht është bërë vlerësimi ekonomik lokal dhe janë identifikuar forcat, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet (analiza SWOT).

Rezultatet e analizës SWOT janë përdorur për definimin e planit të SZHEL. Po ashtu, kanë ndihmuar në përcaktimin e vizionit dhe misionit, qëllimeve dhe objektivave të komunës së Rahovecit. Ato kanë ndihmuar edhe në hartimin e programeve dhe projekteve që do të maksimizojnë forcat, adresojnë dobësitë, përfitojnë nga mundësitë dhe zbutin rreziqet apo kërcënimet.

Në këtë fazë është përcaktuar edhe përparësia konkuruese e komunës së Rahovecit, si dhe janë identifikuar mundësitë për bashkëpunim.

Ky dokument ka kaluar procedurat e konsultimit paraprak dhe të konsultimit publik, sipas rregullave për hartimin e dokumenteve strategjike në Republikën e Kosovës.



## 2. ANALIZA E GJENDJES AKTUUALE DHE SFIDAT KRYESORE

Kjo pjesë prezanton informata mbi gjendjen aktuale demografike, sociale dhe ekonomike të komunës së Rahovecit. Më konkretisht, informata mbi pozitën dhe veçoritë gjeografike të komunës, popullsinë, migrimin, infrastrukturën, kulturën, arsimin dhe shëndetësinë. Më tutje shqyrton buxhetin komunal dhe vazhdon me profilin ekonomik të komunës.

**POZITA DHE VEIORITË GJEOGRAFIKE** - Komuna e Rahovecit shtrihet në regjionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Territori i kësaj komune zë një sipërfaqe prej 275.5 km<sup>2</sup>. Në veri kufizohet me komunën e Klinës me distancë rreth 45 km, ndërsa në verilindje kufizohet me komunën e Malishevës me rreth 16 km. Në juglindje kufizohet me komunën e Suharekës me rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në jug me komunën e Prizrenit 25 km, dhe në perëndim me komunën e Gjakovës 28 km. Ka një largësi rreth 60 km nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina.

Ka lidhje të mira komunikative në mes komunave. Në lindje të komunës së Rahovecit kalon magjistralja Prizren - Pejë dhe hekurudha Prizren - Pejë.

**Fig. 3** Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit



Territori i komunës së Rahovecit shtrihet në hemisferën në mesë shkallës 42° e 30' dhe 42° e 50' të gjerësia gjeografike veriore dhe ndërmjet 20° e 21' dhe 20° e 55' të gjatësisë gjeografike lindore.

Vendbanimet në komunën e Rahovecit shtrihen në lartësitë mbidetare prej 310 metra Krusha e Madhe deri në 920 metra lartësi mbidetare Zatriqi. Për kah lartësia mbidetare këto vendbanime ndahan në lugino-rezervorë, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lugina ose rrafshina (310 – 350 m.) janë këto: Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Ratkoci, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m. dhe që i



takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë: Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastasella, Palluzha, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterusha, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Baboci, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshinave). Vendbanimet malore shtrihen në lartësitë mbidetare prej 600 – 1,000 m. Ato janë: Zatriqi, Kazniku dhe Drenoci.<sup>2</sup>

**Klima:** Temperaturat mesatare vjetore në komunën e Rahovecit janë  $11.68^{\circ}\text{C}$ . Temperaturat më të larta arrihen në muajin korrik, diku rreth  $38.5^{\circ}\text{C}$ . Ndërsa, temperaturat më të ulëta në muajin shkurt,  $-14.5^{\circ}\text{C}$ .

Reshjet mesatare në këtë komunë janë 707.7 mm. Sa i përket reshjeve maksimale ato arrijnë 1,047.2 mm, ndërsa ato minimale sillen rreth 609.9 mm. Muaji janar shquhet me të reshura më të mëdha të dëborës. Mesatarisht janë 15.7 ditë me bore në komunën e Rahovecit. Ndërsa, mesatarja vjetore me mjegull sillet prej 19.7 ditë apo 5.4 %.

Në komunën e Rahovecit erërat më së shpeshti fyejnë prej verilindjes (62 %), pastaj prej perëndimit (50%), nga lindja (17%), nga jugu (14 %). Ndërsa, më së paku fryjnë nga veriu (11.8%), dhe juglindja (4%).

Komuna e Rahovecit është nën ndikimin e klimës mesdhetare e cila depërtón përmes luginës së lumit Drini i Bardhë. Andaj, klima është mjaft e butë dhe nuk ka ndryshime ekstreme në temperaturën e ajrit gjatë vitit.<sup>3</sup>


**POPULLSIA** - Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, komuna e Rahovecit ka gjithsej **56,208 banorë**. Rezultatet e regjistrimeve të popullsisë në këtë komunë për periudhën 1948-2011 janë paraqitur në grafikonin 1.

Sic shihet në grafikun në vijim, që nga viti 1948 e deri më sot komuna e Rahovecit ka pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë. Konkrektisht prej vitit 1948 deri në vitin 2011, kemi pothuajse trefishim të popullsisë në këtë komunë.<sup>4</sup>



<sup>2</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq.12.

<sup>3</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2011, fq. 71.

**Graf. 1** Popullsia në komunën e Rahovecit sipas regjistrimeve, periudha 1948-2011

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Popullsia sipas vendbanimeve në komunën e Rahovecit, 1948-2011*.

**Dendësia:** Në komunën e Rahovecit dendësia e popullsisë është rreth 204 banorë në 1 km<sup>2</sup>, bazuar në popullsinë totale të regjistruar në vitin 2011 (56,208 banorë) dhe sipërfaqen e territorit të saj (275.5 km<sup>2</sup>). Ekzistojnë dallime për sa i përket dendësisë së popullsisë sipas vendbanimeve. Në vendbanimet që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia e popullsisë është më e madhe, ndërsa në vendbanimet që kanë numër më të vogël të popullsisë, edhe dendësia e popullsisë është më e vogël. Dendësi më e madhe kanë: Krusha e Madhe (447 banorë/km<sup>2</sup>), Nushpali (344 banorë/km<sup>2</sup>), Celina (333 banorë/km<sup>2</sup>), Rahoveci (328 banorë/km<sup>2</sup>) etj. Ndërsa, dendësi më të vogël kanë vendbanimet: Saroshi (1 banor/km<sup>2</sup>), Bërnjaku (9 banorë/km<sup>2</sup>)<sup>5</sup>, Hoça e Madhe (9 banor/km<sup>2</sup>), Kazniku (19 banor/km<sup>2</sup>) etj.


**Shtimi natyror:** Nëse e analizojmë rritjen e popullsisë prej vitit 1948 e deri në vitin 2011, komuna e Rahovecit pothuajse e ka trefishuar atë. Megjithatë, statistikat e viteve të fundit (2017-2019) nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, tregojnë se kemi një rritje të vogël të shtimit natyror në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 (1.4%). Ndërsa, viti 2019 karakterizohet me një rënje prej 17.8%, krahasuar me vitin paraprak.

<sup>5</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 18.



Nataliteti nuk ka pësuar as rënie e as rritje nga viti 2017 në atë 2018, ndërsa vërehet një rënie e natalitetit prej 14.7% në 2019-tën krahasuar me 2018-tën. Ndërsa, vërehet një rënie e lehtë e mortalitetit në vitin 2018 kundrejt vitit 2017 (2.9%), dhe rënie më e madhe në vitin 2019 kundrejt vitit 2018 (7.9%). Më gjërësisht, shih figurën në vijim.


**Graf. 2** Shtimi natyror në komunën e Rahovecit, periudha 2017-2019



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror në nivel të komunave, 2017-2019*.

**Struktura gjinore:** Sa i përket strukturës gjinore në këtë komunë, ka pak diferencë. Sipas regjistrimit të vitit 2011, 50.73% (28,512) janë meshkuj, ndërsa 49.27% (27,696) janë femra.

**Graf. 3** Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Rahovecit




Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Rahovecit sipas gjinisë 2011*.



**Struktura etnike:** Struktura etnike e popullsisë në komunën e Rahovecit është mjaft homogjene, meqë mbi 98% e popullsisë janë shqiptarë. Pastaj, ashkalinj 0.72%, egjiptianë 0.53%, serbë 0.24% dhe të tjerë 0.36%. Më gjerësish shih figurën në vijim, ku janë paraqitur grafikisht të gjitha etnicitetet me përqindje në pjesëmarrjen totale prej 100%.

Graf. 4 Struktura etnike e popullsisë në komunën e Rahovecit



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Rahovecit sipas etnicitetit 2011.*

**Struktura religjioze:** Edhe struktura religjioze e popullsisë në komunën e Rahovecit është mjaft homogjene, meqë mbi 99% e popullsisë i takojnë besimit islam. Besimit ortodoks 0.24%, besimit katolik 0.16%. Prej gjithsej të regjistruarve, 0.31% nuk janë deklaruar apo u takojnë besimeve tjera. Më gjerësish shih figurën në vijim, ku janë paraqitur grafikisht religionet përkatës me përqindje në pjesëmarrjen totale prej 100%.

Graf. 5 Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Rahovecit




Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Rahovecit sipas religjionit 2011.*



**Struktura moshore:** Siç shihet në figurën 5, komuna e Rahovecit ka strukturë moshore relativisht të re. Rreth 50% e popullsisë janë nën moshën 24 vjeçare. Ndërsa vetëm 5.96% i takojnë grupmoshave jo aktive për punë, prej 65 e tutje. Më gjërësisht, për secilën grupmoshë, shih figurën në vijim ku janë paraqitur edhe me përqindje.

**Graf. 6** Struktura moshore e popullsisë në komunën e Rahovecit



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Rahovecit sipas grupmoshës 2011.*

**VENDBANIMET** - Komuna e Rahovecit ka gjithsej **36 vendbanime**. Gjashtëmbëdhjetë vendbanime të komunës së Rahovecit kanë më shumë se 1,000 banorë. Qyteti i Rahovecit si vendbanim ka numrin më të madh të popullsisë (15,892), krahasuar me vendbanimet tjera. Megjithatë, duhet theksuar se mbizotëron shtrirja e popullsisë në zona rurale (71.7%), ndërsa, në zonë urbane jetojnë vetëm 28.3% e tyre.

Numri i ekonomive familjare sillet prej 1 (Sarosh) deri në 2,840 (qyteti i Rahovecit). Gjithsej janë të regjistruara 8,221 ekonomi familjare. Më gjërësisht, shih tabelën në vijim.



**Fig. 4 Pamje e qytetit të Rahovecit**



**Tab. 1 Popullsia e komunës së Rahovecit sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare**

Nr.	VENDBANIMI	POPULLSIA	EKONOMITË FAMILJARE	Nr.	VENDBANIMI	POPULLSIA	EKONOMITË FAMILJARE
1	Rahovec	15,892	2,840	19	Polluzhë	808	91
2	Krushë e Madhe	4,473	629	20	Dabidol	799	91
3	Ratkoc	3,791	526	21	Retijë	771	107
4	Xërxe	3,184	439	22	Nagavc	743	110
5	Radostë	2,346	300	23	Petkoviq	731	85
6	Bellacrkë	2,270	318	24	Senoc	687	90
7	Opterushë	1,911	249	25	Gexhë	660	88
8	Celinë	1,903	245	26	Zoçishtë	659	109
9	Dejnë	1,757	205	27	Zatriq	535	55
10	Drenoc	1,587	212	28	Pataçan i Epërm	533	78
11	Çifllak	1,292	164	29	Bratotin	396	52
12	Brestovc	1,288	187	30	Reti e Ulët	234	36
13	Hoçë e Vogël	1,166	168	31	Nushpal	220	37
14	Kramovik	1,125	130	32	Mrasor	191	28
15	Pataçan i Ulët	1,077	139	33	Kaznik	164	22
16	Pastasellë	1,011	127	34	Hoçë e Madhe	124	27
17	Sapniq	996	134	35	Bërnjak	40	5
18	Vrajakë	838	97	36	Sarosh	6	1


**Gjithsej 56,208 banorë dhe 8,221 ekonomi familjare**

Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Rahovecit sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare 2011.*



Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Rahovecit mund të kategorizohen si në figurën në vijim.

**Graf. 7** Kategorizimi i vendbanimeve në komunën e Rahovecit



Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Rahovecit mund të kategorizohen si në figurën në vijim.

**Tab. 2** Klasifikimi i vendbanimeve në komunën e Rahovecit sipas kategorizimit në figurën 4a.


Deri në 500 banorë	500-999 banorë	1,000-1,999 banorë	2,000-4,999 banorë	Mbi 5000 banorë
Sarosh Bërnjak Hoçë e Madhe Kaznik Mrasor Nushpal Reti e Ulët Bratotin	Pataçan i Epërm Zatriq Zoçishtë Gexhë Senoc Petkoviq Nagavc Reti jë Dabidol Polluzhë Vrajakë Sapniq	Pataselli Pataçan i Ulët Kramovik Hoçë e Vogël Brestovc Çifllak Drenoc Dejnë Celine Opterushë	Bellacrkë Radostë Xërxe Ratkoc Krushë e Madhe	Qyteti i Rahovecit

Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Rahovecit sipas vendbanimit, 2011.*

Në vijim është paraqitur grafikisht, numri i popullsisë sipas vendbanimeve, bazuar në regjistrimet 1948-2011.



**Graf. 8 Regjistrimi i popullsisë sipas vendbanimeve, 1948-2011**



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Rahovecit sipas vendbanimit, 1948-2011.*

Sic shihet në grafikonin më lart, të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit kanë rritje të popullsisë prej vitit 1948 në atë 2011, përveç vendbanimet: Kaznik, Hoçë e Madhe dhe Sarosh, të cilat kanë pësuar rënje të dukshme. Bazuar në përqindjen e rritjes prej vitit 1948 në atë 2011, rritje më të madhe kanë shënuar vendbanimet: Çifllak, Xërxe, Pataçan i Ulët dhe Nushpal. Pastaj vendbanimet: Senoc, Kramovik, Bellacrkë, Krushë e Madhe, Dabidol, Celinë etj.



**MIGRIMI** - është lëvizja e njerëzve nga një vend në tjetrin me qëllime të ndryshme si vendosja e përkohshme ose e përhershme. Migrimi është më shumë se rritja ose zvogëlimi i njerëzve që jetojnë në një vend të caktuar. Ai ndikon në ndikon në kulturën, stilin e jetës dhe qëndrimin politik të një kombi.

Të dhënat dhe statistikat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se në komunën e Rahovecit ekziston një rritje e vazhdueshme e migrimit kombëtar dhe ndërkontinentale. Më konkretisht, shih tabelat në vijim.

**Tab. 3a** Migrimi kombëtar në komunën e Rahovecit, periudha 2017-2019

Migrimi kombëtar	2017	2018	2019
Imigrimi	179	161	164
Emigrimi	277	263	268
<b>Bilanci i migrimit kombëtar</b>	<b>-98</b>	<b>-102</b>	<b>-104</b>

**Tab. 3b** Migrimi ndërkontinentale në komunën e Rahovecit, periudha 2017-2019

Migrimi ndërkontinentale	2017	2018	2019
Imigrimi	75	87	78
Emigrimi	879	1,696	2,012
<b>Bilanci i migrimit ndërkontinentale</b>	<b>-804</b>	<b>-1609</b>	<b>-2024</b>

Burimi: ASKDATA: Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin, 2017 – 2019.



**ARSIMI** - luan një rol të madh në zhvillimin e shoqërisë në botën moderne dhe të industrializuar. Njerëzit kanë nevojë për një arsimim të mirë për të qenë në gjendje të mbijetojnë në mjedisin konkurrues. Shoqëria moderne bazohet në njerëz që kanë standarde të larta jetese dhe njoħuri që u lejon atyre të zbatojnë zgjidhje më të mira për problemet e tyre.

Arsimi eshtë institucion shoqëror përmes të cilit shoqëria u siguron anëtarëve të saj njoħuri të rëndësishme, duke përfshirë faktet themelore, aftësitë e punës dhe vlerat e normave kulturore. Një nga përfitimet më të rëndësishme të arsimimit eshtë se ai përmirëson jetën personale dhe ndihmon shoqërinë të funksionoje më mirë. Duke ofruar arsimim, varfëria mund tē zhduket dhe çdo person mund tē japë kontributin e tij në zhvillimin e vendit.

Arsimimi i fuqizon të gjithë. Pra, arsimimi i mirëfilltë ndikon në zbutjen e varfërisë, rritjen e sigurisë, zhvillimin e tregtisë, vénien e rendit dhe rregullit, respektimin e ligjit, fuqizimin e gruas, përmirësimin e pjesëve më të dobëta ekonomike të shoqërisë etj.

Rrjedhimisht, arsimi ndikon në krijimin e një shoqërie më të mirë. Mungesa e arsimimit krijon probleme si bestytnitë, dhuna në familje, shëndeti i dobët dhe standarde të dobëta të jetesës. Arsimimi sjell mundësi të barabarta për burrat dhe gratë dhe njerëzit e arsimuar do tē jenë në gjendje të krijojnë një shoqëri më të mirë. Pra, pa një sistem të qëndrueshëm arsimor, nuk mund tē formohet një shoqëri e mirë.

Arsimi eshtë pjesë integrale e shoqërisë njerëzore. Si pasojë e mos arsimimit lindin probleme të shumta sociale si shëndet i dobët, konflikt i brendshëm, standard i dobët jetese etj. Arsimimi ndihmon njerëzit të gjejnë një zgjidhje më të mirë për problemet e tyre. I lejon njerëzit të kuptojnë vlerën e vërtetë të kontributit dhe të ndihmojnë të bëhen shtylla kurrizore e shoqërisë. Po ashtu, duhet theksuar se arsimimi inkurajon inovacionin dhe krijimtarinë.



Pa njerëz tē arsimuar, bota nuk mund tē bëhet më e mirë. Kjo eshtë arsyaja pse nevojitet arsimim i mirëfilltë për ta kthyer botën në një vend më të mirë. Andaj, themi se një vend që tē evoluojë, duhet tē ketë sistem tē qëndrueshëm arsimor.



**Sistemi arsimor në Kosovë:** Që nga viti 2002, sistemi arsimor në Kosovë është duke funksionuar sipas modelit 5+4+3. Sipas këtij modeli: 5 vite janë në arsimin fillor, pastaj vazhdohet me 4 vite të shkollimit të mesëm të ulët dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të mesëm të lartë.

Rrjetimisht, edhe struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Rahovecit është e organizuar në tri nivele: arsimin fillor (klasët I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasët VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasët X – XII).

Në komunën e Rahovecit arsimi është i organizuar në 39 objekte shkollore, të cilat janë shkolla amë dhe paralele të ndara dhe një (1) çerdhe publike (Çerdhja Tulipanët).

Hapësirat shkollore janë të mjaftueshme për nxënësit, për shkak se në vitet e fundit janë ndërtuar objekte të reja shkollore, siç janë objekti i ri i shkollës në Kramovik, objekti i ri i shkollës në Opterushë. Po ashtu, janë në përfundim e sipër për t'u vënë në funksion në muajin shtator 2021 edhe 5 objekte të reja shkollore, e ato janë: objekti i ri i Shfmu "Sadedin Hajda" në qytet, objekti i ri i Shfmu "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël/Brestoc, objekti i ri i Shfmu "Haki Stërmilli" në Retijë, objekti i ri i Shfmu "Liria" në Fortesë dhe objekti i ri i Shfmu "Milaim Krasniqi" në Kaznik.

Kushtet infrastrukturore të objekteve shkollore janë përmirësuar dukshëm viteve të fundit, sepse në periudhën 2018 - 2020 nga komuna e Rahovecit janë bërë investime në riparimin e objekteve shkollore, është bërë investim në instalimin e ngrohjes qendrore në shtatë (7) shkolla në tri vitet e fundit. Në dy (2) shkolla janë zbatuar masat e eficiencës së energjisë dhe komuna ka siguruar përkrahje nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë edhe për dhjetë (10) shkolla të tjera, projekte të cilat pritet të realizohen gjatë këtij viti dhe viti 2022.

**Arsimi parashkollar dhe parafillor:** Studimet tregojnë se arsimimi i hershëm cilësor, ndikon në performance më të mirë më vonë në jetë, si në sfera shoqërore po ashtu edhe akademike. Personat e tille arrijnë rezultate më të larta në testimet e standardizuara, janë më të rregullt në mësime, janë më të disiplinuar etj.

Përveç përfitimeve të dukshme për secilin fëmijë, studime të shumta kanë treguar gjithashtu se programet e arsimimit të fëmijërisë së hershme sigurojnë një përfitim ekonomik edhe për shoqërinë.

Sipas të dhënave dhe statistikave nga ASK, në komunën e Rahovecit ka një çerdhe për fëmijët e moshës nën 5 vjet. Megjithatë, duhet theksuar se në shumicën e shkollave fillore në vend ofrohet arsimim njëveçar parashkollar për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeçare.

Burimi i njëjtë qet në pah një numër të vogël që kanë vijuar arsimin parashkollar. Në vitin 2017/2018 kanë vijuar 39 fëmijë, në vitin 2018/2019, 31 fëmijë. Ndërsa, vërehet një rritje prej 74% në vitin vijues (2019/2020), ku kanë vijuar mësimin 54 fëmijë.




Me ndërtimin e çerdhes së re përfshirë fëmijët dhe vënien e saj në funksion më 1 dhjetor 2020, numri i fëmijëve që vijnë edukimin parashkollor është rritur nga 54 në 120 fëmijë dhe kjo tendencë e rritjes vazhdon. Numri i fëmijëve që do të përfshihen në edukimin parashkollor në çerdhe përmoshat 0 - 5 vjeç do të trefishohet, përsye se Komuna e Rahovecit i ka gati afër finalizimit 3 objekte të reja të çerdheve, në Krushë të Madhe, Xërxe dhe Ratkoc. Sipas dinamikës së realizimit të këtyre projekteve, në shtator të vitit 2021 këto 3 objekte të çerdheve do të funksionalizohen.

Arsimin parafillor e kanë ndjekur mesatarisht 838 nxënës për periudhën 2017-2020. Mirëpo, te ky nivel arsimi vërehet një rënie mesatare vjetore prej 2.3% për periudhën e lartcekur.

**Arsimi i mesëm i ultë:** Këtë nivel arsimi në periudhën 2017-2020 e kanë ndjekur mesatarisht 7,228 nxënës. Edhe te ky nivel arsimi vërehet një rënie mesatare vjetore prej 3.6% për periudhën 2017-2020.

**Arsimi i mesëm i lartë:** Këtë nivel arsimi në periudhën 2017-2020 e kanë ndjekur mesatarisht 2,010 nxënës. Këtu ka një më rënie më të dukshme mesatare prej 13.1% për periudhën 2017-2020.

**Graf. 9** Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2017-2020



Burimi: ASKDATA: *Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2015-2020.*

Siq shihet në grafikun e mësipërm, te të gjitha nivelet e arsimit në komunën e Rahovecit, ka rënie mesatare nga viti në vit për periudhën e analizuar. Arsyet kryesore të kësaj rënie janë: migrimi i familjeve jashtë vendit dhe rënia e natalitetit.



Gjatë vitit 2019 janë ndarë 95 bursa nga komuna e Rahovecit për studentët e universiteteve publike, për dallim me vitin paraprak që ishin ndarë 63 bursa. Pra, ka një rritje prej 50% nga viti 2018 ne atë 2019.<sup>6</sup>

Bazuar në të dhënrat nga ASK (periudha 2017-2020), numri mesatar i personelit në arsimin publik për këtë periudhë është 847. Prej tyre mesatarisht 730 janë mësimdhënës. Ndërsa, numri mesatar i nxënësve për periudhën 2017-2020 është 10,118. Rrjedhimisht, raporti nxënës/mësimdhënës (edukator) është 14.

Hulumtimi i vitit 2011 nga ASK mbi popullsinë e moshës 10 vjeçë e mbi, sipas nivelit të arsimimit dhe njohjes së shkrimleximit, qet në pah se pjesa dërrmuese e popullsisë së komunës së Rahovecit kanë të përfunduar shkollimin e mesëm të ultë (45%), pastaj atë fillor (21.6%), të mesëm të lartë (17.6%). Prej tyre të diplomuar rezultuan 4.9%, ndërsa me studime postdiplomike vetëm 0.3%. Prej gjithsej të anketuarve, 10.6% e tyre nuk kanë përfunduar asnje lloj niveli të arsimimit. Prej respondentëve që nuk kanë përfunduar asnje lloj shkollimi, 59.5% e tyre janë deklaruar se dinë shkrim dhe lexim dhe 40.5% e tyre janë deklaruar se nuk dinë.

Sa i përket përqindjes së shkollimit të nxënësve në komunën e Rahovecit, nga raportet që ka DKA, përqindja e shkollimit të nxënësve, në krahasim me ata që braktisin shkollimin është 99%. Këtu nuk llogaritet braktisje e shkollimit përfunduar fëmijët/nxënësit, të cilët së bashku me familjet e tyre migrojnë jashtë vendit.

Nuk duhet lënë anash faktin se Marrëveshja e Stabilizim - Asocimit (MSA) përcakton kornizën e bashkëpunimit të Kosovës me Bashkimin Evropian (BE) për ngritjen e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, me qëllim të përmirësimit të shkathtësive, punësueshmërisë, përfshirjes sociale dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik. MSA i kushton kujdes të veçantë bashkëpunimit për arritjen e gjithëpërfshirjes dhe barazisë në arsim, me theks të veçantë, gjininë, përkatësinë etnike dhe fetare, si dhe personat me aftësi të veçanta. Pritet që bashkëpunimi në mes të BE-së dhe Kosovës të merr formën e asistencës teknike për jetësimin e masave të caktuara të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK-ut).<sup>7</sup>

Rrjedhimisht, komuna e Rahovecit duhet të përqendrohen në përmirësimin e kushteve për zhvillim të arsimit para fillor, fillor dhe të mesëm. Duke bërë rregullimin e infrastrukturës së nevojshme shkollore, hapjes së shkollave profesionale, përmirësimin e cilësisë në arsim,

<sup>6</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2019. Komuna e Rahovecit, fq. 3.

<sup>7</sup> Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023, fq. 11.



monitorimin e procesit arsimor. Po ashtu, duhet bërë përgjedhjen meritore të stafit arsimor dhe menaxherial, si dhe përpjekjen në ngritjen e kapaciteteve të vazhdueshme të kuadrit arsimor.

**SHËNDETËSIA** - Në praktikat e vendeve të zhvilluara, komunat janë përgjegjëse për ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve sociale me cilësi të lartë për të gjithë ata që kanë nevojë për to, pavarësisht moshës dhe diagozës. Ndërsa, shteti është përgjegjës për sigurimin e kornizës me kushte të barabarta përmes legjislacionit dhe kornizave financiare. Përveç kësaj, shteti mban përgjegjësinë e ushtrimit të mbikëqyrjes dhe kontrollit.

Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të listës prioritare të projekteve ka inkorporuar edhe projektin për fuqizimin e infrastrukturës në kujdes parësor. Veprimtaria e kujdesit parësor shëndetësor përfshin promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë kujdesin dentar dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike mbështetur në konceptin e mjekësisë familjare.<sup>8</sup>

Në komunën e Rahovecit shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëmive të specializuara mjekësore. Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është i organizuar në 16 objekte shëndetësore si në vijim:

- 1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) - në qytetin e Rahovecit.
- 7 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në: Ratkoc, Bellacerkë (Fortesë), Çifllak, Drenovc, Krushë e Madhe, lagja e Arave dhe Apterush.
- 7 Ambulanca të Mjekësisë Famijare (AMF) në: Lagja e Eperme, Hoçe e Madhe, Zaqisht, Brestoc, Radostë, Polluzhë dhe Xërxe.
- 1 Qendër për Punë Sociale (QPS).

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Rahovec, si bartëse e kujdesit primarë, është e vendosur në qytetin e Rahovecit dhe ka gjendje fizike të kënaqshme. Kjo qendër mbulon



<sup>8</sup> Po aty.



me shërbime territorin e Rahovecit dhe fshatrat përreth.<sup>9</sup> Gjithsesi duhet theksuar se në vitin 2020 është bërë përrurimi i objektit të ri të QKMF në Rahovec, i cili është modern dhe i plotëson të gjitha kushtet për shërbime ndaj qytetarëve. U ndërtua QMF në Çifllak dhe janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e QMF-së në Opterushë, e cila pritet të përfundojë në maj të këtij viti.<sup>10</sup>

Numri i të punësuarit në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas profesioneve në komunën e Rahovecit në vitin 2019 ishte për 12.4% më i lartë se në dy vitet paraprake. Konkretisht, kjo komunë ka të punësuar gjithsej 145 punëtorë shëndetësorë. Prej tyre, 45 mjekë, 71 infermierë dhe 29 punëtorë si personel administrativ dhe teknik.<sup>11</sup>

Grafiku në vijim tregon se numri i vizitave të përgjithshme në QMF në komunën e Rahovecit ka pësuar rënje prej 28.6%. Nëse krahasohet viti 2018 dhe 2019, vërehen ndryshime në qëllimin e vizitave mjekësore sipas kategorive.

Po ashtu, nëse e analizojmë numrin e përgjithshëm të vizitave mjekësore në QMF me numrin e përgjithshëm të popullsisë në këtë komunë, rezulton se mesatarja e vizitave mjekësore vjetore për person është rreth 4 herë. Më gjërësisht, shih informatat e prezantuara në grafikun në vijim.

---


<sup>9</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2011-2020, fq.100.

<sup>10</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovecit, fq. 6, 26.

<sup>11</sup> ASKDATA: *Të punësuarit në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas profesioneve, 2017-2019.*



**Graf. 10** Krahasim i numrit të vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas kategorive, 2018-2019



Burimi: ASKDATA: *Numri i vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare, 2018-2019.*

Sa i përket sëmundjeve të regjistruara në të dhënat dhe statistikat e ASK-së për këtë komunë, del se 98.6% e të anketuarve kanë raportuar raste të sëmundjeve të ndryshme ngjitëse (2016), mesatarisht 1% e tyre sëmundje malinje (2017-2019) dhe mesatarisht 0.4% e tyre sëmundje të tuberkulozit (2018-2019).

Në vitin 2020 është furnizuar QKMF-ja me pajisje moderne të EHO-së, për Radiologji, Gjinekologji dhe Urologji. Po ashtu, pritet së shpejti të furnizohet edhe me Mamografi dhe Ortopan.<sup>12</sup> Ndërsa, gjatë vitit 2019 është renovuar ndërtesa e QPS-së.<sup>13</sup>

**MIRËQENIA SOCIALE** - Sistemi i mirëqenies sociale është një rrjet programesh i krijuar për të ndihmuar banorët e një vendi në fazën e jetës së tyre. Ky sistem lind nga përpjekjet e qeverisë ose organizatave për të siguruar mirëqenie sociale. Është një proces i vazhdueshëm që synon të kujdeset për nevojat specifike të shoqërisë. Përmes programeve të mirëqenies sociale, qytetarët mbrohen nga pasiguritë e ndryshme të jetës.

<sup>12</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovecit, fq. 6.

<sup>13</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2019. Komuna e Rahovecit, fq. 24.



Në komunën e Rahovecit ka disa shërbime sociale që u ofrohen banorëve, por ka edhe disa tjera që u mungojnë atyre.<sup>14</sup>

**Qendra për punë sociale:** Në komunën e Rahovecit funksionon Qendra për punë sociale e cila merret me çështje të rëndësishme sociale siç janë: banimi social, shëndeti mendor, shtresat ndryshme të shoqërisë duke përfshirë të moshuarit, integrimin e personave me çrrregullime të ndryshme etj.

**Banesat sociale kolektive:** Shërbejnë për familjet e pastrehë që janë njëkohësisht raste të rënda sociale. Këto banesa tanimë janë ndërtuar në shumicën e komunave të Kosovës. Komuna e Rahovecit ka një numër të konsiderueshëm të familjeve të pastrehë, andaj ka nevojë për ndërtimin e këtyre banesave. Ekziston një ndërtesë sociale në dalje të Rahovecit, rrugës përfshatin Brezovac, por që ende nuk është e funksionalizuar.

**Qendra e shëndetit mendor:** Edhe kjo Qendër është e një rëndësie të veçantë marrë përbazë personat me nevoja të veçanta, të cilët kanë nevojë për trajtim në këtë lloj qendre. Duke marrë përbazë faktorët e ndryshëm relevantë që kanë ndikuar në gjendjen psiko-fizike të popullatës si pasojat e luftës, varfëria dhe problemet e shumta familjare, edhe komuna e Rahovecit ka nevojë për një qendër të tillë.

**Qendra për të moshuar:** Në komunën e Rahovecit ekziston qendra për persona të moshuar po kjo qendër është në gjendje jo të përshtatshme për shfrytëzim dhe nuk i plotëson kërkesat e kësaj shtrese të shoqërisë. Megjithatë, është duke vazduar ndërtimi i shtëpisë përtë moshuar për qëndrim ditor mbi qytetin e Rahovecit. Në këtë qendër parashihet të ketë një sallë kolektive për qëndrim dhe aktivitete, dhoma përtë pushuar, tarracë etj.<sup>15</sup>

**Shtëpia integruese:** Konsiderohet si vendbanim i përkohshëm për personat me probleme mendore, zakonisht deri në gjashtë muaj, ku aty riaftësohen përtu rikthyer në familje dhe përtu ri-integruar në shoqëri. Edhe kjo lloj shtëpie mungon në komunën e Rahovecit.

**Shtëpia edukuese:** Është një institucion në të cilin vendosen fëmijët pas shqyrimit të masës nga ana e gjykatës apo organit të kujdestarisë. Po ashtu, përdërgimin e të miturve me çrrregullime në sjellje ose sjellje jo sociale. Sigurisht që një shtëpi e kësaj natyre i duhet çdo komune. Kjo shtëpi mungon në komunën e Rahovecit.

<sup>14</sup> Përpunuar nga: Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2013-2023, fq. 32-33.

<sup>15</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovecit, fq. 8.



Të dhënrat nga Qendra për Punë Sociale në komunën e Rahovecit lidhur me numrin e popullsisë me assistencë sociale, familjeve dhe kryefamiljarëve nëna me assistencë sociale, paraqesin një shkallë të lartë të varfërisë ekstreme. Sipas këtyre të dhënave rezulton se në komunën e Rahovecit ekzistojnë 2,581 persona apo 590 familje që jetojnë me assistencë sociale, që nënkupton se kjo pjesë e popullsisë jeton në varféri ekstreme. Ndërkaq, varfëria e përgjithshme përfshin një përqindje më të madhe të popullsisë. Me shkallë më të lartë të varfërisë është e prekur gjinia mashkulllore (75%), kurse me assistencë sociale 25% janë kryefamiljare nëna. Kjo shkallë e lartë e varfërisë shtrihet në tërë territorin.

Më konkretisht, vendbanimet që kanë përqindje më të vogël të popullsisë me assistencë sociale janë: Bellacerka, Nashpalli, Radost, Sapniqi, Zoqishta, Palluzha, Krusha e Madhe, Kramoviku, Brestovci dhe Bratotini. Ndërsa vendbanimet me përqindje më të madhe të popullsisë me assistencë sociale janë: Kazniku, Senoci, Zatriqi, Petkoviqi dhe Dabidoli.<sup>16</sup>

Ndërsa, të dhënrat e fundit nga ASK për vitin 2020 (TM1-TM3) tregojnë se në komunën e Rahovecit janë mesatarisht 2,672 persona apo 639 familje të cilat kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale. Këtu vërejmë një rritje prej 8.3% nga të dhënrat e prezantuara më herët.

Vlen të theksohet se në vitin 2019, komuna e Rahovecit së bashku me Shoqatën “*Jetimët e Ballkanit*” ndërtuan tetë (8) shtëpi për familjet në nevojë.<sup>17</sup>


<sup>16</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 26.

<sup>17</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2019. Komuna e Rahovecit, fq. 3.



**TREGU I PUNËS** – Në vijim janë përbledhur disa statistikat të përgjithshme mbi tregun e punës në Kosovë.

**Graf. 11** Statistikat e tregut të punës, 2019



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2020*, fq. 15.

Siq shihet në grafikun e mësipërm, fuqia ekonomikisht aktive për vitin 2019 ishte 488,485 persona. Rrjedhimisht, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë ekonomikisht aktive për vitin 2019 rezultoi 40.5 %. Ndërsa, fuqia ekonomikisht jo aktive për vitin 2019 ishte 718,321 persona që rezultoi në 59.5 % shkallë të pjesëmarrjes në fuqinë ekonomikisht jo aktive për vitin 2019.

Po ashtu, të dhënrat nga ASK, tregojnë se në vitin 2019 ishin të punësuar 363,180 persona, që rezultoi në 30.1% shkallë të punësimit. Po në të njëjtin vit të papunë ishin 125,305 persona, pra shkalla e papunësisë sillej rrëth 25.7%.

Hulumtimet e ndryshme kanë treguar se shkalla e papunësisë në komunën e Rahovecit është mjaft e lartë, rrëth 28.4%. Vlerësohet se rrëth 80% e të papunëve janë të papunë afatgjatë (për më shumë se 12 muaj).<sup>18</sup>

<sup>18</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2013-2023, fq.33.



Numri i personave kontributdhënës në Trustin pensional në vitin 2019 ishte 8,668. Reth 12.8% më shumë se në vitin paraprak.<sup>19</sup>

**SHËRBIMET ADMINISTRATIVE** - Komuna e Rahovecit ka gjithsej 12 drejtori të cilat janë prezantuar detajisht te skema organizative e komunës (shih Shtojcën). Sipas statistikave të institutit GAP, në vitin 2019 ishin të punësuar 161 persona si shërbyes civilë. Reth 6.6% më shumë se në vitin paraprak.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Ligji Nr. 03/L-040, Komuna është përgjegjëse kryesisht për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve primare ndaj qytetarëve. Si rezultat, komuna e Rahovecit i ofron të gjitha shërbimet dhe merr përgjegjësitë e përcaktuara nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale Ligji Nr. 03/L-040.

Qytetarëve të komunës së Rahovecit përveç që u ofrohen shërbime të mira në komunë, atyre që nga viti 2020 u ofrohen edhe shërbime elektronike nëpërmjet u E-kioskut.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 është riorganizuar administrata dhe është hapur sporteli i veçantë për mërgimtarët.<sup>20</sup>

**INFRASTRUKTURA** - Mirëmbajtja e infrastrukturës publike mbetët një ndër sfidat kryesore të komunave. Ato janë përgjegjëse për mirëmbajtjen, organizimin, operimin dhe zhvillimin e rrjetit rrugor të tyre.

**Rrugët:** Nëse analizohet niveli i mbulushmërisë së sipërfaqes së komunës së Rahovecit me rrugë të te gjitha kategorive, del se ato shtrihen në gjithsej 157.1 km.

Komuna e Rahovecit karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor, të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Shtrirja e rrugëve regionale kryesisht në pjesën qendrore dhe perëndimore të komunës, ia ka shtuar rëndësinë kësaj hapësirë.

Në komunën e Rahovecit ekzistojnë katër kategori të rrugëve (sipas klasifikimit në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato të pa kategorizuara.

<sup>19</sup> Instituti GAP. <https://www.komunat.institutigap.org/Statistics/index/1-16/271-271/y-y>

<sup>20</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2019. Komuna e Rahovecit, fq. 4.




Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovcit përbëhet nga:

- Rrugët magjistrale:** M9.1 Gjakovë-Prishtinë
- Rrugë regionale:** R107 Prizren-Gjakovë, R117 Rahovec-Suharekë, R111 Xerxë-Ratkoc-Kramovik, R204 Rahovec-Krushë e Madhe, R110 Malishevë-Rahovec-Xerxë
- Rrugë lokale:** Rrugët të cilat i lidhin 34 komuna kadastrale me gjithsej 36 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve
- Rrugë të pa kategorizuara:** Lidhin lagjet e fshatit si dhe të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike.<sup>21</sup>

Ato shtrihen në gjithsej Në 297.6 km rrugë. Nga ky total, rrugë magjistrale janë 6.2 km (2.1%), rrugë regionale 64.3 km (21.6%), rrugë lokale 114 km (38.3%), rrugë urbane 30.6 km (10.3%) dhe rrugë të pa kategorizuara janë 82.5 km (27.7%).

**Graf. 12** Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovcit



Burimi: Përpunuar nga: *Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2013-2023*, fq.102.

<sup>21</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2013-2023, fq.101.



Ruga magjistrale konsiderohet e mirë. Rrugët regjionale, lokale dhe urbane konsniderohen mesatarisht të mira. Ndërsa, rruget e pa kategorizuara vlerësohen si jo të mira. Vlerësohet se 94.4% e popullsisë në komunën e Rahovecit kanë qasje në rruge të asfaltuar.<sup>22</sup>

Gjatë vitit 2020 janë ndërtuar trotuare në disa vendbanime të komunës së Rahovecit si në qytetin e Rahovecit, Drenoc, Malësi e Vogël, Ratkoc, Opterushë, Celinë dhe Sapniq. Gjithashtu, ndërtimi i rrugës në fshatin Zaqisht është në përfundim e sipër. Janë duke vazhduar edhe punimet në rrujen Xërxe-Sapniq-Ratkoc si dhe segmentin Sapniq-Nashpall.<sup>23</sup> Duhet theksuar se një ndër sukseset më të mëdha të komunës është edhe vazhdimi i projektit të rrugës katër shiritore nga Rahoveci në Xërxe, kanali atmosferik në qytet si dhe tre udhëkryqet me semaforë të rinj.<sup>24</sup>

Një ndër projektet madhështore të komunës së Rahovecit është edhe projektimi i Sheshit Qendror të Qytetit nga arkitektë të njohur ndërkombëtarë, të cilët i kanë dhënë qytetit të Rahovecit një dizajn ikonik dhe shumë funksional siç kanë kërkuar vetë qytetarët.<sup>25</sup>

**Rrjeti hekurudhor:** Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit është i karakterit regional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit (Lidhë komunat: Prizren, Rahovec, Klinë, Fushë Kosovë). Kjo linjë hekurudhore është një binarëshe dhe ka gjatësi prej 10.4 km. Gjithsej 12 komuna kadastrale preken nga rrjeti hekurudhorë apo kanë qasje të drejtpërdrejtë në të. Ato janë: Mrasori, Kramoviku, Çifllaku, Dabidoli, Dejna, Ratkoci, Radosta, Gexha, Xerxa, Bellacerka, Celina dhe Krusha e Madhe. Shprehur në përqindje, 38.3% e popullsisë së Rahovecit.

Ky rrjet hekurudhor është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për komunën e Rahovecit por edhe për komunat tjera sepse ndihmon në transportimin e mallrave dhe udhëtarëve. Fatkeqësisht kjo linjë hekurudhore momentalisht është jo funksionale.<sup>26</sup>

**Urat:** Komuna e Rahovecit ka dy kategori urash: urat në komunikacionin rrugor (16) dhe urat në komunikacionin hekurudhor (4). Në përgjithësi janë në gjendje të mirë. Disa prej tyre kanë qenë të dëmtuara gjatë luftës së vitit 1999, mirëpo, janë rindërtuar pas luftës.

<sup>22</sup> Po aty, fq. 106.

<sup>23</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovecit, fq. 8, 35.

<sup>24</sup> Po aty, fq. 42.

<sup>25</sup> Po aty, fq. 7.

<sup>26</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2013-2023, fq. 110.



**Transporti publik:** Organizohet nëpërmjet autobusëve dhe automjeteve të tjera të transportit dhe është mjaft mirë i organizuar. Prej gjithsej 36 vendbanime të komunës së Rahovecit, 31 prej tyre kanë qasje në transport publik nëpërmjet autobusëve, ndërsa pesë (5) prej tyre nuk kanë. Bazuar në numrin e popullsisë në këto vendbanime, rezulton se 96% e tyre kanë transport publik të organizuar nëpërmjet autobusëve, ndërsa 4% nuk kanë qasje në transport publik.

Vlen të theksohet se është duke vazhduar renovimi i stacionit të autobusëve, i cili pritet të përfundojë në vitin 2021.<sup>27</sup>

Komuna e Rahovecit së fundi ka ndërtuar parqe në Gexhë, Malësi të Vogël, Pataqan të Poshtëm, Dobidol, Sapniq, Celinë, Zaqisht dhe Ratkoc. Gjatë vitit 2021 pritet të ndërtohen edhe parqe të reja<sup>28</sup>

**TELEKOMUNIKACIONI** - është transmetim i informacionit nga lloje të ndryshme të teknologjive mbi tela, radio, optike ose sisteme të tjera elektromagnetike.

**Rrjeti i telefonisë fikse:** në komunën e Rahovecit është i lidhur nëpërmjet fibrit optik. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së në Rahovec, e cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibër optik. Nga gjithsej 36 vendbanime, vetëm 5 prej tyre kanë qasje drejtpërdrejt në rrjetën e telefonisë fikse. Nëse analizohet sipas numrit të popullsisë në vendbanimeve, 47.5% e tyre kanë qasje drejtpërdrejt në rrjetën e telefonisë fikse. Këto statistika nuk janë të kënaqshme, meqë ky rrjet mbulon një pjesë të vogël të vendbanimeve, por me numër më të madh të popullsisë.



**Rrjeti i telefonisë mobile:** Në territorin e Rahovecit është e mbuluar mjaft mirë. Të gjitha vendbanimet në komunën e Rahovecit kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorë të licencuar nga Autoriteti Rregulativ i Telekomunikacionit (ART).

**Shërbimet e Internetit:** Ekzistojnë disa operatorë të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në komunën e Rahovecit. Territori i komunës nuk është i mbuluar plotësisht me

<sup>27</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovecit, fq. 8.

<sup>28</sup> Po aty, fq. 7.



shërbime të internetit. Kryesisht nuk janë të mbuluara viset malore dhe disa pjesë të vendbanimeve rurale, por edhe këtu ofrohen shërbime me anë të internet-kafeve.

**Radiotelevizioni:** Rrjeta e Radiotelevizionit në komunën e Rahovecit është e shpërndarë pothuajse në tërë territorin e komunës.<sup>29</sup>

Në vijim grafikun në vijim janë paraqitur rezultatet e anketimit nga ASK, lidhur me ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet në komunën e Rahovecit.


Rezultatet e këtij anketimi tregojnë se vetëm 2.2% e ekonomive familjare në komunën e Rahovecit posedojnë telefon fiks. Pjesa dërrmuese e tyre (90.6%) posedojnë vetëm telefon celular. Telefon fiks dhe celular kanë 6.6% e tyre, ndërsa as telefon fiks e as celular 0.6% e tyre.

---

<sup>29</sup> Të dhënat për telekomunikacionin janë siguruar nga Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2013-2023, fq.114-115.



**Graf. 13** Ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet në komunën e Rahovecit



Burimi: ASKDATA: *Ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet, 2016.*

Sa i përket posedimit të kompjuterit personal, rezultatet e këtij anketimi tregojnë se 61.1% e ekonomive familjare në komunën e Rahovecit e posedojnë së paku një të tillë dhe 38.9% nuk posedojnë. Prej ekonomive familjare që posedojnë kompjuter, 53.4% e tyre kanë qasje në internet nga njësia e banimit dhe 7.7% e tyre nuk kanë. Ndërsa, nga ekonomitë familjare që nuk kanë kompjuter, 3.2% e tyre shfrytëzojnë mundësitetë alternative të qasjes në internet dhe 35.7% e tyre nuk kanë qasje fare.



**RRJETI ENERGJETIK** - Është i mbuluar mirë shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike. Mirëpo gjendja e këtij rrjeti në drejtime te caktuara nuk është e mirë dhe kërkon intervenime. Nga gjithsej 36 km gjatësi, 34.3 km e rrjetit energjetik gjendet në zonën e kopshteve. Në përgjithësi, kërkohet që kapaciteti i tij në të gjitha drejtimet të rritet diku nga 10 kv në 20 kv.

Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike në nivel komune duhet të bëhet edhe në segmentin e përmirësimit të infrastrukturës fizike me shtylla elektrike. Ky segment i infrastrukturës energetike të komunës propozohet që në të gjitha drejtimet e shpërndarjes së energjisë elektrike të kapacitetit 20 kv, të bëhen në shtylla të betonit me gjatësi standarde (sipas standardeve të BE-së). Ndërsa në zonën urbane është e preferueshme të ketë kablo nëntokësore. Është e rendësishme të theksohet se rrjeti fizik i energjetikës në nivel të vendbanimeve në mënyrë selektive duhet të përmirësohet me shtylla plotësuese nga druri ose betoni.<sup>30</sup>

**NDRIIMI PUBLIK** - Rrjeti ekzistues i ndriçimit publik përfshin qytetin e Rahovecit dhe pjesën më të madhe të vendbanimeve tjera. Rrjeti i sistemit të ndriçimit është i përbërë prej shtyllave të

drurit. Disa prej tyre janë shtylla të betonit me lartësi deri në 8.5 m. Distanca mes shtyllave është 35 m.<sup>31</sup>



Në vitin 2018 dhe 2019 mbi 10 km janë mbuluar me ndriçim publik. Në vitin 2020 mbi 14.3 km si dhe në vitin 2021 mbi 15 km dhe vazhdon ende. Pra, komuna e Rahovecit ka mbuluar gjithsej 40 km ndriçim publik brenda tri vitesh.

Vendbanimet e mbuluara janë: tri lagje të Rahovecit, Fortesa, Xërxa, Gexha, Malësia e Vogël, Ratkoci, Dejni, Dabidoli, Çifllaku, Gur i Kuq, Mrasori, Drenoci, Nagaci, Krusha e Madhe, Reti.

Pra, nga të dhënat më lart, shihet se komuna e Rahovecit ka investuar dhe rregulluar mjaft shumë në rrjetin e ndriçimit publik. Megjithatë, komuna e Rahovecit që t'i ofrojë banorëve lëvizje të sigurtë, është duke vazhduar ta rregullojë rrjetin e ndriçimit publik aty ku ka nevojë, si në vendbanimet e mëdha dhe të dendura ashtu edhe në qendrat sekondare.

<sup>30</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2013-2023, fq.116.

<sup>31</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 55.



## FURNIZIMI ME UJË

- Qytetarët e komunës së Rahovecit furnizohen me ujë të pijshëm nëpërmjet tri formave:


- Sistemit qendror të furnizimit - ujësjellësi i KRU Gjakova
- Sistemet e vogla - ujësjellësit lokal (sistemi i pompimit), dhe
- Puset individuale.

Komuna e Rahovecit nuk ka sistem shumë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes. Ujësjellësi kolektiv shtrihet në 81% të komunës (29 vendbanime), ndërsa 19% (7 vendbanime) kanë mungesë. Sipas të dhënave zyrtare të komunës, numri i ekonomive familjare të kyçura në ujësjellës është 11,836.

Megjithatë, furnizimi i banorëve të komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm është i kënaqshëm. Mirëpo, konsiderohet që në fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit, sidomos gjatë periudhës së nxehjtë, uji i pijes keqpërdorët edhe për ujitjen e tokave.

Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit (të ujërave të zeza dhe ujërave të shiut) në komunën e Rahovecit menaxhohet nga KRU Gjakova.<sup>32</sup> Në vitin 2020 është përmbyllur projekti i pompave të ujit të pijshëm në fshatin Pastasel.<sup>33</sup> Megjithatë, mbetet sfidë furnizimi me ujë të pijshëm përvendbanimet që ende nuk kanë (Mrasor, Kaznik dhe Zatriq).<sup>34</sup>

**Graf. 14** Furnizimi me ujë në komunën e Rahovecit



Burimi: Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 43

<sup>32</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 41-42.


<sup>33</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovecit, fq. 6.

<sup>34</sup> Po aty, fq. 42.



**KANALIZIMI** - Në komunën e Rahovcit, shumica e vendbanimeve kanë qasje në kanalizim të ujërave të zeza, mirëpo mungon trajtimi i ujërave të zeza. Konsiderohet se 98% e vendbanimeve në këtë komunë kanë qasje në kanalizim.

**Graf. 15** Qasja në sistem të kanalizimit në komunën e Rahovcit



Burimi: Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 43.

Sistemi i kanalizimit të ujërave të ndotura, gjendja e rrjetit të kanalizimit dhe mungesa totale e trajtimit të ujërave të ndotura në komunën e Rahovcit, çon në ndotje të lumenjve, tokës dhe sigurisht edhe ujit nëntokësor. Një ndotje e tillë paraqet kërcënim serioz për shëndetin e popullatës ashtu edhe për mjedisin në tërsi.

Konsiderohet se zgjidhja e këtij problemi do të bëhej me ndërtimin e kolektorëve rreth lumenjve dhe përroskave. Në këtë mënyrë do të eliminohet ndotja e ambientit dhe të gjitha rreziqet që shkaktohen nga ujërat e zeza. Për shkak të konfiguracionit të terrenit nuk mund të përfshihen të gjitha vendbanimet me një kolektor dhe të trajtohen në një impiant. Por, duhet të parashihen tre (3) kolektorë dhe tre (3) impiante për trajtimin e ujërave të zeza që shkarkohen në lumin Drini i Bardh dhe lumenjtë tjera.<sup>35</sup>

Vlen të theksohet se komuna e Rahovcit që nga viti 2018-2019 ka impiantin në Kramovik, i cili ka kushtuar rreth 100,000€ dhe përfshin vetëm fshatin Kramovik me një përqindje jo më të madhe se 5% të territorit të komunës së Rahovcit.

<sup>35</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 46-47.



Po ashtu, është duke investuar në trajtimin e shtretërve të lumenjve në Krushë të Madhe, Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël dhe Nagac. Është duke u bërë edhe trajtimi i përrrenjve në Opterushë, Pataqan i Poshtëm, Malësi e Vogël dhe Pollushë. Ndërsa, problemet me shtretërit e përroskave në Dejnë, Ratkoc, Celinë, Sapniq, Gexhë, Brestoc do t'i adresojë shumë shpejt.<sup>36</sup>

Gjatë vitit 2020 janë përfunduar punimet në rrjetin e kanalizimit në fshatin Dabidol, dy (2) segmente në fshatin Krushë e Madhe, dy (2) segmente në Opterushë dhe dy (2) segmente në Fortesë. Është duke vazhduar shtrirja e kanalizimit në fshatin Bratatin dhe Ratkoc.<sup>37</sup>

**MBETURINAT** - Sasia e mbeturinave e cila grumbullohet brenda një dite sillet 20-30 ton, kurse sipas raporteve të dy kompanive (Ekoregjioni dhe Ekodrinia) që operojnë në komunën e Rahovecit, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës, megjithatë një pjesë e amvisërive nuk pranon të bëjë marrëveshje me operatorët. Pavarësisht mbulueshmërisë prej 100%, prapë haset në deponi ilegale si dhe hudhje të mbeturinave në mënyrë të pakontrolluar. Gjithashtu janë të evidentuara edhe pikat e ndjeshme të ndikimeve mjedisore në këtë komunë me theks të veçantë në sektorin e mbeturinave, sipas raportit për mbeturinat, botuar në vitin 2014 nga Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës (AMMK).

Konsiderohet se sipërfaqja e deponive ilegale në komunën e Rahovecit është rreth 15 ari.

Arsyet kryesore për grumbullimin jo te plotë të mbeturinave janë të ndryshme, si:

- Niveli i ulët i vetëdijes tek një pjesë e banorëve
- Kapacitetet e kufizuara të Ndërmarrjes Publike për menaxhimin e mbeturinave
- Mospagesa e një pjesë të përfituesve të shërbimit
- Moszgjidhja e çështjes së mbeturinave ndërtimore (demolimeve)
- Problemi i pazgjidhur i menaxhimit të mbeturinave nga mbetjet shtazore dhe
- Shkalla e ulët dhe jo-formale e ndarjes dhe riciklimit.<sup>38</sup>

Në vitin 2018 është ndërtuar Deponia e materialeve ndërtimore e cila është në dalje të qytetit të Rahovecit (rrugës për Drenoc), me një sipërfaqje prej rreth 11 ha.

<sup>36</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovecit, fq. 6.

<sup>37</sup> Po aty, fq. 40.

<sup>38</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 60.



**KULTURA** - Trashëgimia kulturore në komunën e Rahovecit nga koha llire e deri më tani është e larmishme, por fatkeqësisht pa mbrojtje të duhur institucionale. Shumë vlera kulturore janë shkatërruar dhe i janë ekspozuar faktorit kohë dhe njeri. Komuna e Rahovecit duhet të kujdeset përveç tjerash, veçanërisht për thesaret e çmuara kulturore si Sahat Kulla në Rahovec, që daton nga viti 1206 (dikur ishte kështjellë e vogël llire), pastaj Kullat e Anadrinit, Kalaja e Durmanit shek. III dhe IV, Kalaja e Kështjellës (Zatriq, Gexhë, Gurkuq) etj.<sup>39</sup>

**Fig. 5** Sahat Kulla, Rahovec



38 monumente.<sup>40</sup>

Komuna e Rahovecit ka trashëgimi të pasur kulturore edhe në aktivitetet sportive që zhvillojnë të rintjtë e të rejat e komunës, si në Palestrën Sportive-Rahovec, e cila është funksionalizuar që nga viti 2018. Po ashtu, edhe fushat tjera sportive nëpër vendbanimet tjera.

Gjatë vitit 2020 është bërë riparimi i Shtëpisë së Kulturës në fshatin Ratkoc. Po ashtu, është në përfundim ndërtimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore në fshatin Dejnë<sup>41</sup>

Në Komunën e Rahovecit janë gjithsej 70 objekte të evidentuara gjatë viteve 2002-2003, si objekte të trashëgimisë kulturore. Në listën e fundit të Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme (2015-2016) janë përfshirë 18 monumente në kategorinë *Trashëgimia Arkeologjike* dhe 20 monumente në kategorinë *Trashëgimia Arkitekturore*, duke e rritur numrin në gjithsej

<sup>39</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2013-2023, fq.78.

<sup>40</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 119.

<sup>41</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovecit, fq. 8.




**PROFILI EKONOMIK I KOMUNËS SË RAHOVECIT** - Kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike kanë ndikuar që bujqësia, vreshtaria dhe veraria të janë aktivitetet themelore ekonomike në komunën e Rahovecit. Dhe kjo në të gjitha aspektet, duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin.<sup>42</sup>

Territori i komunës së Rahovecit zë sipërfaqen prej 27,589 ha. Kjo bazuar në digitalizimin e ortofotove dhe dokumenteve tjera, punës në terren, të dhënavë që janë siguruar nga shërbimet zyrtare komunale, si dhe llogaritjeve tona, gjithnjë në kontekstin e shfrytëzimit dhe destinimit të sipërfaqeve në nivelin komunal.<sup>43</sup>

Është më se e rëndësishme të ceket se që nga viti 2018, komuna e Rahovecit ka edhe Zonën Ekonomike me hapësirë prej 35 ha, e cila iu mundëson bizneseve hapësirë dhe kushte më të mira për punë.

**Graf. 16** Shfrytëzimi i tokës (%) në komunën Rahovecit



Burimi: Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 142.

<sup>42</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 27.

<sup>43</sup> Po aty, fq. 142.



Komuna e Rahovcit me tërë historinë e pasur në prodhim të verës dhe tokën pjellore ka potenciale të mëdha për zhvillime në të ardhmen. Edhe pse industria e verës është vetëm një pikë në sektorin e bujqësisë së Kosovës, është potencial për të hyrë në tregjet evropiane ku kërkesa për verëra të importuara është e madhe. Rrjedhimisht, zhvillimi ekonomik i Kosovës është fuqimisht i ndërlidhur me zhvillimet në komunën e Rahovcit. Andaj, zhvillimi ekonomik në komunën e Rahovcit është i orientuar me së shumti në bujqësi, vreshtari dhe perimkulturë. Rreth 65% e popullatës është vlerësuar që sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Mesatarja vjetore e të ardhurave për një fermer është përafërsisht 2,500-3,000€. Komuna plotësisht përfiton nga kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike, ku 13,000 ha sipërfaqe është tokë punuese, prej te cilave 3,500 ha janë në sistemin e ujitjes. Po ashtu, Rahoveci paraqet bazën e prodhimtarisë së pemëve dhe perimeve në Kosovë, me 2,040 ha sipërfaqe me perime, ndërsa 95 ha me pemë.



Me të kaluarën e vet të pasur në prodhim të verës dhe me tokën bujqësore pjellore, ka potencial të theksuar për zhvillim në të ardhmen. Rahoveci është komunë kryesisht bujqësore, ngase rreth 2/3 e banorëve të kësaj komune jetojnë në fshatrat e saj.

Komuna e Rahovcit disponon me rreth 50% të sipërfaqeve të vreshtave të Kosovës si dhe kapaciteteve përpunuese. Popullata e komunës së Rahovcit ka traditë të lashtë në kultivimin e rrushit dhe verës. Në këtë trevë rrushi kultivohet qysh nga koha ilire.<sup>44</sup>


**Ndërmarrjet:** Gjithsej ndërmarrje të regjistruara për periudhën 2000-2018, në komunën e Rahovcit janë 3,215. Prej tyre 2,966 (92.3%) janë aktive dhe 249 (7.7%) janë pasive. Ndërsa, numri gjithsej i punëtorëve në ndërmarrjet aktive është 5,618 (93.9%), ndërsa në pasivet 365 (6.1%). Këto të informata janë paraqitur në grafikun nr. 14.

Ndërsa, sipas Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në komunën e Rahovcit, sot operojnë mbi 3,684 ndërmarrje, prej tyre 50% janë tregtare, 15% e tyre shërbysese, 16% produhuese dhe 19% transportuese.

<sup>44</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2011, fq. 86.



**Graf. 17** Numri i ndërmarrjeve të regjistruara për periudhën 2000-2018, në komunën e Rahovcit



Burimi: Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 24.

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe shuara sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike gjatë vitit 2019 është si në vijim.

**Tab. 4** Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe shuara sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike, 2019

Nr.	SEKTORËT DHE AKTIVITETET EKONOMIKE	REGJISTRUARA	SHUARA
1	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	0	1
2	Xehetari dhe gurëthyes	1	0
3	Prodhim	42	6
4	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	1	0
5	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të	0	0
6	Ndërtimtari	12	2
7	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	32	21
8	Transport dhe ruajtje	5	0
9	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	15	2
10	Informacion dhe komunikim	2	0
11	Aktivitete financiare dhe sigurimit	0	0
12	Aktivitete të patundshmërisë	0	0
13	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	7	2
14	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	5	0
15	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	0	2
16	Arsim	0	1
17	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	1	1
18	Art, zbavitje dhe rekreacion	0	1
19	Aktivitete të shërbimeve tjera	7	3
<b>Gjithsej</b>		<b>130</b>	<b>52</b>

Burimi: ASK: Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2020, fq. 191.



Numri në rritje i bizneseve nuk ka reflektuar në përmirësimin e dukshëm të ekonomisë së komunave dhe uljen e papunësisë për shkak se shumica e bizneseve janë me veprimtari jo prodhuese.<sup>45</sup>

**Bujqësia:** Sipas dhënave nga ASK-ja, komuna e Rahovecit disponon me 13,600 ha tokë bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore që gjendet përgjatë shtratit të lumbardit Drini i Bardhë në lartësi mbidetare prej 310-350 m, është tokë *aluviale* me pjellori të lartë, në të cilën kultivohen kulturat bujqësore intensive siç janë: perimkultura (speci, domatja, patatja, trangulli, shalqiri, karrota etj.) dhe kulturat lavërtare (gruri dhe misri). Në tokat kodrinore në lartësi mbidetare prej 350-600 m është toka e llojit *smonice*, ku kultivohen kulturat lavërtare pranverore dhe vjeshtore, pastaj kulturat shumëvjeçare si kullosat.

Kulturat e drithërave zëne sipërfaqe totale prej 3,586 ha, ku kultura e grurit dominon me sipërfaqe prej 1,929 ha, pas saj vjen kultura e misrit me 1,602 ha. Ndërsa, kulturat e perimore zënë sipërfaqe totale prej 2,040 ha, ku kultura e specit dominon me sipërfaqe prej 830 ha, pas saj vjen kultura e kungullit të misrit me 319 ha, kultura e patates me 227 ha, kultura e shalqirit me 205 ha dhe kultura e qepës me 188 ha.

Sipas të dhënave statistikore nga ASK, në vitin 2014 komuna e Rahovecit posedonte gjithsej 5,750 traktorë. Prej tyre, 1,310 (22.8%) me vjetërsi 0-10 vjet dhe 4,440 (77.2%) mbi 10 vjet. Siç shihet, kemi problem me vjetërsim të mjeteve të punës.

Sipas planit zhvillimor komunal në këtë komunë për periudhën 2018-2026, priorititet që duhet dhënë bujqësisë janë: mbrojtja dhe prodhimi i bimëve, transformimi i fermave të vogla familjare në ato të mëdha komerciale, shfrytëzimi i praktikave të reja bujqësore dhe aplikimi i tyre, përmirësimi i produktivitetit dhe rritjes së rendimentit përmes përdorimit të hibrideve dhe varieteteve me potencial të lartë biologjik, fillimi i programeve afatgjate në ndërtimin e kapaciteteve, ofrimi i mbështetjes institucionale, ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe përkrahjes teknike.



<sup>45</sup> Strategjinë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 22.



Vlen të theksohet se në vitin 2018 për herë të parë është aprovuar buxheti prej 1,028,000€ për bujqësi.

Në mënyrë që t’iu ndihmohet fermerëve dhe bujqeve të komunës së Rahovecit, komuna e Rahovecit në vitin 2019 dhe 2020 për herë të parë filloi me ndarjen e mekanizmave bujqësorë dhe vazhdon edhe sot. Gjatë vitit 2019 janë përzgjedhur 738 përfitues të të gjithë sektorëve bujqësorë, të cilëve u janë shpërndarë 12 lloje te mekanizmave bujqësorë. Ndërsa, gjatë vitit 2020 janë përzgjedhur gjithsej 800 përfitues të të gjithë sektorëve bujqësorë, të cilëve u janë shpërndarë 12 lloje te mekanizmave bujqësorë.

Gjithashtu, komuna e Rahovecit është duke i mbështetur vazhdimisht buqjt me ngritjen e serave, ndërtimin e stallave dhe ndarjen e koshereve të bletëve.<sup>46</sup> Gjatë vitit 2018 janë përzgjedhur 123 përfitues të serrave, ndërsa gjatë vitit 2019 janë përzgjedhur 247 përfitues të tyre. Sot, në komunën e Rahovecit janë të mbuluara rreth 50 ha me serra.

Po ashtu, gjatë vitit 2019 janë ndërtuar 14 stalla në sektorin e blegtorisë, 11 stalla për lopë qumështore dhe 3 stalla në sektorin e shpeztarisë. Gjatë vitit 2019 janë ndarë edhe 527 koshere të bletëve.

Infrastruktura në bujqësi konsiderohet e mirë. Megjithatë, komuna e Rahovecit po punon vazhdimisht në rregullimin e rrugëve fushore në tërë territorin e komunës, ku një pjesë e madhe e këtyre rrugëve janë rregulluar. Duhet theksuar se në vitin 2020 komuna e Rahovecit ka investuar në ndërtimin e kanaleve të kullimit në Xërxe, Ratkoc-Gexhë, Malësi e Vogël.<sup>47</sup>

**Vreshtria:** Me rreth 2,416 ha, si dhe përpunimin e saj të verës komuna e Rahovecit dallohet në Kosovë dhe rajon. Kultivohet edhe rrushi i tryezës. Faktorët fiziko-natyrorë janë të përshtateshim për kultivimin e kësaj kulture. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të kultivuara është më tepër në viset kodrinore me ekspozicion të kthyer kah lindja. Cilësia e rrushit është i standardit të lartë.<sup>48</sup> Sipas të dhënave të fundit nga departamenti përkatës në komunën e Rahovecit, sipërfaqe të mbjellura me vreshta në komunën e Rahovecit janë 2,477 ha. Prej tyre, 1,943 ha janë sipërfaqe me vreshta të rrushit të verës, ndërsa 534 ha sipërfaqe me vreshta të rrushit të tryezës.

<sup>46</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovecit, fq. 6.


<sup>47</sup> Po aty, fq. 50.

<sup>48</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2011, fq. 76.



Sipas të dhënave statistikore nga ASK (2014), 51.3% e ekonomive bujqësore në komunën e Rahovecit merren me kultivimin e rrushit për verë, ndërsa 48.7% e tyre me kultivimin e rrushit për tryezë. Më gjerësisht, shih grafikun në vijim.

**Graf. 18** Vreshtat sipas kategorisë në Komunën e Rahovecit



Burimi: ASKDATA: *Vreshtat sipas komunave, 2014.*

**Prodhimi i verës:** Para vitit 1999, prodhimtaria vjetore ka qenë deri në 12.5 milion €, me kapacitet të përpunimit prej 30,000-40,000 ton të rrushit dhe 10 milion litra verë në vit. Para vitit 1990, 80% e prodhimeve të fabrikës janë eksportuar në tregjet e Evropës, SHBA dhe Kanadë. Në vitin 2001 është arritur një marrëveshje me kompani private gjermane për eksportin e 200,000 litrave të verës për 5 vitet e ardhshme, duke filluar nga viti 2002.

Kapacitetet për prodhimin e verës janë 50 mil. litër/vjet; për ruajtjen e verës 500,000 hektolitër/vjet, përderisa prodhimi i verës në vitin 2003 ishte 4.8 milion litër, 1.1 milion litër në vitin 2004. Prodhimi i rrushit në vitin 2003 ishte 7.3 milion kg ndërsa në vitin 2004 ishte 2.4 milion kg. Vreshtat në pronësi të furnizuesve privatë janë rreth 2,500 ha. Sipas të dhënave të fundit, në komunën e Rahovecit prodhohen rreth 5 milion verë në vit.

Kapaciteti për prodhim të verës së bardhë "Brnjaka-I" është e ndërtuar në vitin 1975, me bodrum të kapacitetit 18 milion litër, 2 njësi për grumbullim të rrushit, 16 njësi për fermentim, pjesën për distilim, për zbrasje në shishe, linjën e paketimit dhe laboratorin. "Brnjaka-II" e ndërtuar në vitin 1982 për verë të kuqe është e kapacitetit të bodrumit 18 milion litër, përfshirë dhe 5 milion litër



për deponim në fuqi të drurit, 4 njësi për mbledhjen e grumbullimin e rrushit, 48 njësi për fermentim, 25 vagonë/njësi.<sup>49</sup>

**Blegtoria:** Konsiderohet lëmi tjetër kyçe e bujqësisë në komunën e Rahovecit. Ka karakter ekstensiv, pasi që kultivohet në numër të vogël nga fermerët. Riten tri lloje të gjedheve, ku raca më e shpeshtë quhet *Bushë* e cila është më pak produktive në qumësht se sa të tjerat. Prej blegtorisë kultivohen: gjedhet, delet, dhitë, kuajt, buallicat, etj. Kohëve të fundit ka tendencë të kalimit të kësaj dege të bujqësisë në blegtori intensive, me përmirësimin e racës së gjedhit, me racë simentale, montafone etj. Për mbarëvajtjen e blegtorisë në komunën e Rahovecit kujdeset stacioni i veteranës në Rahovec që nga viti 1960.

Sipas të dhënave nga ASK (2014), komuna e Rahovecit në vitin 2014 ka numëruar gjithsej 9,854 gjedhe, 7,102 dele, 1,049 dhi, 122 derra, 51 kuaj, gomarë dhe mushka dhe 13 buallica. Ndërsa, 3,992 koshere bletësh.

Vlen të theksohet së në shtator 2020 për herë të parë është bërë thirrja nga komuna e Rahovecit për Komore ftohëse dhe nga kjo thirrje kanë përfituar 16 aplikantë. Ndërsa, Laktofriz kanë përfituar 39 aplikantë. Po ashtu, gjatë vitit 2020 komuna e Rahovecit ka filluar përkrahjen e blegtorëve me ndërtimin e stallave.<sup>50</sup> Në komunën e Rahovecit sot janë rreth 180 stalla të blegtorisë.

**Shpeztaria:** Është po ashtu e karakterit ekstensiv. Përveç pulës e cila kultivohet më shumë, llojet tjera të shpezëve janë të pakta. Disa prej tyre mund të hasen në natyrë në formë të egër.

Sipas të dhënave dhe statistikave nga ASK (2014), komuna e Rahovecit në vitin 2014 ka numëruar gjithsej 129,413 shpezë. Prej tyre, pula për vezë 93,866 (72.6%), zogj, pula dhe gjela 29,821 (23%), zogj për majmëri 2,745 (2.1%), biba 1,087 (0.8%), rosa dhe patë 722 (0.6%) dhe të tjera 1,172 (0.9%).

**Pylltaria:** Mbrotja pyjeve nga prerjet e pa kontrolluara, si dhe shfrytëzimi dhe ripyllëzimi i hapësirave pyjore është detyrë e institucioneve përgjegjëse. Këto zona kanë atraktivitet peizazhor dhe turistik.

Ripyllëzimi i kontrolluar zëvendëson drunjë e prerë duke ruajtur ekosistemin. Dëmtimet në një shkallë të gjerë ndaj ekosistemave pyjore ndodhin si rezultat i prerjeve ilegale. Për ripyllëzim përdoren një sërë metodash të cilat synojnë jo vetëm të zëvendësojnë ato masa drusore të prera

<sup>49</sup> Po aty, fq. 30.


<sup>50</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovecit, fq. 6-8.



por edhe të ruajnë biodiversitetin. Në të gjitha programet e ripyllëzimit kujdes i veçantë i kushtohet konservimit pyjor.<sup>51</sup>

Sipërfaqja e tërësishme pyjore në komunën e Rahovcit është 7,692 ha. Prej tyre, 4,560.9 ha (59.3%) pyje cungishte, 3,094 ha (40.2%) shkurre dhe sipërfaqe jo prodhuese dhe vetëm 37.1 ha (0.5%) pyje artificiale.

**Graf. 19** Sipërfaqja e tërësishme pyjore sipas kategorive në komunën e Rahovcit



Burimi: Plani zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 33.

Duhet theksuar se komuna e Rahovcit ka mbjellur 7,000 drunj gjatë vitit 2020 dhe vazhdon të mbjellë në vendbanime të ndryshme të komunës.<sup>52</sup> Po ashtu, plani operativ për pyllëzimin e sipërfaqeve të reja parashevë të mbillen 20 ha me pyje të reja si: Pishë e zezë, Bung dhe Dushk.<sup>53</sup>

**Turizmi:** Është më pak i zhvilluar, edhe pse Rahoveci është njëri ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire. Resurse për një turizëm rekreativ ekzistojnë në kanjonin e Drinit të Bardhë, në Majën e Shkodranit (shtegu i ecjes) në Rahovec, pastaj Obelisku në Gradish, kulla e heronjeve Toni e Mici në Opterush. Kjo e fundit është në përfundim e sipër.

Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm kulturor arkeologjik, shpella, hamame, trashëgimi arkitekturore dhe fetare në Hoçën e Madhe, e cila tashmë është edhe e mbrojtur me pakon e Ahtisarit nga e cila derivon dhe Ligji për Mbrojtjen e Zonave të Veçanta të Mbrojtura. Në hartim e sipër është edhe Ligji për Hoçën e Madhe.

<sup>51</sup> Plani zhvillimor komunal Rahovec, 2011, fq. 187.

<sup>52</sup> Raporti vjetor i punës, janar-dhjetor, 2020. Komuna e Rahovcit, fq. 8.

<sup>53</sup> Po aty, fq. 52.



Në qendër të qytetit janë të vendosura shumë monumente historike të ndërtuara para 400 vitesh.<sup>54</sup>

**BUXHETI KOMUNAL** – Disa nga vështirësítë që janë përballur komunat janë: mungesa e një fondi adekuat qendoror pér investime kapitale të nxitur nga projektet i cili do të menaxhohej nga qeveria sipas një sistemi të unifikuar, mungesa e një tregu kreditor që do t'i mundëson komunave qasjen në fonde pér zhvillim me kamata të ulëta, mungesa e mekanizmit pér fondet pér emergjencë të paparashikuara. Ekziston një dallim i madh ndërmjet kapacitetit ekonomik të komunave, pér gjenerimin e të hyrave vetanake (mesatarisht 18%) dhe i grantit nga Buxheti i Kosovës (mesatarisht 82%).<sup>55</sup>

Edhe buxheti i komunës së Rahovecit sigurohet nga dy burime kryesore: grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Buxheti i komunës pér vitin 2021 është 14,548,823.0 €. Nga qeveria qendrore janë siguruar 13,391,982.0 €, ndërsa nga të hyrat vetanake janë planifikuar të sigurohen 1,156,841.0 €.

Komuna e Rahovecit vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë rreth 90% të buxhetit total të komunës.<sup>56</sup> Më detajisht shih tabelën në vijim.

**Burimet e financimit:** Përbëhen nga të hyrat vetanake të komunës, grantet qeveritare, grantet e donatorëve të jashtëm dhe huamarria komunale.

Të hyrat vetanake komunale janë mjetet financiare që mbidhen nga taksat, tarifat, gjobat, pagesat pér shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, ato nga ndërmarrjet komunale, bashkë pagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj.<sup>57</sup> Në komunën e Rahovecit, të hyrat vetanake në vitin 2020 ishin 1,156,841.0 €.

Komunat pranojnë grante operative nga Buxheti i Konsoliduar i Republikës së Kosovës. Grantet operative janë: grantet e përgjithshme, grantet specifike pér arsim dhe grantet specifike pér shëndetësi. Në vitin 2020, gjithsej granti qeveritar



<sup>54</sup> Më gjërësisht, shih: Planin zhvillimor komunal Rahovec 2018-2026 - draft -, fq. 35.

<sup>55</sup> Strategjinë pér vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 23.

<sup>56</sup> Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Rahovecit 2021-2023, faqe 12.

<sup>57</sup> Ligji nr. 03/I-049 pér financat e pushtetit lokal.




për komunën e Rahovecit ishte 13,578,978.0€. Prej tyre, granti i përgjithshëm 5,843,393.0 € ose shprehur në përqindje 43.0% e grantit qeveritar, granti i arsimit 5,820,978.0 € (42.9%), granti i shëndetësisë 1,889,703.0 € (13.9%) dhe Këshilli i Hoçës së Madhe 24,904.0 € (0.2%).

**Tab. 5** Burimet e financimit në komunën e Rahovecit (€), periudha 2021-2023

BURIMI I TË HYRAVE	2020	Vlerësimi 2021	Vlerësimi 2022	Vlerësimi 2023
Granti i përgjithshëm	5,843,393.0	5,670,142.0	6,017,246.0	6,396,041.0
Granti i arsimit	5,820,978.0	5,745,764.0	6,223,738.0	6,250,657.0
Granti i shëndetësisë	1,889,703.0	1,951,048.0	2,590,376.0	2,603,328.0
Këshilli i Hoçës së Madhe	24,904.0	25,028.0	25,028.0	25,028.0
<b>Gjithsej granti qeveritar</b>	<b>13,578,978.0</b>	<b>13,391,982.0</b>	<b>14,856,388.0</b>	<b>15,275,054.0</b>
<b>Gjithsej të hyrat vetanake</b>	<b>1,156,841.0</b>	<b>1,156,841.0</b>	<b>1,311,975.0</b>	<b>1,384,365.0</b>
<b>GJITHSEJ BUXHETI</b>	<b>14,735,819.0</b>	<b>14,548,823.0</b>	<b>16,168,363.0</b>	<b>16,659,419.0</b>

Burimi: Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Rahovecit 2021-2023, faqe 11.

**Graf. 20** Mesatarja e burimeve të financimit në komunën e Rahovecit (%), periudha 2021-2023



Bazuar në të dhënat e tabelës 5, kemi kalkuluar mesataren e grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake për periudhën 2021-2023 dhe ka rezultuar si në vijim: Mesatarisht 92% e buxhetit të komunës së Rahovecit bazohet në grantin qeveritar dhe mesatarisht 8% në të hyrat vetanake.

Ky rezultat vë në pah se kjo komunë varet mesatarisht 10% më shumë nga Buxheti i Kosovës se sa komunat tjera.

Burimi: Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Rahovecit 2021-2023, faqe 11.

**Tab. 6** Struktura e të hyrave vetanake në komunën e Rahovecit (€), viti 2020

STRUKTURA E TË HYRAVE VETANAKE	2020	%
Buxhet dhe financa	626,673.0	54.2%
Ekonomi dhe zhvillim	163,600.0	14.1%
Administratë dhe personel	97,568.0	8.4%
Kadastër dhe gjeodezi	71,250.0	6.2%
Shërbime publike	63,300.0	5.5%
Bujqësi dhe zhvillim rural	55,300.0	4.8%
Shëndetësi dhe mirëqenie sociale	41,000.0	3.5%
Urbanizëm	22,450.0	1.9%
Arsim dhe shkencë	9,900.0	0.9%
Kulturë, rini dhe sport	3,800.0	0.3%
Inspeksion	2,000.0	0.2%
<b>GJITHSEJ</b>	<b>1,156,841.0</b>	<b>100.0%</b>

Burimi: Adaptuar nga: *Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Rahovecit 2021-2023, faqe 11-12.*


Në tabelën e mësipërme është paraqitur struktura e të hyrave vetanake të komunës në vitin 2020. Siç shihet në tabelën e mësipërme, 54.2% e të hyrave vetanake në komunën e Rahovecit janë nga tatimet në pronë, tatimet në tokë, taksat rrugore etj. Ndërsa, 14.1% nga kategoria *ekonomi dhe zhvillim* si licenca të lira individuale, licenca tjera për afarizëm, qiraja nga objektet publike si dhe taksat tjera administrative. Nga kategoria *administratë dhe personel*, saktësisht nga taksat e certifikatave të lindjes, kurorëzimit, vdekjes, si dhe taksave tjera administrative janë rrëth 8.4%. Pjesa e mbetur shpërndahet në kategoritë tjera si *kadastër dhe gjeodezi, shërbime publike, bujqësi dhe zhvillim rural, shëndetësi dhe mirëqenie sociale* etj.

**Struktura e shpenzimeve:** Siç shihet në vijim, shpenzimet rrjedhëse përbëjnë 73.5% të shpenzimeve komunale dhe ato kapitale vetëm 26.5%. Nga shpenzimet rrjedhëse, më të lartat janë ato për paga dhe mëditje 79.8%, pastaj shpenzimet për mallra dhe shërbime 14.7%, subvencionet 2.9% dhe shpenzimet komunale 2.6%.

**Tab. 7** Struktura e shpenzimeve buxhetore në komunën e Rahovecit (€), viti 2020

STRUKTURA E SHPENZIMEVE BUXHETORE	2020	%
Pagat dhe mëditjet	8,644,220.0	79.8%
Mallrat dhe shërbimet	1,594,330.0	14.7%
Shpenzimet komunale	280,500.0	2.6%
Subvencionet	311,000.0	2.9%
<i>Gjithsej Shpenzime rrjedhëse</i>	<b>10,830,050.0</b>	<b>100.0%</b>
<b>Shpenzime rrjedhëse</b>	<b>10,830,050.0</b>	<b>73.5%</b>
<b>Shpenzimet kapitale</b>	<b>3,905,770.0</b>	<b>26.5%</b>
<b>GJITHSEJ SHPENZIME KOMUNALE</b>	<b>14,735,820.0</b>	<b>100.0%</b>

Burimi: Adaptuar nga: *Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Rahovecit 2021-2023, faqe 16.*

**Graf. 21** Struktura e shpenzimeve në komunën e Rahovecit (%), viti 2020

Burimi: Adaptuar nga: *Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Rahovecit 2021-2023, faqe 16.*



### 3. ANALIZA SWOT

Miratimi i një vendimi për investime në komuna, kërkon një rishikim gjithëpërfshirës të faktorëve që kontribuojnë ose pengojnë këtë zhvillim. Një nga veglat për të siguruar besueshmërinë e planeve dhe programeve strategjike për zhvillimin e komunave është analiza SWOT. Në këtë drejtim, analiza SWOT vepron si një mjet për marrjen e vendimeve menaxheriale mbi zbatimin e strategjive të investimeve në komunë.

Analiza SWOT në përgjithësi është një analizë e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm. Mjedisi i jashtëm i komunës është një analizë e mundësive “O” dhe rreziqeve “T” që dalin nga mjedisi i jashtëm i komunës. Mjedisi i brendshëm është një analizë e anëve të forta “S” dhe të dobëta “W” të vetë komunës. Bazuar në rezultatet e analizës, është e mundur të vlerësohet nëse komuna ka përparësi dhe burime të brendshme për të realizuar mundësitë në dispozicion dhe për t’iu ikur rreziqeve, dhe cilat mangësi të brendshme kërkojnë eliminim të shpejtë.

Përkitazi me atë që u tha më lart, vlerësimi i përbledhës i gjendjes së komunës së Rahovecit është bërë duke përdorur analizën SWOT. Komuna e Rahovecit ndikohet nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, qoftë pozitiv apo negativ. Faktorët e brendshëm pozitiv cilësohen si përparësi kurse ata negativ si dobësi. Ndërsa, faktorët e jashtëm cilësohen si mundësi të ofruara që duhet shfrytëzuar, përkatësisht rreziqe, të cilat komuna duhet t’i ketë parasysh dhe t’iu shmanget.

Në vijim janë prezantuar në matricë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e dala nga analiza e mësipërme e vlerësimit të gjendjes aktuale në komunën e Rahovecit. Renditja e tyre është bërë krahas informatave të nxjerra sipas rrjedhës së renditjes të pjesëve të analizuara.


Nëse e analizojmë në aspektin numerik, janë përbledhur trembëdhjetë (13) përparësi, dymbëdhjetë (12) dobësi, dhjetë (10) mundësi dhe nëntë (9) rreziqe.






## PËRPARËSITË

- Ka pozitë të mirë gjeografike
- Struktura moshore e popullsisë e re
- Lidhje të mira të komunikacionit rrugor
- Transport të mirë publik
- Shquhet për trashëgimi të pasur kulturore dhe arkeologjike
- Kushte të favorshme klimatike për zhvillim të bujqësisë, vreshtarisë, permtarisë, pemtarisë etj.
- Tokë pjellore
- Ambient i përshtatshëm për biznese
- Shquhet për traditë shumëvjeçare të kultivimit të rrushit dhe prodhimit të verës
- Traditë shumëvjeçare të eksportimit të verës
- Lehtësimet në regjistrimin e bizneseve të reja
- Ndriçim i mirë publik
- Inkasim i kënaqshëm i të hyrave vetanake komunale



## MUNDËSITË

- Përkrahja e të rinjve me arsimim të lartë adekuat
- Zhvillimi i turizmit meqë ka numër të madh të objekteve të trashëgimisë kulturore
- Peizazhe dhe resurse të përshtatshme për pushim rekreacion, me potencial të zhvillimit të integruar
- Shfrytëzimi i praktikave të reja bujqësore dhe aplikimi i tyre
- Mundësia e fondevë të BE-së për zhvillim
- Shfrytëzimi i skemave të granteve
- T'i ipet prioritet degës së vreshtarisë, permtarisë dhe pemtarisë
- Prodhimet bujqësore, produktet e gatshme ushqimore si dhe prodhimet e rrushit kanë predispozita të depërtojnë dhe plasohen në tregun Evropian
- Nxitja e investimeve të huaja direkte duke ofruar lehtësira në shërbimet komunale
- Partneriteti publiko privat



## DOBËSITË

- Migrimi kombëtar dhe ndërkombëtar
- Përqindje e ultë e të diplomuarve
- Shkallë e lartë e varfërisë
- Shkallë e lartë e papunësisë
- Rrugët e pa kategorizuara jo të mira
- Territori i komunës nuk është i mbuluar tërësisht me shërbime të internetit.
- Shumica e bizneseve aktive janë në sektorin e tregtisë apo në veprimitari jo prodhuase
- Buxheti i vogël i komunës
- Dallim i madh ndërmjet kapacitetit ekonomik të komunave, për gjenerimin e të hyrave vetanake dhe i grantit nga Buxheti i Kosovës
- Mungesë e koordinimit ndërmjet programeve të universiteteve dhe nevojës së tregut
- Kapital i pamjaftueshëm për biznese
- Promovimi pamjaftueshëm i rajonit te investitorët



## RREZIQET

- Rënje e nivelit të arsimimit nga viti në vit
- Mostrajtimi i ujërave të zeza paraqet kërcenim serioz për shëndetin e popullatës ashtu edhe për mjedisin e komunës në tërësi
- Ndërtimë ilegale në toka produktive
- Degradimi i tokave bujqësore përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë
- Eksplotimi i pakontrolluar i resurseve natyrore
- Burime të pafavorshme të financimit, përkatësisht interesë i lartë i kredive dhe kapitali i investimit nuk ekziston
- Mos mbështetje e vazhdueshme në përtëritjen e teknologjisë së vjetësuar
- Ndotja e mjedisit nga mbeturinat e përziera





## 4. VIZIONI, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

### VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT KYIE


Vizioni i komunës, misioni organizativ dhe vlerat kyçe janë elemente thelbësore të ngulitura në të gjithë kornizën për përsosmërinë e performancës në komunën e Rahovecit. Si pjesë e profilit komunal është vizioni i komunës që pasqyron cilësinë ideale të jetës për t'u arritur, si dhe misioni i vazhdueshëm i komunës në mbështetje të realizimit të këtij vizioni. Për të mbështetur misionin dhe arritjen e vizionit të komunës, qëllimet dhe objektivat vendosen përmes proceseve të planifikimit strategjik. Vlerat thelbësore mbështesin këto qëllime dhe objektiva, gjithashtu lidhin së bashku dhe përforcojnë të gjitha vendimet dhe veprimet themelore operacionale.

Në vijim janë prezantuar vizioni dhe misioni i komunës së Rahovecit.





Për ta arritur vizionin e komunës, kërkohet të ekuilibrohen nevojat konkuruese të mjedisit, zhvillimit ekonomik dhe komunitetit, duke zhvilluar një bazë të fortë ekonomike, krijuar vende të reja të punës, tërhequr investime të huaja, rritur numrin e bizneseve të reja dhe mbështetur në zgjerim bizneset ekzistuese lokale, krijuar lidhje ekonomike produktive midis komunës së Rahovecit dhe ekonomisë rajonale dhe më gjërë, përmirësuar dhe zhvilluar aftësitë e resurseve njerëzore për të marrë pjesë në zhvillim ekonomik, njojur dhe mbrojtur vlerat e larmishme dhe të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në komunë dhe siguruar mundësitet për të krijuar dhe mbajtur një komunitet koheziv, të sigurt dhe të fortë.





## QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Për të mbështetur misionin dhe arritjen e vizionit të komunës, qëllimet strategjike dhe objektivat specifike vendosen përmes proceseve të planifikimit strategjik.

Pra, përcaktimi i qëllimeve strategjike paraqet hapin e mëtejmë dhe më specifik drejt arrijes së vizionit, gjithmonë duke i pasur parasysh çështjet e identikuara, nevojat dhe kërkesat, si dhe potencialet mundshme në dispozicion. Më pastaj çdo qëllim specifikohet me objektiva ose nën qëllime, të cilat deshifrohen tutje nëpërmjet projekteve të propozuara për implementim.

Çështjet kryesore me të cilat përballet komuna e Rahovecit janë përqendruar në gjashtë tema, të cilat janë shndërruar në qëllime strategjike për zhvillim ekonomik lokal të komunës së Rahovecit.

- **Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik** (zhvillimi i një ekonomie të ekuilibruar lokale dhe mundësive lokale të punësimit për banorët, nevoja për të mbështetur dhe forcuar bizneset ekzistuese dhe të reja, tërheqja e investimeve të huaja direkte, rritja e eksportit, fuqizimi i gruas ndërmarrëse, mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore, zhvillimi i turizmit vendor, nxitja e inovacionit nëpërmjet partneritetave publiko-private).
- **Përmirësim i kushteve të jetesës së banorëve** (investimi në infrastrukturë, trajtimi i ujërave të zeza, përmirësimi i ndriçimit publik, shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, shtrirja e shërbimeve të internetit në zonat e pambuluara).
- **Ngritje dhe përmirësim i cilësisë së arsimit** (ngritia e kapaciteteve në planifikim strategjik dhe monitorim, përmirësimi i cilësisë në menaxhim të arsimit dhe mësimdhënie, renovim dhe ndërtimi shkollave/kopshteve, investim në infrastrukturë dhe teknologji informative bashkëkohore).
- **Përmirësim i ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale** (renovim dhe ndërtim i objekteve shëndetësore, përmirësimi i kushteve të banimit për rastet sociale).
- **Zhvillim i resurseve njerëzore nëpërmjet arsimimit adekuat dhe trajnimeve profesionale** (përgatitja e banorëve që të kenë sukses në punësim lokal).
- **Mbrojtje dhe ruajtje të mjedisit** (mbrojtja e pyjeve nga prerjet e pakontrolluara, pyllëzimi që të ruhet ekosistemi, trajtimi i shtretërve të lumenjve, moslejimi i ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore, ruajtja e mjedisit, mirëmbajtja dhe përmirësimi i peizazheve ekzistuese të rëndësishme, mbrojtja dhe përmirësimi i zonave dhe vendeve me rëndësi të trashëgimisë kulturore).



Në vijim janë prezantuar qëllimet strategjike, të cilat janë specifikuar më tej në objektiva dhe këto të fundit në projekte të realizueshme.

## Qëllimi strategjik 1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik

**Objktivi specifik 1.1** Përkatja e vazhdueshme e NVM-ve me fokus të veçantë në bujqësi, vreshtari, blegtori etj., deri në fund të vitit 2025.

*Projekti 1.1.1* Përkatja e vazhdueshme e bujqve në kosto të derivateve, farërave, plehrave artificiale dhe materialeve tjera ndihmëse.

*Projekti 1.1.2* Mbështetje në sigurimin e kredive me norma më të ulëta të interesit për bujqësi, vreshtari, blegtori etj.

*Projekti 1.1.3* Mbështetja e NVM-ve nëpërmjet uljes së taksave për 25%.

*Projekti 1.1.4* Mbështetje financiare fermerëve në shtimin e fondit blegtoral për 10%.

*Projekti 1.1.5* Mbështetje financiare fermerëve në ngritjen e serave për kultivimin e perimeve.

*Projekti 1.1.6* Mbështetje financiare fermerëve në përpunim të prodhimeve bujqësore.

*Projekti 1.1.7* Mbështetje financiare kultivuesve të rrushit.

*Projekti 1.1.8* Mbështetje financiare në teknologji adekuate për përpunimin e rrushit dhe verës.

*Projekti 1.1.9* Marrëveshje në nivel komunal me zinxhirët kryesorë të marketeve/tregjeve për plasimin e produkteve të ndërmarrësve lokalë duke aplikuar lehtësira të hyrjes në treg, pagesave, pra të trajtohen veçantë si prodhues vendor.

*Projekti 1.1.10* Organizimi i trajnimeve profesionale duke marrë për bazë nevojat e tyre. Paraprakisht mund të përcaktohen priorititetet nëpërmjet realizimit të një sondazhi.

*Projekti 1.1.11* Përkatja e tyre nëpërmjet ofrimit të ndihmës për ndërrimin e mjeteve të vjetërsuara të punës, sidomos mekanizmave bujqësorë.



**Projekti 1.1.12** Organizimi i panaireve me qëllim të promovimit të prodhimeve lokale.

**Objektivi specifik 1.2** Nxitja e investimeve të huaja direkte dhe tërheqja e së paku 8 milion € investime të huaja direkte deri në fund të vitit 2025.

**Projekti 1.2.1** Evidentimi i investorëve të huaj aktual sipas veprimtarisë, numrit të punëtorëve, qarkullimit deri në qershor të vitit 2021.

**Projekti 1.2.2** Identifikimi i së paku 65 investorëve të huaj potencial, përfshirë edhe diasporën deri në tetor të vitit 2021.

**Projekti 1.2.3** Përzgjedhja e së paku 25 investorëve të huaj direkt dhe krijimi i kontakteve me ta, deri në dhjetor të vitit 2021.

**Projekti 1.2.4** Organizimi i së paku tri konferencave ku ftohen investorët potencialë dhe krijohen lidhjet për nxitje të investimeve të mundshme në komunë, deri në qershor të vitit 2022.

**Objektivi specifik 1.3** Nxitja e krijimit të së paku 450 bizneseve të reja të qëndrueshme deri në fund të vitit 2025.

**Projekti 1.3.1** Organizimi dhe ofrimi i trajnimeve për menaxhim, ndërmarrësi, lidership për të interesuarit për krijuarit të bizneseve të reja, çdo vit në periudhë tremujore.

**Projekti 1.3.2** Hulumtim mbi nevojat dhe kërkesat e të interesuarve për aplikim dhe procedura përcjellëse, për fitimin e granteve dhe mbështetjen e ideve të reja, çdo vit në periudhë tremujore.

**Projekti 1.3.3** Promovimi i bizneseve të reja të krijuara brenda vitit, nëpërmjet organizimit të panaireve dhe organizimit të degustimit të produkteve të tyre.

**Projekti 1.3.4** Ofrimi i konsulencave për biznes në mënyrë të vazhdueshme (sipas nevojës së paraqitur) për bizneset e reja.

**Objektivi specifik 1.4** Rritja e eksportit të produkteve vendore për 25% deri në fund të vitit 2025 (5% për vit).

**Projekti 1.4.1** Evidentimi i eksportit aktual sipas veprimtarisë, vëllimit dhe qarkullimit, deri në qershor 2021.



**Projekti 1.4.2** Përkratja e vazhdueshme e bizneseve që eksportojnë me anë të ofrimit të mbështetjes për konkurrueshmëri në treg jashtë vendit (promovim produktesh, strategji për depërtim në tregje të reja etj.).

**Projekti 1.4.3** Mbështetje e vazhdueshme institucionale në sigurimin e mekanizmit për eksport të prodhimeve bujqësore, vreshtare, verës etj.

**Projekti 1.4.4** Mbështetje financiare për brendim të prodhimeve të rrushit dhe të verës.

**Objektivi specifik 1.5** Përkratja dhe fuqizimi i gruas ndërmarrëse në mënyrë që të motivohen gratë për ndërmarrësi, deri në fund të vitit 2025.

**Projekti 1.5.1** Evidentimi i ndërmarrjeve që janë në pronësi të grave sipas veprimtarisë, numrit të punëtorëve, qarkullimit, deri në qershor të vitit 2021.

**Projekti 1.5.2** Mbështetje e vazhdueshme në aplikim dhe procedura përcjellëse, për fitimin e granteve.

**Projekti 1.5.3** Promovimi i bizneseve të grave ndërmarrëse, nëpërmjet organizimit të panaireve dhe organizimit të degustimit të produkteve të tyre.

**Projekti 1.5.4** Ofrimi i konsulencave për biznes në mënyrë të vazhdueshme dhe organizimi i trajnimeve profesionale duke marrë për bazë nevojat e tyre.

**Objektivi specifik 1.6** Zhvillimi i turizmit vendor nëpërmjet promovimit të resurseve natyrore, peizazheve, vendeve rekreative, monumenteve kulturore dhe arkitekturore, deri në fund të vitit 2025.

**Projekti 1.6.1** Hartimi dhe përgatitja e broshurave informuese, deri në qershor të vitit 2021.

**Projekti 1.6.2** Promovim i turizmit rekreativ të zonës së Rahovcit.

**Projekti 1.6.3** Promovim i monumenteve kulturore dhe arkitekturore në komunën e Rahovcit.

**Projekti 1.6.4** Promovim i trashëgimisë kulturore të Hoçës së Madhe.

**Projekti 1.6.5** Listimi i të gjitha atraksioneve turistike të Komunës në platformat më të njoitura *online*.

**Objektivi specifik 1.7** Nxitja e inovacionit nëpërmjet Partneritetev Publiko Private, inicimi i së paku katër projekteve dhe përfundimi i tyre deri në fund të vitit 2025.



*Projekti 1.7.1* Ngritja e grupit punues për Partneritete Publiko Private.

*Projekti 1.7.2* Ngritja e kapaciteteve për Partneritete Publiko Private.

*Projekti 1.7.3* Identifikimi i projekteve për Partneritete Publiko Private.

*Projekti 1.7.4* Përザgjedhja e katër projekteve potenciale për Partneritete Publiko Private.

*Projekti 1.7.5* Sigurimi i fondeve për financimin e Studimeve të Fizibilitetit për projektet e përzgjedhura të Partneritete Publiko Private.

*Projekti 1.7.6* Hartimi i studimit të fizibilitetit për katër projekte në Partneritete Publiko Private.

## **Qëllimi strategjik 2: Përmirësimi i kushteve të jetesës së banorëve**

**Objektivi specifik 2.1** Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara, rregullimi i rrugëve të pa kategorizuara, në periudhën strategjike.

*Projekti 2.1.1* 2.1.1 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës me 4 Korsi Rahovec – Xërxe.

*Projekti 2.1.2* Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Rahovec – Hamovc -Fortesë.

*Projekti 2.1.3* Rregullimi i rrugës Xërxe - Sapniq – Ratkoc.

*Projekti 2.1.4* Rregullimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit: LOT – 1; LOT – 2; LOT – 3.

*Projekti 2.1.5* Identifikimi dhe prioritizimi i rrugëve të pa kategorizuara për t'u shtruar me kubëza/asfalt. Ndërtimi i rrugës Apterushë - Mamushë

*Projekti 2.1.6* Kubëzimi/asfaltimi i tyre.

*Projekti 2.1.7* Ndërtimi i trotuareve në vendbanimet e komunës së Rahovecit.

**Objektivi specifik 2.2** Trajtimi i ujërave të zeza, në periudhën strategjike.

*Projekti 2.2.1* Evidentimi i gjendjes ekzistuese.

*Projekti 2.2.2* Ndërtimi i kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza: Seg.1; Seg.2; Seg.3.



**Projekti 2.2.3** Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në fshatrat e Komunës së Rahovecit.

**Objektivi specifik 2.3** Investime në ndriçim publik, konkretisht në vendosjen e 700 trupave ndriçues deri në fund të vitit 2025.

*Projekti 2.3.1* Evidentimi i gjendjes ekzistuese të trupave ndriçues.

*Projekti 2.3.2* Përpilimi i listës për ndriçim sipas prioritetit.

*Projekti 2.3.3* Instalimi i 700 trupave ndriçues në vendbanime te ndryshme të komunës së Rahovecit. Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit.

**Objektivi specifik 2.4.** Shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe zvogëlimi i rrezikut për 30% nga mbeturinat e përziera, deri në fund të vitit 2025.

*Projekti 2.4.1* Evidentimi i gjendjes ekzistuese të lokaliteteve të pambuluara deri në maj të vitit 2021.

*Projekti 2.4.2* Përpilimi i listës prioritare për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, deri në korrik të vitit 2021.

*Projekti 2.4.3* Rritja e mbulueshmërisë me shërbime për mbeturina rreth 90%, deri në fund të vitit 2024.

*Projekti 2.4.4* Zvogëlimi i rrezikut për 30% nga mbeturinat e përziera, brenda periudhës strategjike.

**Objektivi specifik 2.5** Marrëveshje me operatorët e telefonisë mobile për ofrimin e pakove të përshtatshme për shtrirjen e shërbimeve të internetit në zonat e pambuluara.

*Projekti 2.5.1* Evidentimi i gjendjes ekzistuese të lokaliteteve të pambuluara, deri në maj të vitit 2021.

*Projekti 2.5.2* Shtrirja e shërbimeve të internetit në zonat e pambuluara si

### **Qëllimi strategjik 3: Ngritja dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit**

**Objektivi specifik 3.1.** Ngritja e kapaciteteve të Drejtorisë Komunale të Arsimit në planifikim strategjik dhe monitorim, deri në shtator 2021



*Projekti 3.1.1* Zhvillimi dhe aprovimi i planit komunal për zhvillim të arsimit 2021-2025, deri në fund të muajit gusht 2021.

*Projekti 3.1.2* Trajnimi i stafit të Drejtorisë Komunale të Arsimit për planifikim strategjik dhe operacional deri në gusht 2021.

*Projekti 3.1.3* Hartimi i rregullores brenda shkollës deri në gusht 2021.

**Objektivi specifik 3.2.** Përmirësimi i cilësisë në menaxhim dhe mësimdhënie nëpërmjet vlerësimit sipas metodologjisë 360°, ku nxënësit vlerësojnë mësimdhënësit, mësimdhënësit menaxhmentin e shkollës, menaxhmenti i shkollës mësimdhënësit. Të futet në aplikim prej shtatorit 2021 dhe të vazhdojë çdo vit.

*Projekti 3.2.1* Adaptimi i metodologjisë dhe informimi i të gjitha palëve për metodologjinë e vlerësimit deri në shtator 2021.

*Projekti 3.2.2* Organizimi i vlerësimit të të gjitha niveleve prej tetorit 2021.

*Projekti 3.2.3* Analizimi i rezultateve, interpretimi i tyre dhe përgatitja për përmirësimet e mundshme deri në mars 2022.

*Projekti 3.2.4* Përzgjedhje e më të mirëve në mesin e nxënësve, mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave në qershor 2022. Të bëhet praktikë çdo vjeçare.

**Objektivi specifik 3.3.** Renovim dhe ndërtimi shkollave/kopshteve deri në fund të periudhës strategjike.

*Projekti 3.3.1* Renovim i shkollave

---

---

*Projekti 3.3.2* Renovim i kopshteve

---

---

*Projekti 3.3.3* Ndërtim i shkollave

---

---

*Projekti 3.3.4* Ndërtim i kopshteve

---

---



**Objektivi specifik 3.4.** Investim në infrastrukturë dhe teknologji informative bashkëkohore, në shkollat fillore dhe të mesme.

*Projekti 3.4.1* Deri në vitin 2023 së paku 90% e shkollave të jenë të pajisura me infrastrukturë dhe teknologji informative bashkëkohore.

## **Qëllimi strategjik 4: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale**

**Objektivi specifik 4.1** Renovim dhe ndërtim i objekteve shëndetësore

*Projekti 4.1.1* Kompletimi i infrastrukturës shëndetësore deri në vitin 2022, që plotësojnë nevojat për ofrimin e shërbimeve cilësore.

*Projekti 4.1.2* Renovim i objekteve shëndetësore

*Projekti 4.1.3* Ndërtim i objekteve shëndetësore

**Objektivi specifik 4.2** Përmirësimi i kushteve të banimit për rastet sociale

*Projekti 4.2.1* Përmirësimi i kushteve të banimit së paku për 100 familje të identikuara si raste sociale.



## **Qëllimi strategjik 5: Zhvillimi i resurseve njerëzore nëpërmjet arsimimit adekuat dhe trajnimeve profesionale për banorët e komunës, në periudhën strategjike**

**Objektivi specifik 5.1** Përgatitja e banorëve që të kenë sukses në punësim lokal.

*Projekti 5.1.1* Hulumtim i kërkesave të tregut të punës kundrejt arsimimit të banorëve, deri në shtator të vitit 2021.

*Projekti 5.1.2* Identifikimi i aftësive/shkathësive deficitare në tregun e punës, deri në nëntor të vitit 2021.

*Projekti 5.1.3* Ofrimi i trajnimeve të ndryshme për fitimin e aftësive/shkathësive deficitare për integrim në tregun e punës.

*Projekti 5.1.4* Zhvillimi i partneritetit mes shkollave profesionale dhe bizneseve, në mënyrë që burimet njerëzore të aftësohen krahas kërkesës së bizneseve.

## **Qëllimi strategjik 6: Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit**

**Objektivi specifik 6.1** Mbrojtja e pyjeve nga prerjet e pakontrolluara

*Projekti 6.1.1* Parandalimi i prerjeve ilegale të pyjeve.

*Projekti 6.1.2* Rishikimi i planeve menaxhuese të pyjeve në nivel komunal.

**Objektivi specifik 6.2** Pyllëzimi që të ruhet ekosistemi

*Projekti 6.2.1* Rikultivimi i zonave të degraduara.

*Projekti 6.2.2* Të rritet hapësira gjelbëruese publike për 20%, deri në fund të vitit 2022.

**Objektivi specifik 6.3** Trajtimi i shtretërve të lumenjve

*Projekti 6.3.1* Largimi i nga shtretërit e lumenjve barrierat natyrale apo ato të shkaktuara nga banorët.

*Projekti 6.3.2* Kontrollimi i zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet.



**Projekti 6.3.3** Mbrojtja e botës bimore në shtretërit e lumenjve dhe mirëmbajtja e tyre.

#### **Objektivi specifik 6.4** Moslejimi i ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore

**Projekti 6.4.1** Përcaktimi i politikave në nivel komune për moslejimin e ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore.

#### **Objektivi specifik 6.5** Ruajtja e mjedisit

**Projekti 6.5.1** Mbështetje financiare për projektet që kanë synim riciklimin e mbeturinave dhe ruajtjen e mjedisit.

## **MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË**

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal 2021-2025 për komunën e Rahovecit ka edhe planin e vet të zbatimit (*shih shtojcën 1*) që mbulon periudhën 2021-2025, i cili përbëhet nga aktivitetet, indikatorët dhe institucionet përgjegjëse.

Plani i zbatimit të strategjisë do të rishikohet në baza vjetore në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në strategji. Struktura për monitorimin e zbatimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal përbëhet nga indikatorët matës, të cilët janë të vendosur në nivel të objektivave specifike në strategji.

Megjithëse komuna do të monitorojet dhe paraqesë raporte të rregullta, është e domosdoshme të vlerësohet nëse janë arritur rezultatet e synuara. Komuna do të përqendrohet në vlerësimin e fushave të caktuara në lidhje me rëndësinë, efikasitetin, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e planit strategjik. Prandaj, komuna do të fillojë një vlerësim afatmesëm në vitin 2023 dhe përsëri në fund të periudhës strategjike në vitin 2025. Sidoqoftë, vlerësimi i projekteve dhe programeve do të vazhdojë gjatë gjithë periudhës strategjike.

## **NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË**

**Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së aktiviteteve:** Plani i veprimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2021-2025 për komunën e Rahovecit, ka një kosto totale të zbatimit prej \_\_\_\_\_ €.

**Burimet e financimit të strategjisë:** Financimi i zbatimit të planit të veprimit të kësaj strategjie, parashihet të bëhet nga buxheti i komunës së Rahovecit dhe \_\_\_\_\_.

# SHTOJCA 1

*Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal*

## PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SZHEL

### Qëllimi strategjik #1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik

Objktivi specifik 1.1	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Përkrahja e vazhdueshme e NVM-ve me fokus të veçantë në bujqësi, vreshtri, blegtori etj., deri në fund të vitit 2025	1.1.1 Përkrahja e vazhdueshme e bujqve në kosto të derivateve, farerave, plehrave artificiale dhe materialeve tjera ndihmëse	Në vazhdimësi	50,000€/vit	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	MBPZHR & Organizatat tjera
	1.1.2 Mbështetje në sigurimin e kredive me norma më të ulëta të interesit për bujqësi, vreshtri, blegtori etj.		20,000€/vit	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	Bankat komerciale
	1.1.3 Mbështetja e NVM-ve nëpërmjet uljes së taksave për 25%					
	1.1.4 Mbështetje financiare fermerëve në shtimin e fondit blegtoral për 10%		50,000€/vit	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	MBPZHR & Organizatat tjera
	1.1.5 Mbështetje financiare fermerëve në ngritjen e serave për kultivimin e perimeve		200,000€/vit	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	MBPZHR & Organizatat tjera
	1.1.6 Mbështetje financiare fermerëve në përpunim të prodhimeve bujqësore		50,000€/vit	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	MBPZHR & Organizatat tjera
	1.1.7 Mbështetje financiare kultivuesve të rrushit		100,000€/vit	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	MBPZHR & Organizatat tjera
	1.1.8 Mbështetje financiare në teknologji adekuate për përpunimin e rrushit dhe verës		50,000€/vit	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	MBPZHR & Organizatat tjera
	1.1.9 Marrëveshje në nivel komunal me zinxhirët kryesorë të marketeve/tregjeve për plasimin e produkteve të ndërmarrësve lokalë duke aplikuar lehtësira të hyrjes në treg, pagesave, pra të trajtohen veçantë si prodhues vendor		30,000€/vit	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	Përkrahja e qendrave përpunuese
	1.1.10 Organizimi i trajnimeve profesionale duke marrë përbazë nevojat e tyre. Paraprakisht mund të përcaktohen priorititetet nëpërmjet realizimit të një sondazhi					

## SHTOJCA 1

### Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

	1.1.11 Përkrasha e tyre nëpërmjet ofrimit të ndihmës për ndërrimin e mjeteve të vjetërsuara të punës, sidomos mekanizmave bujqësorë		100,000€/vit	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	Organizata tjera
	1.1.12 Organizimi i panaireve me qëllim të promovimit të prodhimeve lokale		30,000€	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	HardhFest
Objktivi specifik 1.2	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Nxitja e investimeve të huaja direkte dhe tർheqja e së paku 8 milion € investime të huaja direkte deri në fund të vitit 2025	1.2.1 Evidencimi i investitorëve të huaj aktual sipas veprimtarisë, numrit të punëtorëve, qarkullimit deri në qershor të vitit 2021	2021-2025	10,000€	Komuna e Rahovecit, investitorët privat, organizatat o-qeveritare ndërkombëtare, etj.	Komuna e Rahovecit - DEZHT	Komuna e Rahovecit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, MTI, Ministria e Zhvillimit Rajonal
	1.2.2 Identifikimi i së paku 65 investitorëve të huaj potencial, përfshirë edhe diasporën deri në tetor të vitit 2021	2021-2025	15,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit - DEZHT	Komuna e Rahovecit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, MTI, Ministria e Zhvillimit Rajonal
	1.2.3 Përgjedhja e së paku 25 investitorëve të huaj direkt dhe kriimi i kontakteve me ta, deri në dhjetor të vitit 2021	2021-2025	7,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit - DEZHT	Komuna e Rahovecit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, MTI, Ministria e Zhvillimit Rajonal
	1.2.4 Organizimi i së paku tri konferencave ku ftohen investitorët potencialë dhe krijohen lidhjet për nxitje të investimeve të mundshme në komunë, deri në qershor të vitit 2022	2021-2025	7,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit - DEZHT	Komuna e Rahovecit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, MTI, Ministria e Zhvillimit Rajonal

## SHTOJCA 1

### Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

Objektivi specifik 1.3	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
	1.3.1 Organizimi dhe ofrimi i trajnimeve për menaxhim, ndërmarrësi, lidership për të interesuarit për krijuar të bizneseve të reja, çdo vit në periudhë tremujore	2021-2025	15,000€	Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me sektorin publiko-privat si dhe me OJQ-të e ndryshme lokale dhe ndërkombëtare	Komuna e Rahovecit – DEZHT	Komuna e Rahovecit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, MTI, Ministria e Zhvillimit Rajonal
	1.3.2 Hulumtim mbi nevojat dhe kërkesat e të interesuarve për aplikim dhe procedura përcjellëse, për fitimin e granteve dhe mbështetjen e ideve të reja, çdo vit në periudhë tremujore	2021-2025	5,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit – DEZHT	Komuna e Rahovecit
Nxitja e krijuarit të së paku 450 bizneseve të reja të qëndrueshme deri në fund të vitit 2025	1.3.3 Promovimi i bizneseve të reja të krijuara brenda vitit, nëpërmjet organizimit të panaireve dhe organizimit të degustimit të produkteve të tyre	2021-2025	75,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit, bizneset, donatorët ndërkombëtarë, etj.	Ministria e Bujqësisë, MTI, Komuna e Rahovecit dhe donatorët (p.sh. Zyra e BE-së në Kosovë, USAID, Fondacioni IPA, etj.) apo edhe investitorët ndërkombëtarë
	1.3.4 Ofrimi i konsulencave për biznes në mënyrë të vazhdueshme (sipas nevojës së paraqitur) për bizneset e reja	2021-2025		Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit-DEZHT	Komuna e Rahovecit, TIC, ARBK dhe sektori i zhvillimit ekonomik lokal

## SHTOJCA 1

### Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

Objktivi specifik 1.4	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
	1.4.1 Evidentimi i eksportit aktual sipas veprimtarisë, vëllimit dhe qarkullimit, deri në qershor 2021	2021-2025				
	1.4.2 Përkrahja e vazhdueshme e bizneseve që eksportojnë me anë të ofrimit të mbështetjes për konkurrueshmëri në treg jashtë vendit (promovim produktesh, strategji për depërtim në tregje të reja etj.)	2021-2025	100,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit
	1.4.3 Mbështetje e vazhdueshme institucionale në sigurimin e mekanizmit për eksport të prodhimeve bujqësore, vreshfare, verës etj.	2021-2025	50,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit-DEZHT, DBPZHR	Komuna e Rahovecit dhe Ministritë relevante
	1.4.4 Mbështetje financiare për brendim të prodhimeve të rrushit dhe të verës	2021-2025	70,000€	Komuna e Rahovecit ne bashkëpunim me sektorin publiko-privat si dhe me OJQ-të e ndryshme lokale dhe ndërkombëtare	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, MTI, Ministria e Zhvillimit Rajonal
Objktivi specifik 1.5	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Përkrahja dhe fuqizimi i gruas ndërmarrëse në mënyrë që të motivohen gratë për ndërmarrësi, deri në fund të vitit 2025	1.5.1 Evidentimi i ndërmarrjeve që janë në pronësi të grave sipas veprimtarisë, numrit të punëtorëve, qarkullimit, deri në qershor të vitit 2021	2021-2025			Komuna e Rahovecit, ARBK, ATK, DEZHT	Komuna e Rahovecit, ARBK, ATK, DEZHT
	1.5.2 Mbështetje e vazhdueshme në aplikim dhe procedura përcjellëse, për fitimin e granteve	2021-2025	20,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit, investitorët privatë, OJQ-të, donatorët ndërkombëtarë, etj.	Komuna e Rahovecit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, MTI, Ministria e Zhvillimit Rajonal

## SHTOJCA 1

### Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

	1.5.3 Promovimi i bizneseve të grave ndërmarrëse, nëpërmjet organizimit të panaireve dhe organizimit të degustimit të produkteve të tyre	2021-2022	75,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit, bizneset, donatorët ndërkombëtarë, etj.	Ministria e Bujqësisë, MTI, Komuna e Rahovecit dhe donatorët (p.sh. Zyra e BE-së në Kosovë, USAID, Fondacioni IPA, etj.) apo edhe investitorët ndërkombëtarë
	1.5.4 Ofrimi i konsulencave për biznes në mënyrë të vazhdueshme dhe organizimi i trajnimeve profesionale duke marrë për bazë nevojat e tyre			Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit, TIC, ARBK dhe sektori i zhvillimit ekonomik lokal	Komuna e Rahovecit, TIC, ARBK dhe sektori i zhvillimit ekonomik lokal
Objktivi specifik 1.6	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Zhvillimi i turizmit vendor nëpërmjet promovimit të resurseve natyrore, peizazheve, vendeve rekreative, monumenteve kulturore dhe arkitekturore, deri në fund të vitit 2025	1.6.1 Hartimi dhe përgatitja e broshurave informuese, deri në qershor të vitit 2021	2021-2022	27,000€/vit	Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me sektorin publiko-privat si dhe me OJQ-të e ndryshme lokale dhe ndërkombëtare, etj.	Komuna e Rahovecit – DEZHT-TIC	Komuna e Rahovecit-DEZHT, MTI, donatorët (p.sh. Zyra e BE-së në Kosovë, USAID, Fondacioni IPA, etj.) apo edhe investitorët lokal dhe ndërkombëtarë
	1.6.2 Promovim i turizmit rekreativ të zonës së Rahovecit	2021-2022	70,000€/vit	Komuna e Rahovecit ne bashkëpunim me sektorin publiko-privat si dhe me OJQ-të e ndryshme	Komuna e Rahovecit – DEZHT-TIC	Komuna e Rahovecit-DEZHT, MTI, Komuna e Rahovecit dhe donatorët (p.sh. Zyra e BE-së në Kosovë, USAID,

## SHTOJCA 1

### Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

			lokale dhe ndërkontaktuale, etj.		Fondacioni IPA, etj.) apo edhe investitorët lokal dhe ndërkontaktuale
1.6.3 Promovim i monumenteve kulturore dhe arkitekturore në komunën e Rahovecit	2021-2025	40,000€/vit	Komuna e Rahovecit ne bashkëpunim me sektorin publiko-privat si dhe me OJQ-të e ndryshme lokale dhe ndërkontaktuale, etj.	Komuna e Rahovecit – DEZHT-TIC	Komuna e Rahovecit-DEZHT, MTI, Komuna e Rahovecit dhe donatorët (p.sh. Zyra e BE-së në Kosovë, USAID, Fondacioni IPA, etj.) apo edhe investitorët lokal dhe ndërkontaktuale
1.6.4 Promovim i trashëgimisë kulturore të Hoçës së Madhe	2021-2025	17,000€	Komuna e Rahovecit dhe Këshilli i fshatit		
1.6.5 Listimi i të gjitha atraksioneve turistike të Komunës në platformat më të njohura online	2021-2025	27,000€/vit	Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me sektorin publiko-privat si dhe me OJQ-të e ndryshme lokale dhe ndërkontaktuale, etj.	Komuna e Rahovecit – DEZHT-TIC	Komuna e Rahovecit-DEZHT, MTI, Komuna e Rahovecit dhe donatorët (p.sh. Zyra e BE-së në Kosovë, USAID, Fondacioni IPA, etj.) apo edhe investitorët lokal dhe ndërkontaktuale

# SHTOJCA 1

## Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

Objktivi specifik 1.7	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Nxitja e inovacionit nëpërmjet Partneriteteve Publiko Private, inicimi i së paku katër projekteve dhe përfundimi i tyre deri në fund të vitit 2025	1.7.1 Ngritura e grupit punues për Partneritete Publiko Private					
	1.7.2 Ngritura e kapaciteteve për Partneritete Publiko Private					
	1.7.3 Identifikimi i projekteve për Partneritete Publiko Private					
	1.7.4 Përzgjedhja e katër projekteve potenciale për Partneritete Publiko Private					
	1.7.5 Sigurimi i fondeve për financimin e Studimeve të Fizibilitetit për projektet e përzgjedhura të Partneritete Publiko Private					
	1.7.6 Hartimi i studimit të fizibilitetit për katër projekte në Partneritete Publiko Private					

## Qëllimi strategjik #2: Përmirësimi i kushteve të jetesës së banorëve

Objktivi specifik 2.1	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara, rregullimi i rrugëve të pa kategorizuara, në periudhën strategjike	2.1.1 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës me 4 Korsi Rahovec – Xërxe	Tre vjet	6,513,953€	Komuna Rahovecit, M. Infrastrukturës	Komuna e Rahovecit	M. Infrastrukturës
	2.1.2 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Rahovec – Hamovc - Fortesë	Tre vjet	997,933€	Komuna e Rahovecit, Ministria e Infrastrukturës	Komuna e Rahovecit	M. Infrastrukturës
	2.1.3 Rregullimi i rrugës Xërxe - Sapniq - Ratkoc	Tre vjet	898,888€	Komuna e Rahovecit, Ministria e Infrastrukturës	Komuna e Rahovecit	M. Infrastrukturës
	2.1.4 Rregullimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit LOT – 1 LOT – 2 LOT – 3	Dy vjet Dy vjet Dy vjet	337,408€ 262,463€ 275,674€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit

# SHTOJCA 1

## Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

	2.1.5 Identifikimi dhe prioritizimi i rrugëve të pa kategorizuara për t'u shtruar me kubëza/asfalt Ndërtimi i rrugës Apterushë - Mamushë	Dy vjet	510,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	M. Infrastrukturës
	2.1.6 Kubëzimi/asfaltimi i tyre					
	2.1.7 Ndërtimi i trotuareve në vendbanimet e komunës së Rahovecit	Dy vjet	649.489€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit
Objktivi specifik 2.2	Aktiviteti/Projekti	Afat i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institacioni mbështetës
Trajtimi i ujërave të zeza, në periudhën strategjike	2.2.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese					
	2.2.2 Ndërtimi i kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza Seg.1 Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza Seg.2 Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza Seg.3	Tre Vjet Tre Vjet Tre vjet	1,800.000€ 3,750,000€ 900,000€	Komuna e Rahovecit, donatorët	Komuna e Rahovecit	Donatorët dhe Ministritë
	2.2.3 Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në fshatrat e Komunës së Rahovecit	Tre Vjet	500,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Donatorët dhe Ministritë
Objktivi specifik 2.3	Aktiviteti/Projekti	Afat i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institacioni mbështetës
Investime në ndriçim publik, konkretisht në vendosjen e 700 trupave ndriçues deri në fund të vitit 2025	2.3.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të trupave ndriçues	Dy vjet	50,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna dhe Donatorë
	2.3.2 Përpilimi i listës për ndriçim sipas prioritetit	Dy vjet	5,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit
	2.3.3 Instalimi i 700 trupave ndriçues në vendbanime te ndryshme të komunës së Rahovecit Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit	Tre vjet	250,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit
Objktivi specifik 2.4	Aktiviteti/Projekti	Afat i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institacioni mbështetës
Shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe zvogëlimi i rrezikut për	2.4.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të lokaliteteve të pambuluara deri në maj të vitit 2021	Një vit	5,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit
	2.4.2 Përpilimi i listës prioritare për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, deri në korrik të vitit 2021	Një vit	5,000€	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit

# SHTOJCA 1

## Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

30% nga mbeturinat e përziera, deri në fund të vitit 2025	2.4.3 Rritja e mbulueshmërisë me shërbime për mbeturina rreth 90%, deri në fund të vitit 2024					
	2.4.4 Zvogëlimi i rrezikut për 30% nga mbeturinat e përziera, brenda periudhës strategjike					
Objktivi specifik 2.5	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Marrëveshje me operatorët e telefonisë mobile për ofrimin e pakove të përshtatshme për shtrirjen e shërbimeve të internetit në zonat e pambuluara	2.5.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të lokaliteteve të pambuluara, deri në maj të vitit 2021  2.5.2 Shtrirja e shërbimeve të internetit në zonat e pambuluara si _____					

## Qëllimi strategjik #3: Ngritura dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit

Objktivi specifik 3.1	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Ngritura e kapaciteteve të Drejtorisë Komunale të Arsimit në planifikim strategjik dhe monitorim, deri në shtator 2021	3.1.1 Zhvillimi dhe aprovimi i planit komunal për zhvillim të arsimit 2021-2025, deri në fund të muajit gusht 2021	Deri më 31 gusht 2021	1,000 €	DKA, Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit
	3.1.2 Trajnim i stafit të Drejtorisë Komunale të Arsimit për planifikim strategjik dhe operacional deri në gusht 2021	Deri më 31 gusht 2021			DKA	Komuna e Rahovecit
	3.1.3 Hartimi i rregullores brenda shkollës deri në gusht 2021	Deri më 31 gusht 2021			DKA dhe Shkollat	Komuna e Rahovecit
Objktivi specifik 3.2	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Përmirësimi i cilësisë në menaxhim dhe mësimdhënie nëpërmjet vlerësimit sipas metodologjisë 360°, ku nxënësit vlerësojnë	3.2.1 Adaptimi i metodologjisë dhe informimi i të gjitha palëve për metodologjinë e vlerësimit deri në shtator 2021	I vazhdueshëm			DKA	Komuna e Rahovecit
	3.2.2 Organizimi i vlerësimit të të gjitha niveleve prej tetorit 2021	I vazhdueshëm			DKA	Komuna e Rahovecit
	3.2.3 Analizimi i rezultateve, interpretimi i tyre dhe përgatitja për përmirësimet e mundshme deri në mars 2022	I vazhdueshëm			DKA	Komuna e Rahovecit

## SHTOJCA 1

### Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

mësimdhënësit, mësimdhënësit menaxhmentin e shkollës, menaxhmenti i shkollës mësimdhënësit. Të futet në aplikim prej shtatorit 2021 dhe të vazhdojë çdo vit	3.2.4 Përgjedhje e më të mirëve në mesin e nxënësve, mësimdhënësve, drejtoreve të shkollave në qershor 2022. Të bëhet praktikë çdo vjeçare	I vazhdueshëm			Shkollat dhe DKA	Komuna e Rahovecit
Objktivi specifik 3.3	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Renovim dhe ndërtimi shkollave/kopshteve deri në fund të periudhës strategjike	3.3.1 Renovim i shkollave	I vazhdueshëm	100,000€/vit	DKA, Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit dhe MASHT
	3.3.2 Renovim i kopshteve					
	3.3.3 Ndërtim i shkollave	I vazhdueshëm derisa të ketë nevojë për objekte shkollore të reja	100,000€/vit	DKA, Komuna e Rahovecit + MASHT	Komuna e Rahovecit + MASHT	MASHT
	3.3.4 Ndërtim i kopshteve	Deri në shtator 2021	500,000 €/vit	DKA +Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit	Komuna e Rahovecit
Objktivi specifik 3.4	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Investim në infrastrukturë dhe teknologji informative bashkëkohore, në shkollat fillore dhe të mesme	3.4.1 Deri në vitin 2023 së paku 90% e shkollave të janë të pajisura me infrastrukturë dhe teknologji informative bashkëkohore	Deri në vitin 2023	100,000,00 €/vit	DKA + Komuna e Rahovecit + MASHT	Komuna e Rahovecit	MASHT
<b>Qëllimi strategjik #4: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale</b>						
Objktivi specifik 4.1	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës

# SHTOJCA 1

## Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

Renovim dhe ndërtim i objekteve shëndetësore	4.1.1 Kompletimi i infrastrukturës shëndetësore deri në vitin 2022, që plotësojnë nevojat për ofrimin e shërbimeve cilësore						
	4.1.2 Renovim i objekteve						
	4.1.3 Ndërtim i objekteve shëndetësore						
Objktivi specifik 4.2	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	
Përmirësimi i kushteve të banimit për rastet sociale	4.2.1 Përmirësimi i kushteve të banimit së paku për 100 familje të identifikuara si raste sociale						
<b>Qëllimi strategjik #5: Zhvillimi i resurseve njerëzore nëpërmjet arsimimit adekuat dhe trajnimeve profesionale për banorët e komunës, në periudhën strategjike</b>							
Objktivi specifik 5.1	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	
Përgatitja e banorëve që të kenë sukses në punësim lokal	5.1.1 Hulumtim i kërkesave të tregut të punës kundrejt arsimimit të banorëve, deri në shtator të vitit 2021						
	5.1.2 Identifikimi i aftësive/shkathtësive deficitare në tregun e punës, deri në nëntor të vitit 2021						
	5.1.3 Ofrimi i trajnimeve të ndryshme për fitimin e aftësive/shkathtësive deficitare për integrim në tregun e punës						
	5.1.4 Zhvillimi i partneritetit mes shkollave profesionale dhe bizneseve, në mënyrë që burimet njerëzore të aftësohen krahas kërkesës së bizneseve						
<b>Qëllimi strategjik #6: Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit</b>							
Objktivi specifik 6.1	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	
Mbrojtja e pyjeve nga prerjet e pakontrolluara	6.1.1 Parandalimi i prerjeve ilegale të pyjeve		10,000€	Komuna e Rahovecit	Njësia e Pylltarisë	Agjioni i Pylltarisë së Kosovës	


## SHTOJCA 1

### Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

	6.1.2 Rishikimi i planeve menaxhuese të pyjeve në nivel komunal					
Objektivi specifik 6.2	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Pyllëzimi që të ruhet ekosistemi	6.2.1 Rikultivimi i zonave të degraduara		10,000€	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	APK dhe Organizatat tjera
	6.2.2 Të rritet hapësira gjelbëruese publike për 20%, deri në fund të vitit 2022		10,000€	Komuna e Rahovecit	DBPZHR	APK dhe Organizatat tjera
Objektivi specifik 6.3	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Trajtimi i shtretërve të lumenjve	6.3.1 Largimi i nga shtretërit e lumenjve barrierat natyrale apo ato të shkaktuara nga banorët					
	6.3.2 Kontrollimi i zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet					
	6.3.3 Mbrojtja e botës bimore në shtretërit e lumenjve dhe mirëmbajtja e tyre					
Objektivi specifik 6.4	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Moslejimi i ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore	6.4.1 Përcaktimi i politikave në nivel komune për moslejimin e ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore		0,00	n/a	DBPZHR	MBPZHR
Objektivi specifik 6.5	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Ruajtja e mjedisit	6.5.1 Mbështetje financiare për projektet që kanë synim riciklimin e mbeturinave dhe ruajtjen e mjedisit					

## SHTOJCA 2

### Struktura organizative e komunës së Rahovecit



## SHTOJCA 3

### Financimi i investimeve kapitale komunale 2020-2022



Republika e Kosovës | Republika Kosova | Republic of Kosovo  
 Qeveria e Kosovës | Kosova Vlada | Government of Kosovo  
 Ministria e Financave | Ministarstvo Financija | Ministry of Finance

Date: 04.02.2020 12:20

**Tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale 2020-2022**

#### Rahovec

Prog	Kodi i Prop	Kodi Proj	Emri i Projektit	10 - BKK	21 - THV	Financimi	Totali	Vlerësuar për	Vlerësuar për	Totali	Financimi
				2020	2020	Huamarrja	2020	2021	2022	2020-2022	Jashtëm
<b>623163 - Administrata dhe Personeli</b>											
<b>163110 - Administrata - Rahovec</b>											
0133	623163-1933693	47975	Ndertimi i E-Kioskut	5,000	0	0	5,000	0	0	5,000	0
0133	623163-1933714	47994	Riparimi i objekteve te gjendjes civile	10,000	5,000	0	15,000	10,000	0	25,000	0
0133	623163-2036739	49841	Vendosja e ashensorit në objektin e ndërteses së Komunës	0	0	0	0	5,000	15,000	20,000	0
			<b>Totali - Administrata - Rahovec</b>	<b>15,000</b>	<b>5,000</b>	<b>0</b>	<b>20,000</b>	<b>15,000</b>	<b>15,000</b>	<b>50,000</b>	<b>0</b>
			<b>Totali - Administrata dhe Personeli</b>	<b>15,000</b>	<b>5,000</b>	<b>0</b>	<b>20,000</b>	<b>15,000</b>	<b>15,000</b>	<b>50,000</b>	<b>0</b>
<b>623175 - Buxhet dhe Financa</b>											
<b>175110 - Buxhetimi</b>											
0112	623175-1524844	40791	Projektet me donator (Helvetas)	0	40,000	0	40,000	30,000	30,000	100,000	0
			<b>Totali - Buxhetimi</b>	<b>0</b>	<b>40,000</b>	<b>0</b>	<b>40,000</b>	<b>30,000</b>	<b>30,000</b>	<b>100,000</b>	<b>0</b>
			<b>Totali - Buxhet dhe Financa</b>	<b>0</b>	<b>40,000</b>	<b>0</b>	<b>40,000</b>	<b>30,000</b>	<b>30,000</b>	<b>100,000</b>	<b>0</b>
<b>623180 - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia</b>											
<b>181710 - Infrastruktura Publike - Rahovec</b>											
0451	623180-1831682	46727	Inevstime dhe mirmbatje te hapsiarve gjelbruse, parqet, vorrezat etj ne Ko	45,000	0	0	45,000	30,000	30,000	105,000	0
0451	623180-1525102	40818	Ndërtimi i trotuareve në Komunen e Rahovecit (vazhdim)	70,000	0	0	70,000	80,000	80,000	230,000	0
0451	623180-1933772	48045	Krijimi i parkingjeve të reja në qytet	0	15,000	0	15,000	5,000	0	20,000	0
0451	623180-1525001	40815	Intervenimet emergjente në Infrastrukturë	15,000	0	0	15,000	30,000	30,000	75,000	0
0451	623180-2036785	49877	Ndërtimi dhe trajtimi i ujerrave atmosferik në qytet	50,000	0	0	50,000	50,000	60,000	160,000	0
0451	623180-1525122	40819	Ndertimi i sistemeve te ujesjellesit ne Komunen e Rahovecit	70,000	0	0	70,000	10,000	10,000	90,000	0
0451	623180-2036795	49887	Ndërtimi dhe rregullimi i Infrastrukturës në stacion të autobuseve në Rahov	5,000	0	0	5,000	0	0	5,000	0
0451	623180-1933930	48181	Ndërt. i kan. për ujëra atmos. dhe ndërt. i rrugëve me kubëza në fshatin Za	20,000	0	0	20,000	0	0	20,000	0
0451	623180-2036807	49898	Ndërtimi dhe zgjerimi i ndriqimit publik në Komunen e Rahovecit	147,000	0	0	147,000	386,000	430,000	963,000	0

## SHTOJCA 3

### Financimi i investimeve kapitale komunale 2020-2022



Republika e Kosovës | Republika Kosova | Republic of Kosovo  
 Qeveria e Kosovës | Kosova Vlada | Government of Kosovo  
 Ministria e Financave | Ministarstvo Financija | Ministry of Finance

Date: 04.02.2020 12:20

0451	623180-1627023	43468	Ndërtimi i rrugës Rahovec- Pataqan i Poshtem	100,000	0	0	100,000	50,000	50,000	200,000	0
0451	623180-1933942	48189	Furnizim me gypa PVC	13,025	0	0	13,025	20,000	20,000	53,025	0
0451	623180-1524930	40809	Meremetimi i rrugëve dhe trotuareve	60,000	40,000	0	100,000	10,000	10,000	120,000	0
0451	623180-1525036	40817	Ndertimi i rrugeve ne komunen e Rahovecit	100,000	0	0	100,000	80,000	85,000	265,000	0
0451	623180-1933758	48032	Përmirësimi i kanalizimeve në Pastasel dhe venbanime tjera në Komunën	100,000	0	0	100,000	70,000	100,000	270,000	0
0451	623180-1933954	48200	Ndërtimi i semaforëve të rinjë	0	20,000	0	20,000	0	0	20,000	0
0451	623180-1524990	40814	Ndriçimi publik dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues	60,000	0	0	60,000	80,000	80,000	220,000	0
0451	623180-2036770	49862	Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale (Gropa Septike)	100,000	0	0	100,000	150,000	205,000	455,000	0
			<b>Totali - Infrastruktura Publike - Rahovec</b>	<b>955,025</b>	<b>75,000</b>	<b>0</b>	<b>1,030,025</b>	<b>1,051,000</b>	<b>1,190,000</b>	<b>3,271,025</b>	<b>0</b>
apo duhet me kategorizua zonën e mbrojtur, atëherë unë po mendoj se një vlerësim profesional i institutit për mbrojtjen e monumenteve I duhet si ekspertizë edhe komunës edhe këtij kuvendi. Kështu që unë po besoj që kuvendi i Komunës ka potenciale që ti diskutoj deri ne atë masë sa që te mos del jashtë konditave ligjore, sepse nëse një kryetar paraprak te cilin e respektoj nuk ka qenë ne gjendje që me mbërrit që kuvendit te komunës me ja ofrua një reduktim te zonës se mbrojtur për shkak se ato veprat penale kurrë nuk vjetrohen dhe nuk është i interesuar askush që as kuvendit te komunës as kryesuesit as kryetarit dhe asnjë kryetari tjetër ne ardhje me bo veprime te cilat presin. Dhe sigurisht unë jam ne dijeni që komunal nuk ka PZHK dhe hartë zonale dhe e di që komuna është ne fazën përfundimtare te certifikimit te PZHK-së dhe rrjedhimisht edhe ne përgatitje le te themi përfundimtare te hartës zonale për te cilën keni dhanë kontribut edhe ti shume z. Fehmi Hoxha si pjesë e këtij ekipi. Por ideja ime është që mos te ngutemi dhe kemi mundësi te përgatitemi ndoshta me mire edhe me pas një rekomandim me te veçantë prej institucioneve me kompetente sepse zona e mbrojtur nuk është zone e mbrojtur e komunës sepse komuna nuk aprovon ligje. Por edhe PZHK-ja edhe harta zonale duhet me qenë ne përputhje e sidomos te zonat e mbrojtura duhet m pas shume kujdes. Pra ne këtë kuptim jam I vetëdijshëm edhe ndërgjegjshëm çfarë po flas edhe ne këtë vendim nuk i iki përgjegjësive asnjëherë dhe nuk jam për me ruajt status kohen as me koncept as me filozofi e as me praktiken e veprimeve te mia mirëpo nuk duhet me u ngutë sepse kuvendi ka mandate ende dhe po presim ne ndërkohë mos po na vjen diçka pasi tash është edhe ndërrimi i qeverive duhet ta kemi parasysh që mos te ngutemi sepse sikur te ishte kryer lehte kjo ri kufizimi apo reduktimi i zonës se mbrojtur me siguri do ishte kryer para 5 vite edhe e dini mire z. Fehmi Hoxha se nuk është e thjeshtë prandaj edhe jam i sinqertë dhe korrekt po tregohem që s'po ngutemi dhe ne mundemi me debatua sa here te doni mirëpo te shohim seancën tjetër mos kemi ndonjë rrethanë me te re.

**Fehmi Hoxha** – Po ju informoj se edhe një muaj keni afat pasi 6 muaj para zgjedhjeve nuk kemi te drejtë te marrim asnjë vendimmarje për planifikim hapësinore, vetëm si informatë po ju jap.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Hoxha për sqarimin, të nderuar kolegë e qesim ne votim rendin e ditës. Atëherë aprovohet rendi i ditës me një votë kundër. Kalojmë në pikën e parë te rendit të ditës:

## 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Të nderuar kolegë kuvendarë, a keni diçka rrith procesverbalit.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë te pranishmit ne salle. Kam një ndërhyrje te vogël tek procesverbalit ne faqe 4 tek diskutimi im, që me tepër është gabim teknik, te bashkë pagesat ka qen diskutimi te bashkë pagesat e pacienteve ne shërbimet që i marrin para institucioneve shëndetësore. Pra duhet të bashkë pagesat duhet me qenë, po e bëj këtë ndërhyrje pasi e di që do ta përmendim këtë term edhe herëve tjera dhe te mos bëhet gabimi teknik.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Cena, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim pikën e parë te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e dytë te rendit te ditës:

## 2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

**Afrim Berisha** – I nderuar kryesues i Kuvendit z. Afrim Dina, i nderuar kryetar i komunës shkëlqesia jua, z. Smajl Latifi, te respektuar ju drejtore te drejtorive, kolegë asamblist. Përfaqësues të mediave dhe gjithë ju të pranishëm. Unë do të ngrisë dy pyetje që kanë të bëjnë, njëra për trajtimin e ujërave nga reshjet atmosferike te cilat sjellin problem tek qytetaret e fshatit ku si pasojë e reshjeve dhe jo trajtimi i duhur këtyre përroskave bëhet përmbytja në ekonomitë e tyre familjare dhe po ashtu përreth zonave te fushave, arave. E di që kanë një kosto te lartë mirëpo shpresoj që të merren masa nga organet kompetente të komunës tone. Pyetja e dytë ka të bëj me deponitë e mbeturinave te krijuara veçanërisht afér lumit Drini i Bardhë ku janë krijuar mbeturina me vëllime te ndryshme ku dihet se çfarë roli luan ajo pjesë ne ekosistemin tone. Pra thjesht zona përreth Drinit është në një situate te keqe.

**Ali Zhuniqi** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë kabinet dhe ju kolegë këshilltarë. Unë deshta te ndërlidhem te çështja e seancës se kaluar te çështja e komisionit për përzgjedhjen e drejtoreve, ku ne bazë te

informatave që ne i posedojmë, ne disa shkolla ku konkursi është ne finalizim kemi emra te cilët janë kryekëput politik dhe këtë pyetje deshta me ja parashtrua drejtorit që një ndër emrat që nuk është ftuar ne intervistë pavarësisht përvojës se tij ne menaxhim si drejtor, fjalë është për Gëzim Sahitaj i cili ka aplikuar por nuk është ftuar ne intervista për një shkollë te caktuar e konkretisht në shkollën Rilindja në Çifllak. A kish pas mundësi drejtori me na dhanë sqarime se pse gjithë këta drejtorë kanë ngjyra politike dhe pse zotériu ne fjalë që ka përvojë ne menaxhim nuk është ftuar ne intervistë për përzgjedhje te drejtorit.

**Refki Kryeziu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkyetarin, drejtoret e drejtorive dhe ju kolegë asamblistë. Unë desha të parashtroj një pyetje drejtorit shërbimeve publike, në fakt drejtori po punon shume në gjithë territorin e komunës, mirëpo janë edhe disa rrugë ne fshatin Xerxe që qysh ne fillim te mandatit kam kërkuar që brenda mundësive buxhetore te komunës të sanohen, si rruga Rustem Kryeziu e cila nuk ka kanalizim, ujësjellës dhe nuk është e kubëzuar. Kështu që kisha kërkuar që sipas mundësive të intervenohet në këtë rrugë dhe rruga tjetër është 5 Maji tek varrezat e fshatit e cila është e asfaltuar mirëpo ka shume gropë dhe ka nevoje te sanohet dhe te vazhdohet edhe me tutje pasi është edhe një lagje gjate asaj rruge që nuk është e kubëzuar.

**Munib Durguti** – Përshëndetje për kryesuesin, kryetarin, kolegë asamblistë, përfaqësues te mediave dhe gjithë ju te pranishëm. Çështja e parë që dëshiroj me ngritë ne këtë seancë është çështja e noterit që tash e disa muaj komuna ka mbetur pa noter. Ish ministri i Drejtësisë ka bërë një zgjidhje të përkohshme duke caktuar dy noterë me seli ne Prizren që ti shërbejnë komunës se Rahovecit. Besoj që ka qenë zgjidhje e përkohshme por jo e mirë pasi ankesat janë te shumta për mënyrën e trajtimit te qytetareve tek noterët në Prizren dhe unë kërkoi prej kryetarit që të adresohet tek Ministria e Drejtësisë dhe te kërkojë një zgjidhje me te qëndrueshme duke e bartur një noter ne komunën tonë apo duke caktuar një noter me vendim te përkohshëm apo ushtrues detyre. Besoj që nuk është e logjikshme që një qytet i 60,000 banoreve të shkojë te një noter dhe te mos vij ai noter në qytetin e Rahovecit. Pastaj pyetja e dytë është se ka kohë që e kam ngritur çështjen e legalizimit te ndërtesave që komuna e Rahovecit i ka ndërtuar me bashkëfinancim me një kompani private, ku sot e kësaj dite ato ndërtesa kanë mbetur pa pranim teknik dhe nuk janë te legalizuara pra bëhet fjalë për ndërtesarat që i kemi përball objektit te komunës. Unë kujtoj që komuna ka qenë aksionare dhe tash mbi 15 vite te kësaj problematike nuk i është dhënë një zgjidhje. Komuna i ka shit pjesën e banesave që i ka pasur ne pronësi dhe nuk ka pranuar që ta përfundoj projektin apo ta bëj pranimin teknik te atij projekti. Unë besoj që ka mundur me pas edhe parregullsi gjate ndërtimit apo ekzekutimit te atij projekti mirëpo nuk mund te pajtohem asnjëherë që kjo çështje duhet te shtyhet ne pafundësi, pasi ka pasur parregullsi dhe nuk kemi çfarë të bëjmë pasi janë rreth 50 që nuk munden me bo shitblerjen e banesës për shkak te këtij mospranimi teknik. Po ashtu tash e kemi edhe ligjin për legalizim dhe prape është kusht pranimi teknik i objektit ne mënyrë që pronaret te bartin banesën ne emrin e vet. Ka pasur disa raste te freskëta që unë e di shume mire që kanë kërkuar me bo kontratën e shitblerjes te noteri dhe peng ka qenë pasi nuk ka fletë poseduese pastaj nuk është e regjistruar ne kadastër dhe nuk mund te bëni qarkullim juridik. Unë besoj që kjo situate dhe kjo brengë qytetare duhet te bartet te institucionet përgjegjëse ne radhë të parë te kryetari dhe te drejtori I urbanizmit dhe ti bëhet një zgjidhje adekuate kësaj problematike.

**Rukije Krasniqi** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Pyetja e pare është për drejtorin e DKA-së, se a ka mundësi me na tregua numrin e nxënësve te shkollës se muzikës dhe numrin e mësimdhënësve se a janë ne përputhshmëri me numrin e nxënësve ne këtë shkollë. Pyetja e dytë është e përbashkët për kryesuesin e kuvendit dhe drejtorin e Financave, se kur do te bëhen pagesat e komisioneve pasi ka me shume se 3 muaj që është kryer puna.

**Shqipe Kryeziu** – Faleminderit kryesues dhe përshëndetje për te gjithë. Pyetja ime i adresohet kryetarit te komunës rreth kërkesës se mësimdhënësve për rroga jubilare për shujta dhe për udhëtim.

**Trajko Shariq** – Përshëndetje për te gjithë te pranishmit. Deshta me ngritë një çështje rrëth varrezave ortodokse apo serbe, pasi e dini që ne kemi te drejtën e shfrytëzimit te varrezave tek varrezat e vjetra mirëpo çdo here pas kryerjes se ceremonisë se varrimit vjen deri te vandalizmi i atyre varrezave gjegjësisht simboleve tona, kështu që varrezat është çështje e shenjtë edhe do te doja që ta gjykon rastin e shkatërrimit te varrezave ortodokse ne këtë rast duke mos përjashtuar edhe varrezat e tjera zgjidhen sa i përket kësaj çështje.

**Florida Bajraktari** – Përshëndetje për ju kryesues, kryetarin, nënkyryetarin, drejtoret, kolegë asamblistë, media dhe gjithë te pranishmit në sallë. Unë kam një kërkesë për drejtorin e shërbimeve publike z.Përparim Krasniqi, siç e tha edhe kolegu Refki se drejtori po punon shume mirëpo jo ne krejt vendet si p.sh. ne Brestoc e ka lënë shume anash, pasi kam shume kërkesa prej banoreve aty se sa here te shkoj te familja ime ka shume kërkesa nga banoret aty, si tek rruga e Diturisë është bllokuar komplet kanalizimi edhe ka kriuar shume vështirësi edhe neper shtëpia pasi krijon shume erë te keqe nga bllokimi I kanalizimit, pasi përroska aty është shume ne gjendje te keqe edhe prej kanalizimit edhe prej ujërave që shkaktohen nga vërvshimet që shkaktohen nga reshjet e mëdha te shiut e po kanë problem neper podrumet e shtëpive te tyre. Kështu që dua te di se a do të ndërmerrret diçka rrëth kësaj çështje.

**Kryetari** – Përshëndetje për te gjithë. Atëherë janë disa pyetje te cilat unë do ti përgjigjë rrëth disa kërkesave dhe shqetësimet e sigurisht që do te përgjigjen edhe drejtoret specifisht. Pyetja e parashtruar nga Afrim Berisha për problemet që po shkaktojnë ujërat atmosferik ne Dejnë dhe plot vendbanime tjera. Projekti kryesor është I hartuar dhe shpresojmë me i fillua procedurat sivjet për trajtimin e ujërave atmosferik në Dejnë pastaj ne Sopniq, në lumen Dullo që do te vazhdoj deri ne Rimnik. Kështu që projektet janë gati por vetëm po e presim hartimin e projektit per Çifllak për shkak se aty kemi një situate shume problematike për shkak te pikës se ultë dhe nuk ka shume nivele. Pra ne shpresojmë që sivjet te kemi aktivitete ne drejtim te realizimit te projekteve te trajtimit te ujërave atmosferik për shkak te rreziqeve që po i vine komunës tone. Pastaj deponitë e egra ne Drinin e Bardh janë evidente dhe ju e keni pare se po krijohet ne vazhdimesi deponi dhe ju mund te thuani se ku janë inspektorët. Por unë ju them se inspektoret nuk janë roje por kanë për detyre me veprua nëse kanë ndonjë informatë dhe për këtë informatat janë te munguara sa I takon se kush I hedhë mbeturinat për shkak se njerëzit po hezitojnë me tregua nëpër vende jo të duhura. Fatkeqësisht Drini I Bardh është I mbuluar me plot stoqë te mbeturinave te llojeve te ndryshme si mbetje shtazore e deri te ato te ngurta apo inerte. Unë I kam pae vet tek Ura e Fshejtë me rastin e operimit te ekipit te gardës se togut te ujërave për gjetjen te trupit te pajetë të mësimdhënësit, vërtet ekziston gjendje e tmerrshme e mbeturinave te llojllojshme si shporeta, frigoriferë e shume gjësende tjera. Po ashtu kemi deponi ilegale skaje rrugëve dhe po presim edhe pak se të teret dhe fatkeqësisht jeni detyruar me i pastrua prapë edhe unë e lusë kuvendin e komunës edhe te gjitha institucionet edhe qytetaret që te bashkëpunojnë me shume edhe me policinë që e ka të drejtën e autorizimit për me shqiptua gjoba mandatore por edhe inspektoratin tone që është aktiv 24 orë dhe që paguhet për punën shtesë. Vazhdimeshi I kemi larguar vullnetarisht por nuk mundemi me qenë te sigurt akoma që elementi i papërgjegjshëm dhe I pandërgjegjshëm nuk do te veproj edhe me tutje. Por ka shume me pak mbeturina që ka pas po ashtu ka me shume vëmendje dhe kujdes për shkak se janë prioritet por nuk mund te themi që nuk ka mbeturina dhe deponi ilegale. Ne do ti pastrojmë sidomos ne vende ku sateliti pasi kemi një komunikim dhe bashkëpunim me [ndreqe.com](http://ndreqe.com) dhe me organet e tjera të Ministrisë edhe me grupin e performances me gjithë ekipin që një nga indikatorët është edhe deponitë ilegal si pastrimi apo eliminimi i deponive ilegale. Si konkluzë me pak do te këtë mbeturina por garanca për me i asgjësua deponitë ilegale është përmes një bashkëpunimi dhe partneriteti të qëndrueshëm midis qytetareve që e dojnë këtë vend dhe organeve që janë kompetente me i dënuata që nuk marrin vesh apo janë te pandërgjegjshëm. Reth konkursit për drejtor që e ka ngritë asamblisti Ali Zhuniqi, do të përgjigjet drejtori DKA-së. Pastaj te çështja e rrugës ne Xerxe që e ka ngritë Refki Kryeziu do te përgjigjet drejtori i shërbimeve publike. Pastaj pyetja e parashtruar nga Munib

Durguti rrëth çështjes se noterit, unë qysh sot mundem me ju adresua ministrisë se Drejtësisë gjegjësishët ministres se Drejtësisë, pasi e di që ka pasur një konkurs me herët dhe ka pasur mjaft telashe për përgjedhjen e noterëve dhe jam për me bo zgjidhje e sigurisht edhe ne e kemi evidentua këtë shqetësim pasi na kanë ardh edhe te ne mirëpo ju e dini Munib se vet jeni jurist me profesion se ne nuk jemi kompetent me ofrue këtë zgjidhje por marrim përgjegjësi me kërkua këtë shqetësim me ngritë ne adresat e duhura dhe nuk e di se a ka të drejtë ligjore me emërua ndonjë noter te përkohshëm por sidoqoftë ju mbetet atyre, por ne mundemi me ju adresua ne emër te kuvenit te komunës dhe kryetarit te komunës këtë shqetësim ministres se Drejtësisë rrëth kësaj çështje. Te legalizimi i ndërtueseve te cilat janë ndërtuar pasi e mbaj mend nga mandati parë, kurse ne mandatin e dytë për asnjë minutë nuk jam marr për shkak se nuk ka kërkuar dikush që me u marr për këtë, por kur jam marr ne mandatin e parë për këtë temë e kam kuptuar që edhe ky objekt ku jemi ne tash nuk është bërë pranimi teknik, pra objekti i komunës se re nuk ka pranim teknik dhe aq është e komplikuar kjo situatë saqë edhe prokuroria speciale është dashtë me u marr me këtë punë. Ky objekt është i ndërlidhur diçka me atje, pasi atje i di problemet siç janë dhe i kuptoj shqetësimet e atyre ë banojnë aty dhe që nuk mundem me bo asgjë rrëth kësaj por ky objekt është pa pranim teknik sepse është me kate që sipas informacioni burimor zyrtar që e kom pasur atëherë, njëherë është deshtë me u bo pranimi teknik i katit te parë e pastaj i katit dytë dhe krejt ne fund s'ka pranim teknik. Këtë çështje e kam pas ngritur përmes avokates se komunës Fitneta Kasapi – Iska dhe jemi munduar me i bo zgjidhje për hire te banoreve dhe kur e kam kuptuar që sa keq janë institucionet komunale dhe sa keq kanë veprua jo me gabime dhe sa keq është punuar dhe sa komplekse është kjo situatë, vërtet nuk e di se cila gjykatë mundet m i dhanë zgjidhje kësaj apo ndoshta ata edhe e kanë dërgua lëndët ne gjykatë ndonjëri por nuk po besoj që komuna jonë mundet me i dhanë zgjidhje te lehtë te thjesht edhe epilog pozitiv me i dhanë kësaj çështje shpejt. Por meqenëse u ngritë kjo teme unë do te provoj me këqyr edhe njëherë bashke me zyrën ligjore bashke me zyrën e urbanizmit në përputhje me ligjin e ri.

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit kryesues, po e shfrytëzoj rastin për një pyetje për kryetarin, te ndërtesa për banim social apo rastet ne nevojë e cila para 4 vite ka qenë ne fazën përfundimtare, dua te kem si informatë se deri ku ka mbërrri, a është bërë pranimi teknik pastaj a është marrë certifikata e përdorimit dhe nëse po atëherë pse nuk sillet ne kuvenit edhe te procedohet që ti ndahet njerëzve dhe familjeve që vërtet ka shume që janë ne nevojë edhe te ecim përpara, pasi po besoj që 4 vite kaluan edhe kjo punë është e kryer sa kam informatë, atëherë pse nuk po procedohet ne kuvenit edhe ti japim njerëzve ë kanë nevojë, duke u bazuar gjithsesi ne planin 3 vjeçar për banim që është dokument i votuar ne kuvenin komunal.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Hoxha, atëherë kryetari ju përgjigj disa pyetjeve që i adresuan kuvenaret, kështu që edhe drejtoret mund te përgjigjen për ato që mund te përgjigjen nga ana e tyre.

**Avni Morina** – Përshtendetje për te gjithë, unë kisha dy apo tre pyetje, si pyetja e parashtruar nga z. Ali Zhuniqi se pse nuk janë ftuar drejtoret e shkollave ne intervistë. Atëherë ju informoj se konkursi për drejtoren të shkollave është ne procedurë dhe sot do te mbahet intervista e kandidateve dhe kësaj interviste i ka paraprirë para një jave kontrollimi i dosjeve te kandidateve nga komisioni i emëruar nga DKA-ja, Komuna dhe nga MASHT-i. Dhe pas verifikimit te dokumentacionit te kandidateve, dy prej kandidateve nuk janë ftuar ne interviste për shkak se nuk i plotësojnë kriteret sipas udhëzimit administrativ për përgjedhjen e drejtoreve, unë nuk e di se çfarë ngjyra kanë ata por sipas komisionit dhe sipas udhëzimit administrativ ata nuk i plotësojnë kriteret. Pastaj një pyetje tjetër e parashtruar nga Rukije Krasniqi ishte rrëth numrit te nxënësve dhe numrit te mësimdhënësve ne shkollën e muzikës, ku numri i nxënësve vazhdimisht po vjen duke u rritur ne atë shkolle që është afërisht 230 nxënës kurse për mësimdhënës nuk e di saktë që për këtë duhet ta pyesim drejtorin e shkollës, që me sa di unë janë afërisht 10-të, por nuk e di sa i bien raporti mësimdhënës nxënës, megjithëse për nivel komunal raporti mësimdhënës nxënës është 12 për komunën tonë. Ne kemi pasur një mbledhje para dy jave me Ministrinë e Arsimit dhe ka qenë një raport aty, ku ka komuna që kanë me shume si

p.sh. Fushë Kosova ne report nxënës mësimdhënës pra e vetmja komunë që ka mbi ngarkesë neper shkolla ndërsa neper komuna tjera ka zvogëlim. Sipas një udhëzimi administrativ që ka qenë ne vitet e shkuara rapporti mësimdhënës nxënës duhet të jetë 21.3 mirëpo ne nivel vendi ka dalë 14 sipas këtij reporti, por po ashtu ka komuna që ka raport një mësimdhënës 7 nxënës e po ashtu edhe me 5 nxënës, kurse komuna janë e ka 1 mësimdhënës me 12 nxënës, për arsy se kemi 745 mësimdhënës që japid mësim drejtpërdrejt ne arsim ndërsa i kemi 9552 nxënës, që realisht nga ky report ne jemi nga mesatarja e vendit. Te shkolla e muzikës besoj që jemi aty diku afër, sepse në vitet e fundit ka pasur interesim te nxënësve pasi ka drejtime atraktive aty dhe mësimdhënësit që janë aty janë te përzgjedhur edhe me konkurs edhe janë adekuat sipas profileve te tyre që i kanë si për violinë, kitarë, piano etj. Kështu që për me saktë se sa është numri i sakte i mësimdhënësve do ti marrim informatat dhe do të ju japid përgjigje.

**Përparim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë. Pjetja e parashtruar nga z. Refki Kryeziu, për këtë vite sa për informatë i kemi dy rrugë te kontraktuara ne vitin 2020 në fshatin Xerxe si rruga Rrust Kabashi rrreth 400 metra dhe po ashtu është një rrugë ne lagjen e epërmë rrreth 220 metra. Në pjesën ku është parashtruar kërkesa juaj ne lagjen Kryeziu, e kemi te kontraktuar edhe rrjetin e ujërave fekale mirëpo për shkak te problemeve pronësore që i kemi te mëdha, në po bëjmë përpjekje me bo një zgjidhje dhe pas zgjidhjes se rrjetit te ujërave fekale atëherë do te planifikohet ndërtimi i rrugëve. Ndërsa sa i përket sanimit te rrugëve për momentin nuk kemi kontratë kështu që shumë shpejt do te lidhim konratë me tender për mirëmbajtjen e rrugëve ne terë komunën e Rahovecit dhe do te ndahet ne dy lote, njëra me kubëza dhe tjetra me asfalt dhe shpresoj që te gjitha këto kërkesa do te realizohen. Pastaj sa i përket kërkësës se Floridës për fshatin Brestoc, aty ne e kemi në kontratë rrjetin e kanalizimit mirëpo është një problem me i madhe aty ne atë lagje se është një kanal afër 350 metra dhe se pari duhet te ndërtohet kanali dhe paralelisht te vendoset kolektori I ujërave te zeza ne te dy anët siç është rasti që po ndërtohet kanali ne fshatin Nagavc dhe që po lidhet me pjesën e Hoçës se vogël dhe Brestocit që është një degëzim që ndoshta drejtori i Urbanizmit që bashkërisht do të tentojmë te bëjmë diçka vitin e ardhshëm pasi ne këtë vit nuk ka mundësi, pasi nëse ndërtohet kanalizimi atëherë është shume problem për shkak te ujërave te mëdha që sjell ajo përroskë atëherë do te dëmtohet edhe kanalizimi, kështu që aty duhet paralelisht te ndërtohet kanali edhe paralelisht edhe kolektori dhe te bëhet një zgjidhje. Kështu që mos hezitoni te bëni kërkesa pasi bashkërisht do mundohemi të kryejmë punë dhe gjithashtu falënderues për çdo informatë dhe vlerësimin që keni ndaj nesh.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, pra çështjen që e ngriti Florida Bajraktari edhe unë kam qenë prezentë ne vendin e ngjarjes dhe kemi komunikuar dhe kemi pas mundësitë që ne mënyrë emergjente me gjet një zgjidhje rrreth këtij problem. Po ashtu edhe Rukije Krasniqi mu adresua rrreth pagesave te komisioneve, kështu që do te shohim me drejtorin e Financave që te gjithë anëtarët që janë neper komisione që ti shqyrtojnë dhe ti trajtojnë e sigurisht te shohim mundësitë si janë. Të nderuar kolegë kuvendarë, kalojmë ne pikën e tretë te rendit te ditës:

### **3. Shqyrtimi dhe aprovimi I Draft rregullores komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës se Rahovecit.**

**Mirsad Shala** – I nderuar kryesues i kuvendit, drejtor te drejtorive, anëtarë te kuvendit dhe gjithë ju të pranishëm. Komuna e Rahovecit ne vitet e mëparshme ka pasur një rregulllore komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Mirëpo ne vitin 2019, MAPL-ja ka nxjerrë një udhëzim administrativ për organizimin funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Andaj ne baze te këtij udhëzimi administrativ edhe ne si komunë jemi te obliguar që të bëjmë disa ndryshime ne këtë rregulllore. Në mbledhjet e mëhershme te kuvendit komunal është marr vendim për dalje ne debat publik dhe ne këtë rregulllore janë bërë disa ndryshime esenciale, te komisioni për përzgjedhjen e këshillave lokale, formimi i këshillave lokale që duhet të ketë nga 5-9 anëtarë që varet nga komuna, që është kriter e cila duhet të ketë për zgjedhjen e këshillave lokale, komisioni

i ankesave, mandati i këshillave lokal që është 4 vite. Ky udhëzim administrativ e ka obligua kryetarin e komunës që të mbajë dy konsultime me këshillat lokalë dhe me pastaj është një risi ne bazë te këtij udhëzimi administrativ është se kryetaret e këshillave dhe lagjeve urbane duhet te paguhen me mëditje d.m.th. 6 takime duhet te mbahen patjetër dhe te paguhen nga ky këshill. Dhe ju informoj se kjo rregullore ka qenë e publikuar ne webfaqen e komunës dhe ne platformën për konsultime publike te qeverisë se Kosovës ne te cilën ne si komunë jemi te obliguar që ti publikojmë te gjitha dokumentet që i përgatit komuna siç janë rregulloret, planet, koncept planet etj. Andaj pasi që janë ndjekur te gjitha procedurat e kërkua me ligjet që janë ne fuqi, pres nga ju kuvendare te nderuar që ta votojmë këtë dokument.

**Kryesuesi – Faleminderit z. Shala,** gjithsesi ne e kemi pasur edhe ne komitetin për Politikë dhe Financa dhe i kemi rekomandua Kuvendit.

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, e falënderoj zyrtarin ligjor që dha sqarime rrith rregullores por unë kam një shqetësim pasi ne disa seanca u krijuat një praktik jo e mirë ne kuvend komunal sepse çdo rregullore që vjen ne kuvend prezantohet prej zyrës ligjore, nuk po mundem te kuptoj a duhet rregullorja te prezantohet çdo herë nga zyra ligjore, por sipas mendimit tim duhet te prezantohet nga sponzorizuesi i saj. Nëse ka nevojë një rregullore atëherë duhet me dal drejtori edhe me dhanë arsyen se pse ka nevojë një rregullore ku u hartu prej zyrës ligjore por nuk e kam te qartë se pse duhet kjo rregullore me ardhë edhe kush po e sponsorizon këtë rregullore. Pasi rregulla e thotë që duhet drejtori me dal edhe me dhanë sqarime për nevojat e kësaj rregullore dhe natyrisht ato rregullore hynë ne kuadër te planit te kuvendit. Pra është një rregullore shume e mirë dhe përderisa i keni këshillat e lagjeve dhe këshillat e fshatrave duhet te ketë një rregullore që e sqaron mandatin e tyre pasi aty e pash që ka mjete për kompensimin e ikasimit te tyre dhe kjo është shume pozitive. Ne aspektin teknik ne hyrje është shume mirë titulli i rregullores por ne faqen e dytë ka një gabim ku besoj që duhet me u shqyrtua edhe me u përmirësua, ku ne fillim thotë rregullore për organizimin funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat kurse ne faqen tjeter thotë ne shumës, rregullore për organizimin funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Unë besoj që kjo rregullore ka mundur me ardh prej nivelit qendror edhe i është referua te gjitha komunave por këtë gabim teknik besoj që do ta përmirësoni.

**Kryesuesi – Faleminderit z.Durguti,** sponzorizimi i kësaj rregullore është ne drejtorinë e administratës dhe i kemi pasur disa takime ku ka qenë edhe Syri vizion ku kam marr pjesë edhe vet ne disa takime dhe është bërë një plotësim ndryshim i asaj që me herët i kemi pasur anëtaret e kuvendit që u deshtë me marr pjesë ne zgjedhjen e këshillit te fshatrave me 4 asamblistë kurse tanë janë me 3 dhe gjithsesi kjo rregullore është unike për te gjithë komunat për shkak se me muajt pagesat me u bo për kryetaret e këshillave te fshatrave.

**Masar Popaj** – Përvendetje për te gjithë. Unë desha të parashtroj një pyetje që kryetaret e lagjeve dhe fshatrave që janë pasi me sa e di unë kanë pasur mandat 3 vjeçar, a do i vazhdohet që edhe për një vite shtesë pra a vlen edhe për mandatin tjeter.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, unë desha vetëm pak me kontribuua rrith kësaj rregullore, pasi mendoj se ne e kemi shqyrtuar ashtu si u tha edhe ne komitetin për Politikë dhe Financa, që edhe unë mendoj si rregullore i plotëson kushtet dhe i ka te gjitha elementet e nevojshme për mënyrën e zgjedhjes funksionimit edhe bashkëpunimit me komunën. Po ashtu u cekë si risi se është paguar mënyra financimit te këshillave lokale pastaj stimulimi i kryetareve te këshillave lokale edhe po e themi se jemi pikërisht ne delegatet e Komitetit për Politike dhe Financa që e kemi iniciuar këtë çështje dhe kjo buron prej takimeve buxhetore që i kemi pasur me qytetaret edhe me këshillat ku ata e kanë një rol shume te madhe dhe mendoj që ky financim ka lindur nga aty dhe është e nevojshme që te stimulohet që te jetë si motiv për ata që te punojnë edhe me mirë ë kanë punuar deri tash, megjithëse është ne kuadër te përgjegjësisë se tyre. Kështu që unë mendoj se rregullorja është mjaft e qartë dhe e plotësuar dhe ne duhet ta kalojmë kështu si është.

**Mirsad Shala** – Siç e dini tash është fundi I mandatit sepse ata kanë pasur 4 vjet mandate edhe atë mëhershmit por edhe këta do te kenë 4 vjet, kështu që mandate i tyre vazhdon deri në konstituimin e kuvendit te ri pas zgjedhjeve dhe pas zgjedhjeve lokale që do te mbahen kjo rregullore do te hynë ne fuqi edhe do te fillon mandate i këtyre kryetareve te këshillave dhe lagjeve që do te zgjidhen ne te ardhmen.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Shala, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim pikën e tretë te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tretë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e katërt te rendit te ditës:

**4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për dalje ne debat publik të Draft rregullores komunale për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak se një vite të pronës se paluajtshme komunale.**

**Mirsad Shala** – Faleminderit kryesues, në bazë te ligjit për dhënien në shfrytëzim te pronës të paluajtshme te komunës si dhe ne mbështetje te nenit 7 te rregullores 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies ne shfrytëzim në këmbim te pronës se paluajtshme te komunës, ky ligj edhe kjo rregullore i ka obligua komunat që te nxjerrin një rregullore te veçantë për dhënien ne shfrytëzim me pak se një vite te pronës komunale. Dhënia ne shfrytëzim me pak se një vite te pronës komunale siç e kemi cekur edhe nenin 5 te kësaj rregullore është për hapësirat publike siç janë parqet, sheshet, bulevardet, shtëpia e kulturës, kinematë, teatrot, hapësirat publike para lokaleve, lokalet ne pronësi te komunës që kanë që janë ato që kanë karakter të përkohshëm siç janë kioskat si dhe hapësirat publike rrëth vend punishteve. Kjo rregullore është bërë ne 3 kapituj, dispozitat e përgjithshme siç janë qëllimi, kufizimet, dhënia ne shfrytëzim e pronës se komunës me pak se një vite, kriteret që duhet të plotësojnë për dhënien ne shfrytëzim te pronës se paluajtshme që kemi te bëjmë edhe me dhënien ne shfrytëzim te pronës se paluajtshme për organizatat e shoqërisë civile, kushtet që janë te parapara për aplikim, komisioni që do te jetë i formuar nga ana e kuvendit te komunës, komisioni i ankesave etj. Andaj kjo rregullore pas shqyrtimit te juaj do te dal ne debat publik si dhe ne platformën e qeverisë për konsultime publike që jemi ne te obliguar që ti publikojmë te gjitha rregulloret, planet e të tjera për konsultim publik.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Shala, atëherë nëse nuk ka dikush diçka sa i takon pikës se katërt te rendit te ditës, e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e pestë te rendit te ditës:

**5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për subvencionimin e lindjeve në QKMF në Rahovec.**

**Samir Mustafa** – Përshëndetje për te gjithë. Në mbështetje te nenit 13/58 te ligjit për vetëqeverisje lokale, kryetari i komunës i propozon kuvendit te komunës te Rahovecit te merret vendimi ne te cilat gratë nënët tonë të cilët lindin ne qendrën kryesore te Mjekësisë familjare te subvencionohen nga 200 euro. Subvencionimi do te bëhet nga mjetet vetanake te komunës se Rahovecit përkatësisht nga kodi i subvencioneve pran drejtorisë se Shëndetësisë dhe Përkujdesje sociale. Kërkoi që ta miratoni propozim vendimin e kryetarit.

**Sali Sallteku** – Unë kërkoi një sqarim shtesë nga ana e drejtorit, se a vlen kjo vetëm për ata që lindin ne QKMF duhet te subvencionohen apo edhe për te tjerët sepse ka shume që lindin edhe neper qendra tjera si Prizren, Gjakovë, Prishtinë, për shkak se nuk e shoh të arsyeshme te imponohet kjo apo e keni ndaje dhe kjo nuk është aspak ne rregull pasi mendoj se është sanksionim, kështu që unë nuk jam për me votua këtë propozim vendim.

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, ju përgëzoj për iniciativën si propozim në përgjithësi për subvencionimin e lindjeve në komunën tonë, por unë nuk pajtohem që këtë ndarje me një arsyetim që materniteti i lindjeve ne QKMF përfaqëson nivelin primare shëndetësor, pra ka statusin e përcaktuar ne shëndetësi, pra është kompetent për çdo lindje pa komplikime d.m.th. këtu ne po e kufizojmë dhe po e diskriminojmë ato lindje që ka nevojë kujdesi sekondar, bile edhe për ato që janë te nivelit tertiar. Pra mbi këtë fushe ka shume komplikime dhe ka shume specifika dhe nëse marrim një vendim te tillë atëherë ne do ti diskriminojmë ato lindje që kanë komplikime dhe që kanë nevojë përtetje nivelit primar, pra ky është problemi.

Unë kisha propozua që ky propozim me u tërheq dhe me u analizua mire edhe me këto propozime që i kemi pasur dhe nëse nuk ka mundësi me 200 euro atëherë te shkohet me 100 euro por te subvencionohen te gjitha lindjet që bëhen në komunën tonë.

**Ali Zhuniqi** – Faleminderit kryesues, kjo sigurisht që i plotëson te gjitha pasi ka filluar me Prishtinën dhe ka vazhduar me Vushtrrinë e Mitrovicën dhe kjo është një iniciativë që rrjedhimisht ka rrjedhur prej lëvizjes Vetëvendosje, kështu që ne parim ne jemi për me shtyje që me plotësim ndryshim që me mbështet krejt me 100 euro por nëse vërtet dojmë me i subvencionua femrat që lindin ne QKMF ne Rahovec ato te subvencionohen me 200 euro kurse jashtë QKMF-së me 100 euro. Kështu që ne te kundërtën ne nuk e votojmë kështu siç është.

**Florida Bajraktari** – Faleminderit kryesues, vërtet me ka ardh shume mirë kur e kam pse këtë propozim ne rend te ditës, pasi sa me kujtohet këtë propozim e kam bërë në një prej mbledhjeve të kaluara kryetarit te komunës që te gjitha gratë lindin në QKMF në Rahovec te subvencionohen me një shume simbolike. Kryetari na patë premtuar se do të realizohet edhe tani po e bënë këtë, kështu që e falënderoj përfjalën e dhënë. Por si propozim shtesë e kam pasur edhe ne KPF që pa marr parasysh se ku lindin ato veçse dihen se janë gra te komunës tonë dhe duhet te subvencionohen me këtë shume sepse ne e dimë se materniteti i Rahovcit nuk i plotëson kushtet ngase te gjitha gratë e komunës tonë kanë dëshirë me lind këtu por nuk i plotëson kushtet, pasi aty nuk mund te bëhen operime, pasi nga përvoja ime se ne lindjen e kaluar e kam rrezikuar fëmijën, kështu që te gjitha gratë kanë dëshirë me lind këtu mirëpo ju imponohet me lind në ndonjë qendër tjetër, pra do te ishte mirë me qenë për te gjithë njëjtë për te gjitha gratë e komunës, pa marr parasysh se ku lindin.

**Fahrie Lushi** – Faleminderit kryesues, te nderuar kolegë këshilltar, drejtor te drejtorive dhe gjithë te pranishmit. Meqë te gjitha u përmendën si specifika te veçanta ne vet edhe besoj se si iniciativë është mjaft e qëlluar mirëpo duke pasur parasysh problematikat dhe duke pasur parasysh edhe faktet që i përmendën me herët parafolësit atëherë i duhet patjetër një rishikim apo analizë e mirëfilltë e këtij propozimi sepse ne këtë mënyrë ashtu siç është nuk çdo gjë ne rregull andaj unë mendoj që ta rishqyrtojmë edhe njëherë dhe ta forcojmë aty ku ka nevojë edhe pastaj ta sjellim ne kuvend.

**Masar Popaj** – Pjetja ime ishte se a do te subvencionohen edhe nga komunat tjera e sidomos nga Malisheva pasi unë kam informata se ka me tepër lindje nga Malisheva këtu ne Rahovec se vet te komunës se Rahovcit.

**Samir Mustafa** – Qëllimi është te subvencionohen lindjet që ndodhin ne QKMF, pasi ka qenë një tendencë e Ministrisë se shëndetësisë që të mbyllen repartet në këtë qendër kryesore te mjekësisë familjare. Komunat nuk kanë kapacitet të subvencionojnë çdo lindje, ato mundet qeveria ne nivel nacional me i subvencionua. Qëllimi është që te aktivizohen repartet ne këtë qendër kryesore te mjekësisë familjare edhe subvencionohen vetëm lindjet që kryhen në qendrën kryesore te mjekësisë familjare edhe aty kryhen lindjet normale ndërsa për komplikime te mëtejme shkojnë neper qendra spitalore.

**Kryesuesi** – Unë mendoj se është një iniciativë mjaft e mirë, pasi edhe ne me ne fund fillojmë te subvencionojmë lindjet, por e thash edhe me herët që e kemi edhe drejtorin e Financave që do të na jep kontributin rreth kësaj çështje.

**Afrim Limani** – Pëershëndetje për te gjithë ju te pranishëm. Në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa me takon vetëm ne pjesën rreth analizës financiare, pasi me këtë problematike sa i përket aspektit te financës kam qenë ne konsulta të vazdueshme me shefin e gjendjes civile dhe përafërsisht e dimë për disa krahasime se sa lindje munden me qenë ne komunën tonë. Mbi bazën e kësaj edhe pse ju e dini se buxhetit për këtë vite është planifikuar ne shtator te vitit te kaluar mirëpo ka mundësi dhe hapësirë që me i siguria mjetet deri ne fund te vitit. Ndërsa vitin e ardhshëm do ta futim ne planifikimet tona buxhetore edhe nuk besoj që do te kemi problem. Vlera afërsisht për një lindje siç e tha edhe drejtori është 200 euro që ne mundemi me subvencionua por ju jeni ata që vendosni dhe po ashtu jam ihtar me rrit numrin e lindjeve ne QKMF-në tonë por nëse do ta

me kishte pyetur mua dikush atëherë do te kisha thënë që kisha subvencionua te gjitha lindjet që lindin ne komunën tonë pra çdo banor që është i komunës tonë e kisha subvencionua pra edhe për këtë total te lindjeve mjetet financiare nuk besoj që do te ishte problem.

**Sali Sallteku** – Këtë sqarim me se miri edhe dha Munib Durguti si jurist, kështu që e lusë drejtorin me tërheq këtë pasi mund ta vështirësojmë edhe me tutje pasi njerëzit mashtrohen edhe munden edhe munden me pas probleme. Kështu që do te ishte me mirë me tërheq këtë pasi nuk ka pas asgjë për këtë jo vetëm tanë por edhe ne te kaluarën, kështu që do ishte me mirë me tërheq këtë drejtori pasi njerëzit vijnë për 200 euro edhe mund te këtë probleme dhe vështirësi gjate lindjes, pasi edhe me herët e potencoja edhe zonja Florida rrëth rastit te vet të lindjes, kështu që mendoj se është problematikë edhe e gruas që do te lindë por edhe e fëmijës që lind.

**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, në funksion te grupit për këtë çështje, me plot te drejtë ju kisha dhënë te drejtën kolegeve femra për këtë çështje mirëpo po pajtohem edhe me propozimin e drejtorit që qëllimi është me ruajt si institucion maternitetin ne kuadër te QKMF-së, kështu që ne mundemi me shkua deri ne fund te vitit kështu kurse për vitin tjetër te shqyrtohet mundësia e subvencionimit e te gjithëve.

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, unë kam disa informata që subvencionojnë si vdekjet ashtu edhe lindjet pra i subvencionojnë shpenzimet e varrimit si dhe lindjet, që kemi qytetin e Suharekës që besoj që drejtori i Financave mundet me marr informata te sakta. Por prape jam që mos te behet kjo gafë, pasi e kuptoj dëshirën e drejtorit që me nxitë performancen e lindjeve mirëpo kujtoj se ka forma tjera, pasi mandatin e kaluar unë si drejtor i Shëndetësisë kam siguruar 5 specializime te nivelit sekondar por edhe ne QKMF. Jam shume kritik pasi që 4 vjet asnjë specializim sekondar nuk është siguruar ne komunën tonë, pasi kam prit që te sigurohet netrologjia pasi e kemi repartin e dializës por edhe te paktën edhe dy gjinekolog, kështu që ne këtë formë ne mundemi me rrit performancen, numri i lindjeve pasi pasiguria e lindjeve që bëhen aty, pra këto janë forma që e nxisin performancen dhe kualitetin e jo ne këtë formë. Kështu që kemi me ardh që pas dy apo tre muaj që kemi me këqyr me shfuqizua këtë vendim.

**Rukije Krasniqi** – Faleminderit kryesues, mendoj që duhet me tregua një shembull konkret nga familjaret nëse krahasojmë komunën e Rahovecit me komunat tjera, pra QKMF-të ne këtë rast, pasi mamitë janë shumë në nivel pastaj përkujdesi është i mirë dhe gjithçka është ne rregull dhe nëse e krahasojmë me qendrat tjera si Gjakova apo Prizreni vërtet është për të ardh keq se ne çfarë gjendje shume te keqe nga myku i mureve dhe infekzionet që krijohen neper maternitetet e këtyre dy vendeve e sidomos ne Gjakovë. Qëllimi i këtij vendimi është që me rrit lindshmërinë në QKMF-të tona, pasi ne maternitetin tonë përkujdesi është jashtëzakonisht i madhe nëse e krahasojmë me komunat tjera, pasi kemi familjar edhe po flas krejt diçka konkrete për diçka që kam pae edhe që është shume e vërtetë. Pasi nuk munden me u krahasua mamitë e tona me të komunave tjera.

**Dervish Çadraku** – Përvendetje për te gjithë. Në komitetin për Politikë dhe Financa për këtë çështje kemi biseduar gjerë e gjatë dhe ndër te tjera kemi kërkuar që të na sjellin një statistikë për lindshmërinë e foshnjave në komunën tonë. Nuk e di se a kemi të dhëna rrëth kësaj çështje, kështu që nëse i kemi atëherë ne mundemi me ditë afërsi se sa banor janë shtuar për vitin 2020, pasi ne nivel te Kosovës po del që është mbi 19,000 dhe tash nëse ju na tregoni numrin sa është atëherë unë përkundrazi mendoj që janë shume pak 200 euro sepse askush nuk rrezikon për me lind një fëmijë pasi edhe deponimi e te rinjve pasi një fëmijë i duket edhe shume e mos te flasim për 2 apo 3. Por nëse ata i stimulojmë pasi kjo është edhe efekti i kësaj, unë mendoj kjo kish kalua me mirë sa i takon buxhetit tonë që te dihet banori i kujt është nëna e atij femiu, e jo me ardh prej vendeve tjera e sidomos nga vendet përreth. Kështu që origjina e prindit e dikton atë dhe ne nuk kemi nevojë me hezituar ketë punë dhe unë mendoj që kjo duhet me u bo edhe me një kosto me te lartë, që duke e ditur edhe saktësinë e lindshmërinë e vitit te kaluar, atëherë unë them 500 euro një çmim që ne njëfarë mënyre e arsyeton.

**Fehmi Cena** – Tash kjo çështje kaloj në debat dhe shume mire që u bë debat, pasi ne komitetin për Politikë dhe Financa kemi kërkuar disa sqarime dhe drejtori e kishte lënë që me na sqarua ne mbledhje te kuvendit. Pyetja është se cili është qëllimi i kësaj, pasi a është qëllimi me rrit natalitetin ne komunën tone apo me rrit vëllimin e punës ne maternitet. Ka mendime pozitive aq sa ka mendime hezituese dhe unë mendoj se ne se pari duhet që me mbrojte maternitetin që e kemi në kuadër te QKMF-së. Është bërë një luftë dhe një përpjekje e madhe atëherë kur është hapur materniteti, që është një shërbim shume i mirë dhe ka kryer shume punë te mire, që realisht pas luftës kemi pasur aty rrëth 1300 lindje dhe janë krye jashtëzakonisht mirë dhe probleme shëndetësore ne këtë institucion ka pasur edhe sigurisht se ka me pas, sigurisht edhe ne Gjakovë, Prizren edhe ne Rahovec, Tash ne fakt është një ekip e mirë aty që janë dy gjinekolog dhe një ekip me mami që kanë përvojën e tyre te mjaftueshme që do te thotë se suksesi ka qenë por ja që është krijuar njëfarë vetëdije te popullata që me shkua ne Prizren apo Gjakovë e që realisht edhe këtu kushtet janë. Natyrisht që ne do ti bëjmë kushtet edhe me te mira sa i përket renovimit te repartit ne kemi biseduar se ka mungesa edhe duhet i gjithë reparti te rinovalohet dhe ekipa është aty me një përvojë te mrekullueshme. Kështu që mos te harrojmë se lindja është proces normal dhe nuk është diçka patologjike që kërkohet që ku me dit se çfarë pune aty. Duhet t vetëdijesohen qytetaret se edhe këtu kushtet janë me te mira se sa ne spital dhe ekipa është shume e mirë por duhet që ta ndihmojmë maternitetin se numri i lindjeve ka rënë sa që po rrezikohet ekzistencë e maternitetit. Prandaj qëllimi është që te shtohet numri i lindjeve dhe ta shpëtojmë një shërbim që pastaj nuk do te na jepet mundësia me u hap përsëri. Dhe ne këtë drejtim edhe unë pajtohem pasi shumica ishin te pajtimit që kjo te shtyhet dhe te bëhet një analize me e hollësishme dhe pastaj që ta kalojmë, pra duam statistika sa është numri i lindjeve, sa do te jetë kosto që te gjitha edhe pse drejtori e ka. Kështu që nuk besoj që do te jetë shume pasi sivjet edhe shume pak lindje ka dhe ne mundemi me ja nis mirëpo kjo ka me pas reagime se pse këta që lindin jashtë nuk stimulohen pasi ka edhe aty disa specifika se shkon dikush vizitohet edhe mjeku pastaj e orienton për spital në Gjakovë apo Prizren, kështu që çka do te bëhet me ata edhe pse ata kanë dashur me krye lindjen aty. Pra janë disa pyetje që nuk kanë marr përgjigje dhe kur ti marrim te gjitha këto përgjigje dhe ne mbledhjen e ardhshme edhe ajo do te mundet me u kalua. Kështu që ky është mendimi i shumicës dhe unë mendoj se duhet te jetë ashtu.

**Samir Mustafa** – Qëllimi nuk është stimulimi rritja e natalitetit ne komunën e Rahovecit, pasi çdo lindje që regjistrohet jashtë komunës se Rahovecit si ne Priren Gjakovë apo dikën tjetër, ai fëmijë regjistrohet si banor i atij vendi ku ka lindur, pra vendlindjen e ka ne atë vend ku lindur. Tek mërgata pyetjen e parashtruar nga Fehmi Hoxha, ata kanë te drejtë te regjistrohen pasi janë në regjistrin e gjendjes civile tek regjistrimet e jashtme, mirëpo tanë nuk kemi kapacitet si komunë me i stimulua. Qëllimi i propozim vendimit të gjallërohet puna ne maternitet, pasi ka qenë një tendencë e Ministrisë se Shëndetësisë që te mylllet maternitetet ne nivele vendi, por nuk është qëllimi i këtij vendimi rritja e natalitetit ne komunën e Rahovecit.

**Fatmir Iska** – Faleminderit i nderuari kryesues, të nderuar asamblistë, drejtorë dhe gjithë ju të pranishëm. Ky vendim që ne sot e miratojmë apo e shtyjmë për seancën tjetër apo nuk e votojmë hiq, është vendim në interes se pari i qytetareve. Unë jam i pajtimit pasi kemi biseduar me përpara edhe me drejtorin e Financave dhe kryetarin e komunës, që secilën lindje te banoreve tanë Brenda territorit administrative te komunës tone që jetojnë me adresë ne komunën e Rahovecit te subvencionohen, pra kjo është ideja edhe pastaj kemi kërkuar vendimin qysh e kemi sjellë edhe për KPF e që vlen edhe për kuvend mirëpo ky ndryshohet. Edhe prape që një nen përfshihet që te gjithë banoret që jetojnë jashtë territorit te Republikës se Kosovës te përjashtohen nga kjo liste, pra vetëm ata që lindin këtu. Kështu që drejtori i Financave e përmendi me herët se komuna mundet me bo zgjidhje dhe unë jam I pajtimit që 200 euro nuk janë shume duke marrë për bazë koston, pasi që shërbimet e varrimit 200 euro dhe përfundon shpenzimi ndërsa te kjo vetëm që fillon me u krijua shpenzimi. Unë kërkoj nga ju që ta mbështesni ketë vendim sepse nuk bën dëme askujt as natalitetit me shume prej 200 euro e as atij

që do të I lind familjari apo ne me i bo dëm asaj sepse askush nuk mundet me zor me shtye që me shkua ne QKMF me lind, pasi krejt ajo varet prej komplikimeve dhe rekomandimeve që mundet me I dhanë mjeku apo me lind këtu nëse nuk ka komplikime apo ne spitalin e Gjakove apo Prizrenit e kudo qoftë tjetër. Po ashtu edhe Dervish Çadraku e ka përmend ne KPF dhe ka kërkuar një shume prej 500 euro, kështu që unë mendoj se është një shume e madhe për komunën e Rahovcit pasi nuk mundet me përballua por qeveria sigurisht se mundet kurse komuna nuk mundet. Kështu që besoj drejtori e kanë një statistikë të lindjeve dhe ideja është që vetëm banoret e komunës se Rahovcit te subvencionohen me këtë dhe te precizohet me saktë. Pra vetëm kërkoi nga ju ta mbështhesni sepse edhe ne seancën e radhës nëse kërkoni me shtye këtë vendim atëherë i njëjtë vendim ka me qenë dhe e njëjta përkrahje ka me qenë, pasi as pikë e as presje e këtij vendimi ska me ndryshua as ne muajin tjetër e as brenda këtij viti kalendarik. Atëherë nëse mendoni me shtye pas zgjedhjeve atëherë cilido që ma qenë fitues i zgjedhjeve ka me vazhdua me vendimin e njëjtë dhe vetëm se shuma mundet me ndryshua me pak apo me shume. Pra kjo është diferenca, absolutisht kurrgjë nuk ka me ndryshua, pasi askush nuk mundet me detyrua dikën që me shkua ne QKMF apo cilindo qendër spitalore tjetër. Por nëse ka komplikime atëherë edhe gratë këtë më mirë e din pasi jam vet prind edhe jam ballafaquar, kështu që ato me mirë e din vet se a dëshirojnë me lind ne QKMF apo ne ndonjë qendër tjetër spitalore dhe absolutisht kjo shumë nuk e stimulon natalitetin me shumen 200 euro. Kështu që unë kërkoi nga ju që ta përkrahni këtë propozim me ato që i përmendi edhe drejtori i Financave që gjithë banoret e Komunës tonë brenda territorit administrativ kudo që lindin ne QKMF apo ne qendra spitalore tjera do te përkrahen me këtë shume simbolike. Të gjitha lindjet për banoret e komunës se Rahovcit brenda territorit administrativ, mirëpo kjo nuk i takon atyre që bëjnë regjistrimin ne komunën e Rahovcit por që lindin jashtë republikës se Kosovës. Po ashtu edhe drejtori i Financave e përmendi edhe me herët, se mundet me u bo zgjidhje edhe besoj që ne këtë vendim duhet te precizohet që brenda këtij viti kalendarik duhet te jetë ky vendim kurse për vitin tjetër siç e bëjmë për shpenzimet e varrimit prape edhe për këtë vendim do të shikojmë se a do te ketë rritje apo zvogëlim te shumes simbolike. Për ndryshe që për specifikat e tjera, të jeni te bindur se kjo ka me vazhdua njëjtë absolutisht, vetëm nëse do te kemi përkrahje tjetër prej qeverisë, pasi politikat qeveritare janë tjera, por ne gjithnjë flasim brenda nivelit lokal pra brenda komunës se Rahovcit.

**Samir Mustafa** – Veç ju mbeta borxha i takon numrit te lindjeve rrëth statistikave, në vitin 2018 janë kryer 90 lindje në QKMF, në vitin 2019 janë kryer 76 lindje kurse ne vitin 2020 janë kryer 70 lindje.

**Kryesuesi** – Sigurisht se do te flas edhe unë sa i takon kësaj teme pasi me pëlqeu jashtëzakonisht shume propozimi dhe mendimi i nënkytarit por edhe ne mbledhjen e KPF-së e kemi përgëzua dhe e kemi falënderua iniciativën e drejtorit dhe krytarit që e ka marr këtë vendim dhe ky vendim vlen për këtë vite pra për 2021. Poashtu edhe pjesën tjetër që e tha nënkytar që një herrit e falënderoj që e dha kontributin pasi vërtet e dha propozimin dhe mendimin jashtëzakonisht te mirë. Kështu që për rastet që shkojnë me lind ne QKMF, kemi raste kur vet doktori e udhëzon me shkua ne ndonjë qendër tjetër si p.sh. ne Prishtinë dhe propozimi im është që te gjitha lindjet nga gratë apo nënrat tona te komunës se Rahovcit brenda territorit te Komunës se Kosovës te subvencionohen ne shumen prej 200 euro mirëpo vetëm për banoret e komunës se Rahovcit, me keqardhje për komunat e Malishevës apo Suharekës por i kanë vendimet që i ndihmojnë, Dhe ky vendim pra kjo shume është vetëm për këtë vite 2021.

**Afrim Limani** – Desha me dhanë një propozim te ri dhe asgjë me shtua me tepër fjalët që i tha nënkytarit pasi edhe unë jam i thitar i asaj që ne këtë proces nëse nuk i futim te gjithë banoret e Komunës se Rahovcit nuk kemi bërë asgjë pasi pa marr parasysh se ku lind ne Prizren apo Gjakovë por që është rezident brenda territorit te Komunës se Rahovcit atëherë duhet me subvencionua mirëpo ideja është që për me mbrojt

maternitetin ne QKMF atëherë ne po shkojmë me një vlerë pak me lartë dhe po i stimulojmë dhe ata që lindin jashtë komunës tonë me një vlerë edhe pse nuk me takon me dhanë si propozim nga ana ime mirëpo pasi ndërlidhet si temë me aspektin e buxhetit e jap këtë propozim, por prapë jeni ju ata që vendosni si te doni sa i takon kësaj.

**Rukije Krasniqi** - Nuk është iniciativa me rrit lindshmërinë por kjo është qenësore dhe me sa kuptova drejtori me mbajt aktive maternitetin ne QKMF tone ne Rahovec. Nuk besoj që ka hapësirë për komplikime dhe mos mundësisë se ofrimit te shërbimit ne QKMF por me shume shkojnë pse dëshira e tyre është me lind në Prizren apo Gjakovë apo edhe diku tjetër kinse ne komunën tonë nuk ofron kushte për lindshmëri. Unë mendoj që jo vetëm ne maternitet por edhe për gjësende tjera shkojnë neper komuna tjera e jo me krye shërbimin ne komunën tonë edhe unë mendoj që pjesërisht e mbështes propozimin e drejtorit te QKMFS-së vetëm për ata që lindin ne Rahovec por duke përjashtuar Malishevën pasi nuk është i komunës tonë dhe ska nevojë me i mart mjetet. Kurse te komunës tonë vetëm ata që lindin ne maternitetin e QKMF-së pasi për çdo vite kemi rënje te lindshmërisë, pasi që nëse nuk ka lindshmëri atëherë pse me ekzistua materniteti ne QKMF.

**Ali Zhuniqi** – Në rend te parë që gratë shkojnë ne QKMF dhe që largohen nga aty, arsyeva është se kanë komplikime dhe jo pse nuk dëshirojnë me lind aty, po ashtu si asamblist dhashë propozimin që lindjet që ndodhin në kuadër sipas këtij propozimi në kuadër te QKMF-së të subvencionohen me shumen 200 euro ndërsa lindjet që ndodhin jashtë QKMF-së te subvencionohen me 100 euro. Pra është e padrejtë që grave apo nënave ë lindin për herë te parë apo për herë te dytë me ju mohua edhe me i kategorizua me këtë lloje forme në bazë te këtij propozimi. Na do ta votojmë vetëm nëse bëhet plotësim ndryshimi i këtij propozimi, në te kundërtën si grup parlamentar nuk do ta votojmë.

**Samir Mustafa** – Ju ftojë që ta votoni propozimin e kryetarit, përndryshe çdo propozim tjetër do të anulohet nga MAPL-ja, pasi e kam nga praktika e komunave tjera.

**Sali Sallteku** – Unë ju kisha lut që me qitë në votim ashtu siç e dha propozimin nënkyetari sepse nuk do informohet shume shpejt opinioni dhe nuk besoj që do te jetë shume e madhe, kështu që nuk ka nevojë me i ndaje dhe te shkojmë ashtu siç tha nënkyetari edhe ta kryejmë këtë punë, pasi që çdo veprim tjetër është e paligjshme dhe e padrejtë dhe jo e moralshme.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Sallteku, vërtet është mirë që e kemi debatuar gjerë e gjatë këtë çështje dhe po besoj që kemi dhanë mendimet tonë, gjithashtu që pjesa me e madhe e kuvendit është për mendimin që e dha nënkyetari por sigurish që kishte edhe propozime tjera që me muajt me klasifikua.

**Fatmir Iska** – Po e përsëris edhe njëherë që me qenë sa me specifik para votimit, propozoj 200 euro për secilën lindje pavarësisht se ku lind dhe le te precizohet ne këtë vendim, ashtu siç e potencova edhe me herët pasi ne KPF ka qenë ky vendim edhe nuk e kemi ndryshua si letër por sigurisht që kjo ndryshohet me propozime pasi nuk është vendimi i parë që ndryshohet dhe sigurisht se ka me vazhdua kjo edhe për vendime tjera nëse ka nevojë për plotësim ndryshime. Pra te precizohet saktë për secilën lindje te banoreve te komunës tonë, te precizohet saktë për vitin kalendarik brenda këtij viti kurse për vitin e ardhshëm 2022 do te marrim vendim qoftë ne Janar apo shkurt dhe pastaj zbatohet retroaktivisht. Kështu që me propozimin që e kam dhënë ju ftojë që ta përkrahni dhe pastaj shkojmë edhe mundësi tjera. Pra 200 euro për secilën lindje qoftë ne QKMF, apo ne qendra tjera spitalore apo edhe ne spitale private pavarësisht se ku lindin.

**Kryesuesi** – Të nderuar kolegë kuvendarë, unë mendoj që pikat që e ka sjellë me propozim të bëhet plotësim ndryshimi i vendimit aty dhe te bëhet pagesa për te gjitha banoret e komunës se Rahovecit.

**Samir Mustafa** – Propozimi është shume i qartë por gjithashtu është edhe propozimi i nënkyetarit, ju ftojë që ta votoni dhe ju vendosni, pikat shtesë te nënkyetarit ne propozim vendim.

Çdo lindje që bëhet ne spitale regionale si p.sh. ne Gjakovë atëherë regjistrohet si lindje ne Gjakovë dhe është banor i Gjakovës apo njëjtë edhe ne Prizren, pasi aktin lindjes e ka ne vendin ku ka lindur.

**Munib Durguti** – Sa për një sqarim te vogël se drejtori e ka mirë që regjistrohet lindja pra vendi i lindjes por ai nuk do te thotë që është edhe banor i vendit ku ka lindur. Propozimi i nënkyetarit ka të bëj me banoret e komunës tonë dhe dihet se kush janë, kështu që nuk është me rëndësi se ku ka lindur.

**Sali Sallteku** – Drejtori nuk kishte te drejtë sepse propozimi i nënkyetarit është shume me vend dhe gjithashtu I drejtë. Është e vërtetë që lindja mundet të bëhet në cilin do vend, mirëpo zyrat e gjendjes civile ekzistojnë çdo kund e sigurisht edhe ne komunën e Rahovecit.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Sallteku. Propozimi nga drejtoria apo kryetari ka ardhë që te merret vendim për subvencionimin e lindjeve ne QKMF ne Rahovec mirëpo pas gjithë këtyre diskutimeve që trajtuam, kuvendi është ai që vendos për këtë. Atëherë e marrim si përfundim këtë vendim që me qitë ne votim që me pastaj të bëhet plotësim ndryshimi dhe shënohet dhe te precizohet se gratë banoret e komunës se Rahovecit që lindjet i kryen brenda territorit te Republikës se Kosovës jo jashtë saj por edhe nënët që lindin jashtë territorit te Republikës se Kosovës te mos subvencionohen. A po pajtoheni edhe ju që te marr këtë definim. Atëherë e quesim ne votim. Konstatoj se aprovohet me një votë kundër. Kalojmë ne pikën e pestë te rendit te ditës:

**6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Planit lokal për deponinë e Mbeturinave te Ngurta.** Te nderuar kolegë kuvendarë, gjithashtu këtë pikë e kemi trajtuar ne Komitetin për Politikë dhe Financa dhe kjo pikë ka qenë ne debat publik dhe i ka kalua te gjitha procedurat e nevojshme. Kështu që kalojmë e shtatë te rendit te ditës:

**7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Planit lokal për deponinë e Mbeturinave te vëllimshme.**

Gjithashtu edhe kjo pikë siç e thash me herët i ka kaluar të gjitha procedurat e debatit publik. Atëherë nëse nuk ka dikush diçka sa i takon kësaj pike, e quesim ne votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e shtatë te rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e tetë te rendit te ditës:

**8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës se paluajtshmë të komunës në shfrytëzim – lokalit afarist personave fizik dhe juridik.**

Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa i kemi rekomanduar kuvendit që te dal ne debat publik.

**Artan Asllani** – Pëershëndetje për të gjithë. Të nderuar anëtarë të Kuvendit, a keni diçka sa i përket procesverbalit. Pra bëhet fjalë për dhënien në shfrytëzim të një lokal afarist i cili gjendet në stacionin e autobusëve këtu ne Rahovec, bëhet fjalë 268 m<sup>2</sup> për lokalin i cili gjendet ne hapësirat e stacionit te autobusëve ne Rahovec. Për zhvillimin e të gjitha procedurave është paraparë ashtu siç është paraparë sipas rregullores ligjit për dhënien në shfrytëzim te pronave komunale dhe nga ana e komisionit për dhënien në shfrytëzim te pronave komunale. Te pika 3 me qellim gjate seancës se KPF-së nuk e kemi vendos vitin, për sa vite ne shfrytëzim dhe kërkoj nga ana e juaj pasi ne si drejtori kemi propozuar që te jetë afërsisht 10 vite. Kështu që kërkoj nga ju kuvendarë te nderuar, që ta përkrahni këtë pikë te rendit të ditës.

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, e dëgjuam propozimin e drejtorit mirëpo ajo që me interesoj dhe që është brengë në këtë situatë është se lokal afarist nuk ka leje ndërtimi fare dhe po ju informoj se ajo ka qenë si një terasë e hapur dhe ndërkohë e ka mbuluar e ka zgjeruar dhe e ka rritë pa kurrfarë leje nga komuna dhe sot ne sot me dhanë ne shfrytëzim pa legalizua, kjo për mua është anomali. Unë kisha propozua që me tërheq dhe me analizua këtë çështje edhe për një çështje tjeter pasi përboll këtij lokal apo stacionit, unë bashke me kushérinjtë e mi kemi kontest gjyqësor për atë pronë dhe ky propozim mendoj se ka mundur me hyje edhe përtëj pronës që është në shfrytëzim te stacionit te autobusëve. Kështu që kërkoj prej drejtorit me analizua mirë edhe me na informua në seancën e radhës se a është objekt i ndërtuar me leje apo pa leje.

**Artan Asllani** – Faleminderit për pyetjen i nderuar, sa e di unë ky lokal ka qenë ne menaxhim te stacionit te autobusëve këtu ne Rahovec ndërsa pas marrjes se vendimit nga ana e kuvendit që ajo pronë të jepet ne menaxhim nga ana e kuvendit te komunës se Rahovecit dhe nuk jam në dijeni se aty kanë ndodhur ndërtime

pa pëlqimin e komunës apo diçka tjetër. Mirëpo vetëm një e di se ai lokal ka qenë aneks i lokalit që ka qenë dikur prej 78 m<sup>2</sup> që gjendet brenda ndërsa për hapësirën e jashtme mua me ka interesua dhe e kemi verifikuar që është në certifikatën e pronësisë se komunës se Rahovecit dhe vetëm e di se ky ndërtim ka ndodhur para 4-5 vite.

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit kryesues, objekti është i ndërtuar ne mënyrë ilegale pra pa leje ndërtimi pasi unë kam qenë drejtor i urbanizmit atëherë dhe ka bërë një zgjerim tepër t madhe dhe është pa leje. Kështu që nuk ban ne si kuvend me marr një vendim që me ja dhanë ne shfrytëzim që s'ka leje. Në atë kohë ka bërë kërkesë dhe ka marr pëlqim vetëm për renovim brenda mirëpo krejt ajo që shihet jashtë që ka ndërtuar është pa leje ai objekt. Kështu që nuk është mirë me na qitë ne lajthitje që me marr një vendim kur e dimë që objekti është i ndërtuar pa leje. Procedurën gjyqësore sa kam unë informatë, inspektorati e ka filluar procedurat mirëpo deri ku ka shkuar kjo punë nuk e di. Kështu që edhe unë jam që te tërhiqet ky propozim që te mos te marrim këtu një vendim për objektin që është i ndërtuar ilegalisht.

**Artan Asllani** – Siç e thash edhe me herët, këtë lokal apo hapësirë ne pronën e certifikatës është e komunës se Rahovecit. Kështu që nëse vërtet është ashtu siç e potencuat me herët i nderuari Fehmi Hoxha pasi keni qenë edhe drejtor i urbanizmit, nuk jam i interesuar që kjo pikë te kalon për shkak se asnijëherë nuk kam pretendime dhe nuk do të kemi që nëse ka kontekste apo i ndërtuar ne mënyrë ilegale te vazhdoj procedurën ne këtë ankand. Kështu që e tërheqim këtë propozim ndërsa për seanca tjera do te hulumtojmë dhe do të verifikojmë se si është gjendja e këtij lokalit.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për sqarimin, atëherë meqë drejtori e tërroqi pikën e rendit të ditës për hulumtime te mëtutjeshme ne seancat e radhës. Kalojmë në pikën e nëntë te rendit te ditës:

#### **9. Informatë rreth formimit të komisioneve lidhur me pasuritë e komunës se Rahovecit.**

**Artan Asllani** – Gjate vitit 2020 n; kuadër te drejtorisë dhe me vendim te kryetarit janë formuar disa komisione rreth regjistrimit te pasurisë të komunës qofshin ato mbi vlerën 1000 euro apo nen vlerën 1000 euro ,e komisionit për tjetërsimin e pasurive jo financiare dhe komisionin për regjistrimin e pasurive financiare. Ne jemi shkuar ne disa forma, dhe ne formën e parë ne mënyrë tabelare është përshkrimi, numri i regjistrimit dhe vlera e këtyre regjistrimeve për pasurin e komunës se Rahovecit për vitin 2020.Ndersa ne tabelën e dytë është përshkrimi i pasurisë nen vlerën 1000 euro për periudhën e viteve 2000-2020,ndërsa ne tabelën e tretë paraqitet ndarja sipas klasave te pasurisë kur është e përcaktuar komplekt ne tërësi vlera e pasurisë se komunës se Rahovecit.

**Masar Popaj** – Tek tabela e tretë, klasa e pasurive shuma totale është 132,950,601 euro, ku sipas llogaritjes sime me siguri është gabim teknik, kështu që është 132,950,727,që i bie me pak 46 euro 44 cent.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Popaj, atëherë meqë nuk kemi të tjerë të lajmëruar për ketë pikë, kalojmë në pikën e dhjetë te rendit te ditës:

#### **10. Informatë mbi pronat të cilat gjenden në zonën e mbrojtur të Kanionit të Drinit të Bardhë tek Ura e Fshejtë.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, drejtorë te drejtorive, anëtare te kuvendit dhe gjithë ju te pranishëm. Para jush keni materialin e përgatitur prej drejtorisë se gjeodezisë që ka të bëj me pronat që gjenden ne parcelën te zonës se mbrojtur me vendim te kuvendit te komunës se Rahovecit. Pra kemi një listë me emra te pronarëve dhe ka prona në atë zona që janë emër te komunës pastaj ka prona që janë te privatizuar prej Shpk. Korodona dhe ka prona që figurojnë emër për emër në listë që gjenden në atë zonë. Kështu që mos me ju lexua gjithë listën tanë, ju i keni materialin fizikisht para juve.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për sjelljen e kësaj informate. Atëherë meqë nuk kemi diçka rreth pikës se dhjetë, kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë te rendit te ditës:

## **11. Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, para jush keni informatën me listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre. Ne i kemi përfshije këto ne prona të cilat menaxhohen prej kuvendit komunal të Rahovecit ku bëjnë pjesë shkollat, çerdhet, objektet kulturore, palestra sportive, objektet shëndetësore dhe te gjitha pronat tjera të cilat gjinden ne 34 zona kadastrale ne nivel te komunës. Pra kemi prona në çdo zonë kadastrale në çdo fshat, ku janë të përfshira me ari dhe hektar dhe te gjitha këto i kemi te përbledhura bashkë. Pra është një informatë që e sjellim çdo vite dhe nuk ka ndonjë ndryshim përveç disa materialeve që shkojnë ne gjykatë dhe fatmirësisht nuk fitojnë prona publike ë kanë pretendim pronaret privat.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për informatën, atëherë meqë nuk ka dikush diçka sa i përket kësaj pike, kalojmë ne pikën e dymbëdhjetë te rendit te ditës:

## **12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale ne Zoqishtë.**

**Artan Asllani** – Faleminderit kryesues, ky vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, miratohet propozimi i kryetarit te Komunës se Rahovecit me numër te protokollit 01217/21 te datës 19.03.2021 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës se paluajtshme te komunës në shfrytëzim te personave fizik dhe juridik. Hapësira për te cilën do të bëhet vendimi për dhënien për shfrytëzim te kësaj parcele është me sipërfaqe te parcelës të 2500m<sup>2</sup> dhe gjendet në zonën kadastrale ne fshatin Zoqisht. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim te pronës se paluajtshme te komunës te cekur ne pikën 1 te këtij propozimi është ruajtja dhe rritja e vlerës e pronës publike komunale. Afati kohor për dhënien e pronës se paluajtshme te komunës në shfrytëzim të cekur në pikën 1 dhe 2 te këtij vendimi është afatshkurtër në kohëzgjatje 1-15 vite. Si drejtori propozojmë që afati për dhënien në shfrytëzim te kësaj parcele te jetë 10 vite. Ftojë të gjithë kuvendarë që ta përkrahin këtë pikë te rendit te ditës.

**Masar Popaj** – Unë kisha propozua me dhanë për 15 vite pasi që kemi dhënë te gjitha pronat deri me tash për 15 vite, kështu që edhe kjo prona duhet te jepet ashtu sikur te tjerat për 15 vite këtë prona.

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit kryesues, për informatë shtesë objekti ne fjalë aktualisht kush e përdorë apo kush e shfrytëzon, për hapësirën e jashtme publike, nuk e di edhe çka ka të ndërtuar aty.

**Artan Asllani** – Bëhet fjalë për hapësira te jashtme me sipërfaqe te përgjithshme prej 12,527 m<sup>2</sup> mirëpo te jepet ne shfrytëzim vetëm parcela e sipërfaqes prej 2500m<sup>2</sup>.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për sqarimet, atëherë pasi që ishte edhe kërkesë e drejtorit që te jepet për 10 vite ne shfrytëzim, e qesim ne votim pikën e 12-të te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e 12-të e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e trembëdhjetë te rendit te ditës:

## **13. Shqyrtimi i Propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private për interes publik.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, të nderuar kuvendarë para juve keni propozim vendimin për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private. Bëhet fjalë për zonë kadastrale ne Rahovec konkretisht për pronën private te cilën ju ne seancën e kaluar e keni shpallur ju me interes te përgjithshëm, ngastra me numër 1355/4 e cila është prona e komunës se Rahovecit dhe po kërkojmë prej juve që te këmbejmë ne sipërfaqe prej 81m<sup>2</sup> te ndarë nga pjesa e përgjithshme që është 69 ari e 61 m<sup>2</sup> dhe te këmbehet me pronën private që figuron ne emër të NTP. Agronomi me prona Gëzim Rexhep Cena nga Rahoveci me sipërfaqe te njëjtë prej 81m<sup>2</sup>. Pra bëhet fjalë për parcelën me numër 1687/3. Qëllimi i këtij këmbimi është aty faktikisht është një rruge faktike e kalueshme për me shume se 100 vite dhe është e kubëzuar mirëpo aty rrugë me kadastër nuk ka dhe prona ka kërkuar leje prej neve që te ndërtoj një objekt ne pronën e vet, pasi ai kufizohet me pronën shtetërore ne atë parcelë njëjtë për me marr kushtet e ndërtimit, kështu që ne kemi kërkuar kushtet e ndërtimit leje që te ndërtoj në pronën e vet, dhe i kemi propozua që kur ta marrim pëlqimin prej juve te këmbejmë sipërfaqe te njëjtë 1 me 1 prona private me prona shtetërore me sipërfaqe prej 81m<sup>2</sup> që figuron edhe me kadastër rrugë publike që

edhe ashtë është rruge e kalueshme. Për këtë në te ardhmen do te kujdeset drejtoria për kadastër dhe gjeodezi. Ftojë kuvendaret që pas shqyrtimit te votojnë propozim vendimin për këmbim.

**Kryesuesi – Faleminderit** shume drejtor, a ka dikush diçka rrëth kësaj pike. Atëherë nëse nuk ka e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e 13-të e rendit te ditës.

Kolegë te nderuar, faleminderit shume te gjithëve për kontributin e dhënë dhe mirë u pafshim ne mbledhjen e radhës.

**Procesmbajtësi:**

---

**Agim Hoti**

**K R Y E S U E S I**

---

**Afrim Dina**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Komuna Rahovec**  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Nr. 01-2021  
Datë: 11.03.2021

	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLICA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNE/OPŠTINE/FEDERATION MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësie Nr./Br./No 02(Kabinet i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 259 Nr. i fuq/Ur.str./No pg. 190		
Data/Datum/Date 31 / 03 / 2021		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

# RAPORTI VJETOR I PUNËS I KOMITETIT TË AUDITIMIT 2020

Nga: Sead Rama, Kryesues i Komitetit të Auditimit

Për: Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Komunës së Rahovecit  
CC: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa

RAHOVEC, Mars 2021

Për periudhën raportuese, Komiteti i Auditimit ka shqyrtuar raportet e Auditimit të Brendshëm dhe raportin vjetor të Auditorit Gjeneral për vitin 2019.

Gjithashtu, Komiteti i Auditimit ka mbajtur katër seanca ku janë shqyrtuar pikët të ndryshme sipas programit dhe planin e punës për vitin 2020.

Në të gjitha takimet janë mbajtur procesverbale ku janë regjistruar të gjitha diskutimet e anëtarëve të komitetit të Auditimit dhe drejtorët e drejtive përkatëse, pjesëmarrës në këto takime. Po ashtu në shumicën e seancave ka marrë pjesë drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Afrim Limani. Gjithashtu, në procesverbalet e takimeve janë nxjerrë konklaza nga këto takime të cilat u janë rekomanduar drejtive komunale për veprim.

## 1. Seanca e parë

Është mbajtur më 29.06.2020 me këto pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të brendshëm të Zyrës së Prokurimit;
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për Drejtorin e gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë;
3. Të ndryshme

Ky takim pune është mbajtur në përbërje të plotë të Komitetit të Auditimit. Gjithashtu në këtë takim pune kanë marrë pjesë, Zyrtar i zyrës së prokurimit pranë Zyrës së prokurimit z.Astrit Mullabazi, Drejtori i Drejtorisë për Drejtorin e gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë, z.Afrim Oruqi.

Në këtë takim kanë diskutuar; Sead Rama, Kryesues i Komitetit, Fllanza Popaj, Anëtar i Komitetit, Sehad Boshnjaku, Anëtar i Komitetit, Skender Hamza, Anëtar i Komitetit, Mirsad Shala, Anëtar i Komitetit, Zyrtar i zyrës së prokurimit, Astrit Mullabazi, Drejtori i Drejtorisë për Drejtorin e gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë, z.Afrim Oruqi, si dhe Auditor i njësisë së Auditimit të brendshëm Ruzhdi Kabashi.

Gjithashtu me procesverbal nga kjo seanca e parë, janë konstatuar:

**REKOMANDIMET:** Të Zyrës së Prokurimit- rekomandimet e vitit paraprak për këtë zyre kanë qenë 6, ku nga ta 3 rekomandime janë adresuar plotësisht dhe 3 rekomandime janë adresuar pjesërisht.

**TË GJETURA:** Të Zyrës së Prokurimit- Të gjeturat janë mos koordinimi i mjaftueshëm me menaxheret e projekteve, ku janë treguar dobësi në projektet që është dashur të pajisen me dokumentacione të nevojshme në përpjekje me kërkeshat e ligji të ndërtimit, ku duhet të sigurohet leje ndërtimore, mbikëqyrja inspektive gjatë ekzekutimit dhe në fund të sigurohet leja e përdorimit, po ashtu caktimi i vlerës së lartë në para masën dhe para llogarinë.

**KONKLUZION:** Zyrës së Prokurimit Adresimi i plotë i disa rekomandimeve e ritë rrezikun e mos respektimin e kushteve dhe kritereve që rrjedhin nga kontratat e nënshkruara dhe hyrje në detyrim pa i siguruar ndarja e mjaftueshme buxhetore përmes mbulimin e detyrimeve.

**REKOMANDIMET:** Të Drejtorisë së gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë - rekomandojmë që drejtoria e audituar duhet të sigurojë se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, që të merë parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshirë edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake, që të ketë efekt në realizimin e të hyrave.

**TË GJETURA:** Të Drejtorisë së gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë- Të hyrat e planifikuara për vitin 2020 ishin më shumë prej 25,000.00 €, kurse realizimi i të hyrave për periudhën janar - prill ishin më shumë prej 5,162.00 €, realizimi në përqindje ishte 20.65 %. Sipas raportit të referentit për të hyrat në drejtorin përkatëse, realizimi i të hyrave për periudhën janar - prill të vitit ishin më shumë prej 5,033.00 €.

**KONKLUZION:** Të Drejtorisë së gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë- Drejtoria e audituar ka vendosur kontrollle mbi të hyrat, por kontrolllet si të tilla kërkojnë përmirësimë të mëtejshme sidomos më

sigurimin e një baze të të dhënave të drejta dhe të hyrave në ngritje, duke u siguruar se palët sipas kërkesës i kryejnë obligimet e tyre ndaj komunës.

## 1. Seanca e dytë

Është mbajtur më 08.07.2020 me këto pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i raportit të Auditimit në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport,
2. Të ndryshme.

Të pranishëm ishin: Sead Rama Kryesues i Komitetit të Auditimit, Fllanza Popaj anëtar, Sehad Boshnjaku anëtar, Skender Hamza anëtar, Mirsad Shala anëtar, Ruzhdi Kabashi Auditor i Njësisë së Auditimit.

Në këtë takim, po ashtu ishin prezent, Zyrtar për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit z. Shedad Ukaj.

Objektivat e këtij auditimi kanë qenë:

- 1..Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit;
- 2..Inkasimi i taksave për shfrytëzimin e sallave, stadiumeve (terreneve sportive), teknikës, biletat dhe anëtarësimi në bibliotek;
3. Shpenzimet; Menaxhimi i subvencioneve; dhe vlerësimi i rrrezikut dhe identifikimi i rrrezikut.

Në vazhdim do vazhdojmë me një përbledhje të shkurtër të rezultateve dhe të gjeturave të këtij rapporti të auditimit. Grumbullimi i të hyrave vetanake në këtë drejtori është bërë sipas taksave të përcaktuara nga Rregullorja Komunale në fuqi.

Çështja 1 ka të bëjë me mangësi në menaxhimin e të hyrave, pasi që në informacionet e shpalosura nga evidencia e raporteve financiare e të hyrave vjetore për vitet paraprake 2017, 2018, 2019 dhe raportit katër mujor të viti 2020 nuk kishte inkasime në të hyrat nga dhënia në shfrytëzim e sallës së madhe, sallës së vogël, shfrytëzimi i sistemit të zërimit si dhe nga biletat e shitura për shfrytëzim të sallës së madhe, shitja e biletave për shfaqjen e filmave, etj. Këtu kemi një inkasim vetëm nga anëtarësimi në bibliotek për leximin e librave për një vit, ku nga planifikimet që i ka bërë drejtoria të hyrat në këtë sektor kan qenë të vogla dhe sillen nga 20% deri në 27% e planifikimit të të hyrave. Gjithashtu gjatë testimit është konstatuar se nuk ka patur raporte ditore, javore, mujore dhe vjetore të të hyrave dhe as evidenc apo rregjistër i të hyrave nga kjo drejtori përfunduar e fushat e tjera përfunduar.

**Sehad Boshnjaku** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të pranishmit. Së pari kamë një vërejtje për Drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sport e cila edhe pse ka pasur ftesën për të marrë pjesë në këtë takim nuk ka ardhur, duke mos ditur arsyet e mosardhjes në këtë takim. Mendoj se si udhëheqëse e kësaj drejtorie, ndoshta kishte mundur me dhanë ma shumë përgjigje rreth çështjeve të ngritura në këtë auditim. Kërkoi falje përfaqësuesin e drejtorisë që është i pranishëm, por se mendoj se ajo do na kishte ndihmuar më shumë në këtë drejtim. Sa i përket çështjes së parë të gjetur nga auditori, mendoj se drejtoria përkatëse në këtë drejtim duhet të bëjë më shumë, dhe në të ardhmen të fuqizojë kontrollin e të hyrave në këtë drejtori si dhe të mbajë rregjistrin e shkruar përfunduar e të hyrat në këtë dikaster. Gjithashtu dua të lidhem me rekomandimin e auditorit të brendshëm që drejtoria në vitet pasuese të bëjë një planifikim më të mirë të të hyrave pasi që kjo përqindjen e vogël e inkasimit të të hyrave nuk është në proporcione të mirë me planifikimin e të hyrave.

**Sead Rama** – Faleminderit Sead, gjithashtu pajtohem me ju përmungesën e paarsyeshme nga Drejtoresha e Drejtorisë, për Kulturë, Rini dhe Sport pasi që është udhëheqëse e këtij departamenti dhe se çështjet e ngritura në këtë raport do ti përgjigjej shumë më mirë dhe do të na informoj më mirë në lidhje me këto.

**Mirsad Shala – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit,** dua të lidhem pak në këtë pikë. Duke mos dashur të arsyetoj pse të hyrat dhe planifikimi nuk janë proporcionalisht në vijë të drejtë, dua të bëjë një përbledhje me këtë pikë pasi që siç u cek aty në çështjen 1, pajtohem me parafolësin se drejtoria në fjalë duhet patjetrl të ketë rregjistër të shkruar apo raporte periodike për të hyrat nga dikasteret e ndryshme. Më lejoni tju sqaroj disa çëshje. Taksat nga kjo drejtori të përcaktuara me rregullore komunale janë taksa që zakonisht nuk inkasohen. P.sh. dhënia në shfrytëzim e sallës së madhe bëhet fjalë për sallën në shtëpinë e kulturës, përfaqësuesi i drejtorisë ndoshta do të na kishte shpjeguar më mirë, por kjo taksë në të shumtën e rasteve nuk inkasohet, pasi që nuk ka shum aktivitete në atë sallë. Në raste se atz ka aktivitete nga Komuna e Rahovecit, organizatat e dala nga lufta, ose nga shoqatat e ndryshme rinore kjo drejtori nuk inkason te ardhura pasi që siç jam i njoftuar drejtoria në fjalë nuk inkasion pasi që, disa oqj kanë buxhet të vogël dhe zakonisht bëjnë kërkesë në drejtori për lëshimin e sallës pa pagesë. Pastaj siç e dini në këtë, në shtëpinë e kulturës qe një kohë të gjatë, nga ajo që une mbaj mend nuk ka pasur ndonjë aktivitet apo shfaqje me pages qe drejtoria do të mund të inkasoj të hyra nga biletat, pasi siç e dijmë ne aty mbahen vetëm tubime elektorale nga partitë dhe se ato tubme janë të liruara nga pagesa me rregullore. Pra i vetmi inkasim është nga rregjistrimi apo anëtarësimi në bibliotek. Ju faleminderit.

**Fllanza Popaj – Përshëndetje për të gjithë.** Dua të kem informacion në lidhje me Palestrën Sportive, pse drejtoria nuk inkason mjete nga shitja e biletave nga kjo palestër.

**Mirsad Shala – Përshëndetje edhe njëherë, prapë me duhet me ndërhy në këtë pyetje.** Me tu përfunduar palestra Sportive në Rahovec, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka bërë kërkesë për hartimin e rregullores për palestrën sportive, dhe Zyra Ligjore në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës e ka hartuar rregulloren, e cila i ka kaluar të gjitha procedurat dhe në fund është miratuar në Kuvendin e Komunës së Rahovecit. Në këtë rregullore janë të përcaktuara të gjitha kushtet dhe procedurat për klubet e sportit si dhe qytetarët e Komunës të cilat dëshirojnë ta shfrytëzojnë palestrën. Këtu është përfshirë menaxhmenti i palestrës, mirëmbajtësit etj. Mirpo në mungesë të personelit drejtoria ka caktuar mbikëqyrës të palestrës deri ne marrjen e një konfirmimi nga ministria përkatëse për lejimin e zhvillimit të procedurave të rekrutimit për kompletimin e stafit të palestrës. Poashtu n këtë rregullore janë të përcaktuara çmimorja e shfrytëzimit për klubet brenda dhe jasht komunës, kushtet e shfrytëzimit për stërvitjet e klubeve, oraret, çmimorja për reklama etj.

**Shedat Ukaj – përshëndetje për të gjithë.** Siç e përshkruajti dhe e arsyetoj parafolësi unë ju siguroj që Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport nuk mund të inkasojë disa taksa sipas rregullores pasi që në të shzumtën e rasteve subjektet e ndryshme bëjnë kërkesë për shfrytëzim të sallave në shtëpinë e kulturës pa pagesë pasi që ato mbajnë disa aktivitete humanitare në të shumtën e rasteve për vetëdijesimin dhe avancimin e të rinjve.

**Sead Rama -** Ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë rreth kësaj çështje, andaj kalojmë me çështjen 2 evidentimi, harmonizimi dhe barazimi i dobët i shpenzimeve. Këtu kemi të gjetur se drejtoria nuk kishte vendosur kontolle të mira në menaxhimin e shpenzimeve si dhe menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të pa paguara. Këtu është vërejtur se menaxhmenti nuk mban evidencë raporte periodike për shpenzimet si dhe nuk kanë evidencë për krahasim dhe harmonizim të shpenzimeve me zyrtarin komunal të shpenzimeve. Nga kjo është rekomanduar që drejtoria në fjalë të mbaj evidencia të sakta dhe raporte periodike dhe vjetore për shpenzime.

**Fllanza Popaj – Përshëndetje për të gjithë.** Duke u nisur nga ajo që u paraqit në çështjen 2, mendoj që drejtoria dhe menaxhmenti në fjalë duhet të mbaj evidencia dhe të risë sa më shumë transparencën. Për këtë duhet të mbajë evidencia të sakta për shpenzime si dhe raporte periodike për shpenzimet që në të ardhmen mos të ketë të gjetura të këtij lloji.

**Sead Rama – Faleminderit.** Dua të lidhem me çështjen 2 pasi siç e dimë të gjithë se të gjitha shpenzimet të cilat bëhen nga menaxhmenti duhet të jenë të evidentuara. Andaj une shpresoj që në vitet pasuese ky rekomandim duhet të plotësohet nga drejtoria në fjalë dhe në të ardhmen mos të haset në mos mbajtje të raporteve apo evidencave për shpenzimet e bëra, tek e fundit janë paratë e taksapaguesve të Komunës së Rahovecit dhe duhet të jetë një llogaridhënie sa ma e mirë dhe menaxhim më i mire i parashë publike.

Andaj nëse askush nuk ka diçka me shtu për këtë pikë kisha vazhdu me çështjen 3. Kjo ka të bëjë me kushtet dhe kriteret për ndarjen e subvacioneve. Në këtë çështje gjatë ekzaminimit nuk ka pasur të gjetura. Këtu drejtoria në fjalë është rekomanduar që përmes monitorimin e sistemeve të formoj një projekt për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve, të sigurojë forcimin e kontrollit që rreziqet të janë nën kontroll që të arrihet performance në formë të shkruar në baza mujore të raportojë te menaxhmenti i lartë.

**Sehad Boshnjaku** – Përshëndetje për të gjithë edhe njëherë, dua të kem një informacion në lidhje me këto subvacione që i jep kjo drejtori se si është procedura që vjen deri te përfituesi i një subvencioni.

**Mirsad Shala** – Në mungesë të Drejtoreshës dua që une këtu të jap informacion, pasi që jamë pjesë e zyrës ligjore në kuadër të kabinetit të kryetarit të Komunës dhe ne jemi ata që përgadisim ose edhe i këshillojmë menaxhmentin se si duhet të veprojë nëse kanë paqartësi. Këtu është bërë një gabim ndoshta teknik nga njësia e auditimit, sepse Klubet e sportit, OJQ-të e ndryshme apo përfitues individual të cilët përfitojnë nga subvencionet e kësaj drejtorie nuk subvencionohet në bazë të rregullore komunale për ndarjen e subvacioneve, por në bazë të rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht të Ministritë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Në bazë të kësaj rregullore së pari bëhet thirja publike për aplikim për OJQ dhe individët të cilët aplikojnë duke u bazuar në kriteret përcaktuara në thirje e që inkorporohen nga kjo rregullore. Pastaj zyrtari kryesor administrativ apo kryetari i komunës merr vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve dhe vendimin për caktimin e komisionit të ankesave. Pas këtyre procedurave komisioni merr vendim për shpalljen e përfituesve dhe i rekomandon kryetarit të komunës që të lidhë konratë me çdo përfitues, ku në konratë cekën detyrat dhe përgjegjësitë e përfituesit të subvacioneve.

**Sead Rama** – Në konratën që e lidhë kryetari i komunës a i detyron përfituesit subvacione që të japidon një raport për shpenzime.

**Mirsad Shala** – Gjithsesi në konratë ekziston një nen i cili i obligon përfituesit e subvacioneve që në baza periodike si dhe në fund të projektit të dorëzojnë reportin finanziar të shpenzimeve.

**Sead Rama** – Të nderuar anëtar të Komitetit për Auditim me kaq përfundon mbledhja e këtij komitetit, ju faleminderit për pjesëmarrje dhe për angazhimin tuaj në këtë takim, shihemi në takimet e radhës.

## 2. Seanca e tretë

Është mbajtur më 18.09.2020 me këto pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit përvitin 2019;
3. Të ndryshme.

Të pranishëm ishin: Sead Rama kryesues, Filanza Popaj anëtar, Sehad Boshnjaku anëtar, Skender Hamza anëtar, Mirsad Shala anëtar Binak Kryeziu Drejtor i Njësisë së Auditimit. Në këtë takim ishin prezent Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani.

Kryesuesi i Komitetit Z.Sead Rama pas prezentimit të rendit të ditës foli edhe për opinionet e auditorit dhe rekomandimet për Raportin e vitit 2019.

Sa i përket këtij rapporti është bërë një përbledhje, ku si rezultat i kësaj ka dalur që ekzaminimi i pasqyrave financiare është bërë në përputhje të plotë me standartet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit SNISA, auditimi kryesish është fokusuar në pasqyrat financiare, tek menaxhimi financiar, kontrolli dhe zbatimi i rekomandimeve. Konkluzioni për pasqyrat financiare vjetore, ku vërehen se disa pozicione janë korrigjuar pas sugjerimeve te auditimit, ku pasqyrat financiare vjetore janë në përputhje të plotë me rregullat dhe standartet e zbatueshme , me përjashtim të keq klasifikimit të shpenzimeve në mes të kategorive të ndryshme ekonomike. Konkluzioni për MFK-në, menaxhmenti i komunës ka zbatuar një numër kontrollesh

të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet për përmirësim të performances në përgjithësi, por megjithatë ende ka nevojë të përmirësohet organizimi dhe komunikimi i strukturave brenda komunës. Konkluzioni në lidhje me rekomandimet e mëhershme, ka progres të zbatuar në zbatimin e rekomandimeve. Të dhënat për raportin e auditimit për vitin 2019, disa rekomandime janë zbatuar dhe një pjesë e tyre është duke u zbatuar ashtu siç e ceku edhe drejtori. Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes, sipas opinionit të auditimit pasqyrat financiare vjetore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet ndërkontrollare të kontabilitetit për sektorin publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Tej theksimi i çështjes vlen të ceket se ternerheqja e vëmendjes përfaktive se shpenzimet në vlerë prej 225,373.00 € janë paguar dhe regjistruar në kategorinë joadekuante. Pagesat në vlerë prej 105,373.00 €, janë kryer nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësore dhe të përmbarimit, kurse pjesa tjetër prej 120,000.00 € është buxhetuar gabimisht. Sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit, ky pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin, sa i përket komunës së Rahovecit, prokurimi mbetet shqetësim i madh, nuk janë duke u zbatuar rregulloret, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësim janë: realizimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit me ministritë, fushat e mallrave dhe shërbimeve, arkëtimi i llogarive të arkëtueshme dhe menaxhimi i pasurive. Buxheti final në raporte me atë fillestare ishte rritur për 1,394.360 €, si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, donacioneve dhe rrithes së grantit qeveritar për 1,000.000 € me vendim të qeverisë. Ndërsa kishte zgjedhur të financimit nga huamarrja për 73,839.00 €. Në vitin 2019, komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 14,688,602.00 €, me një përmirësim prej 5.5% krahasuar me vitin 2018. Drejtori e tha që shumica e rekomandimeve janë në zbatim e sipër, po ashtu edhe ju e keni pas materialin, por edhe unë sa kam mundur të vërej, kamë parë që ky raporte ka mundësi përmirësim, por mos të harrojmë të cekim se ky raporte është njëri ndër raportet më të mira në krahasim me vitet paraprake. Fjala është e juaja.

**Afrim Limani** – Të nderuar sa i përket raportit të auditorit për vitin 2020 lirishtë mundem të ju them se ky raport nuk do të ketë keq klasifikime sepse e kemi bërë planifikimin shumë të mirë në mënyrë që mos të i lejmë hapësirë auditorit kombëtar që të na gjejë keq klasifikime. Po ashtu tani jemi duke e përgatitur buxhetin për vitin 2021, po ashtu edhe këtu jemi kujdesur që mos të kemi keq klasifikime.

**Sehad Boshnjaku** - Përshtendetje përfshin gjithë të pranishmit, sa i përket raportit të auditorit të jashtëm u tha që u tha deri më tani dhe siç po duket me këtë raporte kemi dalë të kënaqur, por rekomandimi imë është që gjatë këtij viti drejtorët e drejtorive komunale, rekomandimet e auditorit të brendshëm të i marrin më shumë parasysh në mënyrë që pastaj kur të vije puna deri tek auditori i jashtëm nuk kemi mundësi asgjë të ndryshojmë. Kam edhe një pyetje sa i përket tatimit në pronë për ish ndërmarrjet shoqërore, këtu ceket se një pjesë e 37,562.00 €, janë arkëtuar në vitin 2019.

**Skender Hamza** – Përshtendetje përfshin gjithë të pranishmit, Shumë mirë e ceku z. Sead Boshnjaku që puna e auditorit të brendshëm duhet të merret më seriozisht, po ashtu edhe auditorët e brendshëm duhet të janë më të zhurmshëm ndaj ekzekutivit, sepse kur vije puna tek auditori i jashtëm puna është e kryer. Propozoj si anëtar i komitetit të auditimit që këto rekomandime që janë dalë nga auditori i jashtëm, të merren më seriozisht si nga auditori i brendshëm, ekzekutivi dhe po ashtu edhe ne si anëtar të komitetit të auditimit, në mënyrë që vitin e ardhshëm mos të përsëriten.

**Binak Krzeyiu** – Përshtendetje përfshin gjithë të pranishmit, të nderuar ky është rapporti i auditorit të jashtëm dhe ne si zyre e auditimit të brendshëm nuk kemi të bëjmë asgjë me këtë raport, ne si auditor të brendshëm mbas të gjeturave i japim rekomandime drejtorive të audituara. Shumë më e arsyeshme kishte me qenë që komiteti i auditimit të jetë më azhure në sa i përket rekomandimeve të auditorit të jashtëm, por besoj se ne së bashku me komitetin e auditimit do ti eliminojmë të gjeturat që janë paraqitur në këtë raport. Po e them edhe një herë se këto rekomandime duhet të eliminohen, por kishte me qenë mirë që rapporti dhe rekomandimet e njësisë së auditorit të brendshëm të mos neglizhohen, gjithashtu edhe plani i kësaj njësie.

**Sead Rama** – vetëm në një çështje nuk pajtohem me ju i nderuar, aty ku e ceket se auditimi i brendshëm nuk ka të bëjë asgjë me auditimin e jashtëm, i nderuar jujeni udhëzues i ekzekutivit, pra i bëni gjetjet së pari,

para se të shkojë tek auditori i jashtëm. Sipas përvojë që e kam auditorët e jashtëm më shumë mirën me ju sepse baza merret nga auditimi i brendshëm, kurse sa i përket asaj që nuk ju kthejnë drejtorit përgjigje rreth implementimit të rekomandimeve, ne në disa takime që kemi pasur disa nga drejtorët na kanë thënë se ju kanë kthyer përgjigje, por ne gjithsesi se në një mbledhje do ti diskutojmë këtë çështje sepse janë shumë të rendësishëm.

**Skender Hamza** - Ajo që desha të them është se jam i vetëdijshëm se ne si komitet i auditimit jemi më shumë të thirrur që ta ndihmojmë zyrën e auditimit të brendshëm, këtë e them që mos ta merë z. Binak Kryeziu që kemi diç kundra tije, por pyetje ime është se këto rekomandime që janë dhënë nga auditori i jashtëm, 14 sa ishin, drejtori e ceku se disa nuk kanë qenë kompetencë e drejtorive që ti ndryshojnë, por ju si zyre e auditimit të brendshëm a i keni paraparë këto rekomandime, a i keni përcjellë këto të gjetura drejtorive në mënyrë që mos të vije deri tek auditorët e jashtëm, pra a është bërë një lloj paralajmërimi nga auditorët e brendshëm.

**Binak Kryeziu** – Drejtori e ceku se është formuar një komision për implementimin e rekomandimeve të zyrës kombëtare të auditimit, ky komision është funksional dhe është duke punuar. I nderuar njësia e auditimit të brendshëm auditon të hyrat dhe shpenzimet brenda komunës, kursye auditorët e jashtëm i auditojnë pasqyrat financiare, ne gjatë auditimit të tyre kemi bashkëpunim me ta sepse ata na kërkojnë raportet tona dhe mbas raporteve tona ata e kryejnë punën.

**Mirsad Shala** – Përshëndetje për të gjithë, së pari urime drejtor për këtë raporte që ju ka ardhur si raporte më i mirë deri më tanë, ajo që desha të ndërlidhem tanë është me njësinë e auditorit të brendshëm, çështje B3 ceket se njësia e auditimit të brendshëm nga gjithsej 57 rekomandime që i ka dhënë për vitin 2019, rreth 50% prej tyre janë zbatuar kurse pjesa tjeter ishte në proces. Sipas auditorit të jashtëm ko është shumë vështirë përtu konfirmuar duke pasur parasysh se 10 nga 12 adutimet e kryera në vitin 2019, ka munguar plani i veprimit të menaxhmentit për zbatimin rekomandimeve nga raportet e auditorit të brendshëm. Kjo do të thotë se menaxhmenti ose nuk ka qenë serioz ose nuk i ka dërguar në njësinë e auditimit të brendshëm në lidhje me rekomandimet që i ka dhënë njësia e auditorit të brendshëm. I nderuari z. Limani a kanë drejtoritë ndonjë planë ku i bëjnë plotësimet e rekomandimeve të auditorit të brendshëm.

**Afrim Limani** – Një herë do i përgjigjem z. Sead Boshnjakut se ma tërroqi vëmendjen pyetje e tij, i nderuar llogaritë e arkëtueshme në komunën e Rahovecit sa për dijeninë tuaj janë nga tatimi në pronë, nga taksa në afarizëm, nga qiraja dhe aty këtu nga ndonjë llogari e çrrregullt por jo e rregullt, pra këto janë të hyrat e rregullta të komunës dhe llogariten si pjesë e llogarive të arkëtueshme. Kur e kemi mare ne pushtetin llogaritë e arkëtueshme në tatimin në pronë kanë qenë 1,400,000.00 €, shuma e madhe dhe plotësisht auditori ka të drejtë të shkruaj çka të dojë. Tani llogaritë e arkëtueshme kanë rënë në vlerë prej 1,200,000.00 €, në sajë të angazhimit maksimal të punëtoreve të sektorit të tatimit në pronë dhe mua sepse nuk e lëshojmë asnjërin pa paguar, prandaj dhe jemi në trendin mirë të shlyerjes së këtyre borxheve. Në mesin e këtyre llogarive që na krijojnë një situata më të ndërlikuar i kemi llogaritë e arkëtueshme nga ish ndërmarrjet shoqërore të cilat tani janë të privatizuara, kurse tani përgjegjëse për këto borxhe është AKP-ja. Ne si drejtori i kemi kryer të gjitha punët që na takojnë neve, ne vazhdimisht i dërgojmë shkresa. Borxhi total i tyre përafërsisht është diku rreth 300,000.00 €. Ne këtë vite i kemi përgatitur lëndët dhe i kemi dërguar tek përbaruesi, ajo që na ka mbetur neve është që tani ne të presim rezultatet. Sa i përket pyetjes së z. Misad Shala, i nderuar unë vazhdimisht kam pasur debate shoqërore edhe jashtë detyrës zyrtare me zyrtarët e njësisë së auditimit të brendshëm, unë edhe në mandatin e parë edhe tani nuk jam pajtuar me strategjinë e veprimit të tyre, arsyja pse është se këta ne tani jemi në vitin 2020 kurse këta në planin e tyre e përfshin edhe auditimin e vitit 2019, kjo për mua nuk është pranueshme sepse raporti për vitin 2019 ka kaluar kurse këta ende merën me reportin e vitit të kaluar. Por këta si njësi arsyetohen se planin e martin nga dikush tjetër, por mendoj se plani këtyre duhet të bazohet në ndonjë rregullore sose ligj të Ministrisë së Financave, nëse po atëherë pse auditori i zyrës kombëtare këtë e ka gjete si të gjetur. Ata kanë cekur si te gjetur që: Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani vjetor i auditimit të fokusohet më shumë në proceset e vitit aktual, pra kjo është gjetur për njësinë e auditimit të brendshëm. Pra të nderuar anëtar të komitetit për auditim, besoj se puna e juaj është që të fokusoheni në këto 14 rekomandime, ne këto rekomandime i kemi adresuar nëpër drejtori

disa nga këto rekomandime janë zbatuar, disa janë në proces dhe presim që shumica e rekomandimeve të zbatohen dhe në raportin e viti të ardhshëm të mos jenë më.

**Binak Kryeziu** – Sa i përket asaj që ne jemi duke i audituar edhe disa muaj të vitit paraprak, njësia e auditimit të brendshëm planin vjetor e përpilon dhe më pastaj e dërgon tek kryetari i komunës dhe kryesuesi i komitetit të auditimit, në këtë plan janë të paraqitura auditimit që do të bëhen në vitin e ardhshëm. Në këtë plan paraqiten 8 ose 10 auditime që do të kryhen, ceket edhe fushëveprimi kur do të auditohet, në këtë plan shumë qartë ceket se auditimi bëhet në shkurtë kurse planifikohet të bëhet auditimi i 6 mujorëshit të vitit të kaluar dhe ne marrim mostra nga 6 mujorëshi i vitit të kaluar dhe dy mujorëshi i vitit aktualë sepse jemi në muajin shkurtë të vitit aktual. Këtë plan e nënshkruan kryetari i komunës dhe kryesuesi i komitetit të auditimit. Por mendoj se auditorët e jashtëm edhe pse unë ju kam shpjeguar se si bëhet plani i auditimit të bre4ndshem, por mendoj se ata nuk e kanë kuptuar dhe kanë dashur të shkruajnë diçka që mos të mbetet pa thënë asgjë, prandaj se kjo e gjetur nuk ka kurrfarë baze.

**Afrim Limani** – I nderuari z. Binak Kryeziu nuk pajtohem me këtë që e the në fund, është shumë e vërtet që këtë plan e nënshkruan kryetari, por ai e nënshkruan ashtu siç ja servoni ju, po ashtu shume e paqartë më duket se si ju e bëni auditimin e vitit të kaluar kur rapporti i zyrës së auditorit të jashtëm vetëm se është kryer. Por ajo që është më e rëndësishme është se unë vetë kam biseduar me zyrtarët e auditorit të jashtëm, para se të gjejnë një të gjetur ata tregojnë, P.sh. Mua si drejtor më kanë thënë i nderuari drejtor tek llogaritë e arkëtueshme kështu e ke punën a ke ndonjë fakte që e demanton këtë, ose ndonjë argument që neve na bindë që ne mos të shkruajmë si e gjetur. Njëjtë edhe juve ju kanë thënë për këtë të gjetur, po ashtu e kanë pasur problem edhe të takohen me ju sepse ju nuk ishit asnjëri në zyre,, pra nëse nuk është ashtu atëherë është dashur ju ta bindeni atë që nuk është ashtu, besoj se ata nuk do të kishin cekur si e gjetur sepse ata janë shumë profesionistë në këtë punë që e bëjnë.

**Sehad Boshnjaku** – Ne si çështje e ngritëm që të bashkëpunojmë, por nëse e shikojmë si auditim i brendshëm dhe auditim i jashtëm tek bizneset private, auditim i brendshëm është një ciceron tek menaxhmenti i lartë. Pra nëse është nevoja njësia audituese pa e përfill planin e veprimit të shkojë dhe të bëjë auditimin dhe pastaj ta informojë kryetarin për të gjitha të gjeturat, se ne e dimë që këtu ka zotnillak në të gjitha drejtorit. Kurse tek bizneset private kur bëhet auditimi i jashtëm ai duhet të ketë të nënshkruar një kontratë me auditorin më së largu deri me 1 shtator, pra që do të vazhdojë auditmin e vitin aktual në vitin e ardhshëm. Prandaj pajtohem me z. Binak Kryeziun kur e thotë se në muajin shkurtë nuk munden të gjejnë mostra.

**Sead Rama** – Edhe pse ata e kanë përmbyll vitin,, mendoj se kanë pasur shumë të drejtë për këtë rekomandim që e kanë cekur, arsyja pse e them këtë është se mendoj që ata janë bazuar në ndonjë ligj që e kanë cekur këtë rekomandim. Ne tani jemi duke diskutuar se si ti tejkalojmë këto rekomandime në mënyrë që vitin e ardhshëm mos të janë më, edhe pse disa kërkojnë angazhim më të madh.

**Skender Hamza** – Ajo që mua më intereson ta di është, e ceka edhe më parë, këto 14 rekomandime që janë dalë nga auditori i jashtëm a ju kanë servuar si të gjetura edhe nga auditori i brendshëm kryetarit në raportin e tije 6 mujor ose një vjeqar, sepse auditori i brendshëm është këshillues për kryetarin e komunës. Pe marr një shembull edhe po ja qes po ashtu si pyetje edhe drejtorit, si e gjetur e ceket se: Kryetari duhet të sigurojë se ekzekutimi i pagesave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren e MF, përparësi duhet të i jepet obligimeve të bartura nga viti paraprak dhe atyre që kanë afat më të gjatë të pritjes. Auditori i brendshëm këtë rekomandim a ja ka prezantuar kryetarit dhe i ka thënë kjo duhet të anulohet sepse do të jetë si e gjetur nga auditori i jashtëm, pra a keni ju ndonjë dokument ku do të arsyeton se këtë rekomandim ja keni prezantuar kryetarit të komunës. Besoj se ky rekomandim më nuk do të jetë si e gjetur në raportin e viti 2020, sepse është diçka që ka mundësi të përmirësohet.

**Binak Kryeziu** – Neve auditorët e jashtëm na kërkojnë planin vjetor, planin strategjik, raportin vjetor dhe çdo raporte të cilin e kemi bërë ne si zyre, pastaj në bazë të raporteve tona ata e bëjnë auditmin, ku ata më shumë fokusohen aty ku është rrezikshmëria më e lartë. sa i përket rekomandimeve të mijë duhet të interesohem ne si zyre dhe komiteti për auditim, në mënyrë që të vije deri tek zbatimi i rekomandimeve dhe të eliminohen të gjeturat nga secila drejtori.

**Skender Hamza** - Pra ju jeni duke thënë që edhe ju i keni paraparë këto të gjetura dhe i keni prezantuar por nuk janë mare përbazë nga ekzekutivi.

**Mirsad Shala** - Do isha ndalur tek rekomandimi C6 ku thuhet se çdo kontratë duhet të ketë menaxherin e kontratës, prandaj si rekomandim ju është dhënë kryetarit që çdo kontratë duhet të ketë menaxher të kontratës. Sa jam në dijeni unë shumica apo të gjitha kontratat kanë pasur menaxher të kontratës sepse jam i kyçur në këtë, por dua ta di pse është dal ky si rekomandim.

**Afrim Limani** - Në bazë të ligjit në kuadër të investimeve publike çdo kontratë duhet të ketë menaxherin e saj, por ne nuk e kemi ditur që duhet të caktohet edhe një menaxher i kontratës edhe në kudër të mallrave dhe shërbimeve sidomos me vlerat e vogla. Nga ko ka dalë kjo e gjetur, por kjo ka qenë për ne si risi, por ne si ka dalur ky rekomandim ne e kemi bërë menaxherin e kësaj kontrate dhe lirishtë mundem të ju them se ky rekomandim është i zbatuar.

**Mirsad Shala** - Tek rekomandimi A3 ka të bëjë me palestrën sportive, i nderuar pse ka dalë ky rekomandim nga auditori i jashtëm, po ashtu pse nuk e ka mare një iniciativë drejtoria që të regjistrojë këtë palestër si pasuri komunale, mendoj se drejtoria për kulturë duhet të bëjë një kërkesë me shkrim Ministrisë së kulturës që të bëjë bartjen e kësaj palestre nga Ministria e Kulturës në pronësi të drejtorisë së kulturës.

**Afrim Limani** - Palestra sportive edhe pse është menaxhuar nga komuna e Rahovecit, por pagesa është bërë nga Ministria e kulturës dhe ajo i ka arkivuar ato në ministri. Unë jam dëshmitar që zyrtari për menaxhimin e pasurisë ka bërë kërkesa vazhdimisht që ti jepen një kopje të lëndëve por nuk ju janë dhënë, por më vonë ka arritur që të merë disa dokumentacione sa i përket investimeve që janë bërë në këtë palestër, dhe mendoj se edhe kjo e është kryer dhe nuk do të jetë në raportin e vitit të ardhshëm.

**Skender Hamza** - I nderuari drejtor edhe një e gjetur që është cekur nga auditorët e jashtëm është: Realizimi i aktiviteteve jashtë planit të prokurimit dhe mos njoftimi i AQP-së në lidhje me këto aktivitete. Si rekomandim për kryetarin është dhënë që ai do të sigurojë që do të ndërmerr masat e nevojshme që planifikimi i planit të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitat në mënyrë që sa më pak aktivitete jashtë planit të realizohen, por këta e kanë cekur edhe nëse ka aktivitetet jashtë planit duhet të njoftohet AQP-ja, ata nuk e ndalojnë por thonë se duhet të njoftohen. A ka ardhur kjo e gjetur vetëm pse zyrtarët e zyrës së prokurimit nuk e kanë njoftuar AQP-në sepse si rekomandim më duket shumë i thjeshtë dhe i zbatueshëm.

**Afrim Limani** - Sa i përket këtij rekomandimi ne e kemi një projekt me USAID-in quhet TIME, ku jemi përgjedhur në mesin e 6 komunave si ma të mira ku kemi fituar një donacion për menaxhim më të mirë, pikërisht në këtë që e potencove ti kemi vërejtje edhe në këtë program te USAID-it. Tani nuk e di çka të them se pse ka ardhur deri tek kjo, a është mungesa e koordinimit të aktiviteteve në mes zyrës së prokurimit dhe drejtorisë së financave dhe drejtoreve tjera, për vete unë këtë e kam dëgjuar për herë të parë sinqerisht po ju them, por nuk e kam ditur se çdo gjë duhet të jetë e planifikuar nga zyra e prokurimit. P.sh. nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve paguhen shërbimet e Caritasit ose kompania që merret me mirëmbajtje dhe pastrim e di që duhet të jetë në planin e prokurimit, por kontratat me vlera të vogla nuk e kam ditur që duhet të jetë e planifikuar këtë tani e kemi mësuar.

**Sead Rama** - Të nderuar anëtar të Komitetit për Auditim me kaq përfundon mbledhja e këtij komitetit, ju faleminderit për pjesëmarrje dhe për angazhimin tuaj në këtë takim, shihemi në takimet e radhës.

#### 4. Seanca e Katërt

Është mbajtur më 13.10.2020 me këto pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm në Drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike Komunale;
4. Të ndryshme.

Të pranishëm ishin: Sead Rama kryesues, Fllanza Popaj anëtar, Sehad Boshnjaku anëtar, Skender Hamza anëtar, Mirsad Shala anëtar, Binak Kryeziu Drejtor i Njësisë së Auditimit. Në këtë takim ishin prezent Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani, Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm z.Artan Asllani, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike Komunale, z. Përparim Krasniqi.

Në këtë takim kanë diskutuar; Sead Rama, Kryesues i Komitetit, Fllanza Popaj, Anëtar i Komitetit, Sehad Boshnjaku, Anëtar i Komitetit, Skender Hamza, Anëtar i Komitetit, Mirsad Shala, Anëtar i Komitetit, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani, Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm z.Artan Asllani, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike Komunale, z. Përparim Krasniqi.

Objektivat e këtij auditimi janë: Inkasimi dhe realizimi i të hyrave nga qiraja dhe veprimtaria afariste, taksat dhe ngarkesat vjetore për ushtrimin e afarizmit për subjektet juridike, dhënia në shfrytëzim të pronës komunale, taksa mujore dhe menaxhimi, evidentimi dhe mirëmbajtja e pasurisë.

Fushëveprimi i auditimit është gjashtëmujorëshi i dytë i vitit 2019 dhe periudha janar – maj e viti 2020, duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me identifikimin e të hyrave, regjistrimet, evidentimet, pagesat dhe barazimet. Kurse objektivat e këtij auditimi janë: Inkasimi dhe realizimi i të hyrave nga qiraja dhe veprimtaria afariste, taksat dhe ngarkesat vjetore për ushtrimin e afarizmit për subjektet juridike, dhënia në shfrytëzim të pronës komunale, taksa mujore dhe menaxhimi, evidentimi dhe mirëmbajtja e pasurisë. Kalojmë tek rreziku, në kontrolllet e brendshme nga menaxhmenti në lidhje me buxhetin dhe financat mund ta ekspozojmë komunën ndaj rreziqeve dhe gabimeve të pa ndërprrera. Reziqet të cilat ju ekspozohen drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim janë: Mos mbajtja e regjistrat të plotë të pasurive, mos themelimi i komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive, që të mos ketë procedura formale për shlyerjen e pasurive, regjistri i pasurisë nuk i përfshin të gjitha pasuritë, nuk është bërë amortizimi, tjetërsimi i pasurive, mos ofrimi i dokumenteve për dëshmi nga zyra e prokurimit dhe zyrtari i pranimit për të bërë regjistrimin e aseteve, mos mbajtja e regjistrat gjithëpërfshirës dhe të përditësuar të pasurive, mos mbajtja e regjistrave adekuat kontabël për pasurit fikse, mos realizimi i të hyrave nga qiraja, mos harmonizimi dhe barazimi i të hyrave, mos funksionimi i Sistemit të kontrollit të brendshëm i të hyrave nga qiraja, mos Identifikimi dhe regjistrimi i pronës, mos lidhja e Kontratave. Do të diskutojmë sa i përket regjistrimit të pasurive kapitale dhe jokapitale, tek çështja A1 vlerësimi i pasurisë në pajtim me rregulloren, nuk kemi të gjetura në këtë fushë. Kalojmë tek tjetërsimi i pasurisë financiare, çështja A2, mangësitë e tjetërsimit të pasurisë jo financiare. Të gjeturat Në bazë të vendimit të Kryetarit nr. 700 të datës 20.05.2020 është formuar komisioni për regjistrimin e pasurive të pa përdorura. Sipas raportit të komisionit Nr. 1767 të datës 03.06.2020.

Komisioni gjatë regjistrimit të pasurisë të pa përdorura në tri (3) shkolla ka konstatuar se numri i tyre është i madh dhe janë gjithsej 822 artikuj që janë jashtë përdorimit. Në bazë të vendimit të Kryetarit nr. 02/088/2019 të datës 24.10.2019 është formuar komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiare.

Sipas raportit të komisionit NR. 3861 të datës 12.12.2019. Nga inventarizimi nën 1000€ në Administrata Komunale janë evidentuar 111 asete jashtë përdorimit, në QKMF-në janë evidentuar 19 asete jashtë përdorimit dhe në Objekte Shkolllore ishin evidentuar 682 asete jashtë përdorimit. Konkluzioni për këtë është: Mos bartja e pasurive të pa përdorura në depon ekzistuese, vështirëson identifikimin e saktë të pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, humben apo tjetërsohen. Rekomandimi-1, Rekomandojmë që Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm të funksionalizoj depon, të gjitha pasurit të pa përdorura të vendosën në depo, në një afat sa ma të shkurtër.

Kalojmë tek Inkasimi dhe realizimi i të hyrave nga qiraja dhe nga veprimtarit afariste të biznesit. Çështja -2, Mangësi në Planifikimin, regjistrimin dhe realizimin e të hyrave, të gjeturat e kësaj janë: Plani i inkasimit të të hyrave nga taksat dhe ngarkesat vjetore për vitin 2020 ishte në vlerën 163.600,00€, në periudhën Janar-Maj të vitit 2020, ka inkasuar të hyra në vlerë 41.589,81€ apo 25.42% të buxhetit të planifikuar. Nuk kishte trend të rritjes ndaj planifikimit, si rezultat i mos angazhimit të mekanizmave për inkasimin e të hyrave. Konkluzioni i kësaj është: Performanca jo e mirë e realizimit të të hyrave sipas planit vjetor ndikon negativisht në aspektin buxhetor të komunës e po ashtu edhe në mos realizimin e objektivave të Drejtorisë. Planifikimi jo i drejt rrit rrezikun e humbjes apo edhe keq përdorimin e parasë së gatshme. Rekomandim nr.2 Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të sigurojë se performanca e mbledhjes së të hyrave monitorohet dhe rishikohet në mënyrë sistematike.

**Sehad Boshnjaku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, së pari mendoj se kjo drejtori ka një rëndësi shumë të madhe për komunën tonë sa i përket inkasimit, nuk jam i kënaqur aspak me raportin e auditorit sa i përket kësaj drejtorie. Sipas rekomandimit të parë Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim duhet të funksionalizoj depon, pyetje ime për drejtorin është: A keni depo për vendosjen e aseteve që janë jashtë përdorimit, nëse nuk keni ku jeni duke i mbajtur këto asete, propozimi imë kishte me qenë që kjo depo të jetë tek ish bufeja e komunës.

**Fllanza Popaj** - Përshëndetje për të gjithë, desha të ndërlidhem edhe unë sa i përket depove, në bazë të vendimeve të mara për caktimin e komisioneve për regjistrimin dhe tjetësimin e pasurive ceket se depoja ekziston, por asetet nuk janë në këtë depo.

**Artan Asllani** - Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, zhvillim dhe turizëm – Përshëndetje për të gjithë, të nderuar me vendim të kryetarit të komunës është caktuar depoja në komunën tonë për materialet që janë jashtë përdorimit, kjo depo është në katin përdhese të komunës, pra tek ish bufeja. Kurse sa i përket aseteve që janë jashtë përdorimit dhe bartja e tyre nuk është bërë në këtë depo mundem të ju tregojë arsyen. Komisioni për regjistrim të aseteve nuk e ka për detyrë të bëjë bartjen e aseteve, këtë e ka për detyrë drejtoria për administratë ose mundemi të themi secila drejtori, të gjithë ata që kanë ndonjë ndryshim të aseteve duhet të lajmërojnë komisionin që të bëjë regjistrimin ose çregjistrimin e aseteve, pasi të bëhet kjo çdo zyrtar asetet e vjetra jashtë përdorimit i lënë nëpër korridore.

**Binak Kryeziu** – Auditor, Drejtori e ceku shumë mirë se depoja ekziston, por asetet e komunës gjenden nëpër korridore apo zyre, kishte me qenë mirë që të formohet një grupe punues dhe të bartin këto asete në depo, sepse kur vinë për auditim auditorët e jashtëm do ta theksojnë këtë çështje.

**Artan Asllani** – Më vije mirë që z. Binak Kryeziu e pranoi që sado që ne formojmë ne komisione për bartje nuk do të bëjmë asgjë sepse komisioni nuk e kryen këtë punën e bartjes sepse nuk është kompetenca e tyre, po ju informoj se disa inventarët janë bartur si karika dhe disa banka, pra ato që kanë pasur mundësi vetë të i bartin, poashtu kemi zhvilluar procedura për ankand për disa asete që kanë qenë nëpër tre shkolla, shpresojmë se do të kemi të interesuar.

**Fllanza Popaj** – I nderuar drejtor në raport ceket se ende ka asete që janë nëpër korridore të komunave, besoj se edhe këto asete munden të kapen dhe të dërgohen në depo, poashtu kishte me qenë mirë që ju si drejtori të cakttoni një staf nga punëtorët e drejtorisë suaj që të bartë këto asete nga korridori, e jo të na vije si e gjetur për çdo vit.

**Sead Rama** – Sa e kam vërejtur unë ka asete nëpër zyre të komunave që janë në emër të një zyrtari tjetër, kurse përdoren nga një zyrtar tjetër në zyre tjetër, mendoj se kjo është dashur të bëhet një herë dorëzim pranimi e pastaj të merret në përdorim ai aset.

**Atan Asllani** – Të nderuar ne nuk mundemi me e krye këtë si drejtori e ekonomisë, ose nuk mundem të i detyroj punëtorët e drejtorisë sime për këtë sepse për bartje të tyre duhet edhe fuqi njerëzore poashtu edhe transport, prandaj kam kërkuar fuqi punëtore nga drejtoria për administratë.

**Afrim Limani** – Përshëndetje për të gjithë, edhe pse sot jam si nikoqir i juaji, por në cilësinë e Drejtorit të Financave kam edhe obligim që të jem pranë jush, poashtu falënderoj edhe auditorin e brendshëm, përmendimin time është një raporte shumë i mirë dhe i përgatitur në mënyrë profesionale. Ajo që dua të them është se ju si komitet në fund do të vini me konkluzione dhe rekomandime se çka duhet të ndërmerr drejtoria e auditor për një të gjetur nga auditori i brendshëm, në mënyrë që auditimi i njëjtë që mos të përsëritet.

**Fllanza Popaj** – Kishte me qenë mirë që drejtorët të cilat ju kanë audituar drejtorit të na sjellin një informatë ose raporte se çka kanë ndërmarrë ata rrëth të gjatuarve që i kanë dalë në raport të aludimit, pra cilat masa do të ndërmarrin ose kanë ndërmarr ata që të përmirësohen këto rekomandime.

**Sehad Boshnjaku** – I nderuar drejtor z. Afrim Limani si mundet të vazhdohet kontrata qiradhënësve të cilët nuk kanë qenë stabil në pagesat e qirasë, pra qiramarrësi ka borxh komunës por komuna përsëri po ja vazhdon kontratën.

**Afrim Limani** – I nderuar pajtohem plotësish me ju atë që e thatë, ky është edhe rekomandim edhe nga auditori i jashtëm, por unë e thashë atë me qëllim që mos të ju mundoj juve dhe për të gjitha këto drejtori ka biseduar me drejtorin para se të bëjë raportin final. ajo që pritet nga ne është se si të i gjejmë ne hapat që të eliminohen këto dobësi ose të gjetura.

**Skender Hamza** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmëve, sa i përket asaj që e tha edhe kryesuesi i komitetit që të lirohen nga ngarkesa zyrtarët të cilët nuk i përdorin më ato asete, ose nëse ato asete i përdor dikush tjetër por janë në emër të dikujt tjetër. Mendoj se kjo është pak më problem sepse kemi raste kur një zyrtar ja jep një zyrtari tjetër në huazim për të përdorur një printer, dhe në ato momente komisioni për regjistrim të aseteve shkon dhe ja gjen ne zyre dhe e regjistron aty ku e ka parë, pastaj këtu linin ato problemet e mos përpunjës.

**Fllanza Popaj** – I nderuar edhe pse ti atë printer e ke dhënë përkohësisht ajo duhet të ceket në procesverbal që është përkohësisht këtë drejtori përkatëse dhe besoj se me këtë do të sqarohej gjithçka. Sa i përket rekomandimit nr.6, realizimi i të hyrave për bizneset për taksat afariste, jemi duke parë që ka pasur shumë pak të hyra dhe për këtë nuk duhet themi shkaktar pandemia sepse faturat shpërndahen deri në muajin shkurtë. Mendoj se buxheti është dashur të ritet më shumë se sa është planifikuar nëse ka pasur vonesa në pagesë sepse ka edhe kamata nëse nuk e paguan me kohë. Propozoj që drejtoria ta zbatoj vendimin ashtu siç e kanë të përcaktuar me ligje dhe rregulloret në fuqi.

**Artan Asllani** – Është bërë një gabim sepse unë kam pasur një afat kohorë që ti përgjigjem auditorëve për të gjeturat që i kanë gjetur në drejtorin e ekonomisë, tanë s'mundemi të bëjmë më asgjë sepse kjo ka ndodhur. Por ajo që dua të diskutoj është se si kanë mundur të qesin si e gjetur mos realizimin e të hyrave, kur e kanë të cekur se kemi mbi 120% të të hyrave brenda vitit, ne çdo muaj e kemi tejkaluar planifikimin e të hyrave. Ka edhe shumë të gjetura që janë cekur në këtë raporte që nuk janë ashtu siç e kanë cekur këta sepse ka afate kohore që janë të përcaktuar me ligje dhe rregullore.

**Fllanza Popaj** – A mundeni edhe një herë të i rishikoni kontratat, pra të shikohet se nga cilat kontrata nuk janë inkasuar të hyrat, kur të bëhet identifikimi i tyre të dërgohen tek përmbaruesi.

**Sead Rama** – me procedurë është pas 45 ditëve ke të drejtë të paraqesësh tek përmbaruesi.

**Artan Asllani** – Sa i përket obligimeve për qira, për herë të parë vitin e kaluar kemi zhvilluar procedura vitin e kaluar edhe këtë vite, lajmi mirë është se kur është bërë auditimi tek saldoja kanë qenë dikur rrëth 30,000.00 €, sot si drejtori për herë të parë kemi arritur që borxhet të i zgresim deri në 15,000.00 €. Me ata që nuk kemi mundur të mëremi veshë lënda ka shkuar tek përmbaruesi dhe deri më tanë gjërat janë duke shkuar shumë mirë.

**Skender Hamza** – Pak më parë drejtori z. Afrim Limani shumë mirë e ceku por edhe unë po e ceki edhe një herë, i nderuar drejtor Asllani, këto informata që na i paraqite neve tanë, a ja keni dhënë edhe auditorit para se të hartojë raportin final, pra a keni pasur së paku ndonjë takim sepse sa e dimë ne para se të hartohet raporti final nga auditori i brendshëm, ju keni një afat kohorë për përgjigje në të gjeturat.

**Binak Kryeziu–** I nderuari z. Hamza e patë shumë me vend, ne kur ta kryejmë auditimin e kemi si draft raporte ku dhjetë ditë kanë afat pastaj drejtorit e audituara që të jatin komente në ato të gjetura, drejtori në këtë rast nuk na ka dërguar asnje koment. Pasi nuk na ka ardhur asnje koment atëherë ne kemi menduar se është pajtuar me ato të gjetura dhe raporti është bërë final.

#### **Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike Komunale.**

Qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit, Fushëveprimi i auditimit është periudha (Janar – Korrik) të vitit 2020, duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me: Identifikimin e të hyrave, regjistimet, evidentimet, pagesat dhe barazimet.

Objektivat janë: Menaxhimi i Projekteve, inkasimi dhe Realizimi i të hyrave vetanake, taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapsires publike për kryerjen e veprimtarisë së tyre, subjektit afariste të regjistruar, taksat për vendosjen e objekteve të përkohshme (Baraka, kioska etj). Taksat për dhënie me qira të hapësirës publike dhe aseteve nëntokësore për shfrytëzimin. Konkluzioni: Mos kordinimi i dy drejtorive, rrit rrezikun që komuna të ketë një performance të dobët në mbledhjen e të hyrave dhe mos realizim të projekteve që priten të financohen nga këto të hyra, si dhe rritjen e vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme të komunës.

**Rekomandimi:** Rekomandojmë që Drejtoria për punë inspektuese të i zbatoj vendimet e Drejtorisë të Shërbimeve Publike, në bazë të ligjeve në fuqi.

Menaxhimi i Projekteve. Tek menaxhimi i projekteve janë pesë faza të menaxhimit të projekteve: Faza e definimit, faza e planifikimit, faza e organizimit, faza e kontrollit, faza e përfundimit.

Konkluzioni: Mungesa e verifikimit të çmimeve në treg ndikon në rritjen apo uljen e shumave në paramas dhe paralogari të parashikuar dhe dakordimi i tyre me sasitë e kontraktuara, rrisin rrezikun e tejkalimit të pozicioneve të parapara në kontratë.

**Rekomandimi:** Rekomandojmë që në paramas dhe paralogari të kontraktuar të parashikohet çmimi sipas konkurrencës në treg. Kjo ishte e tjera sa i përket raportit të auditimit në Drejtorin e Shërbimeve Publike, nëse keni dikush ndonjë rekomandim ose ndonjë sugjerim fjala është e juaja.

**Fllanza Popaj –** Sa i përket raportit të drejtorisë së shërbimeve publike, pashë që shumica e punëve dhe kontratave ishin të lidhura edhe me punën e inspektoratit, është dashur që edhe drejtoria e inspektoratit të jetë këtu prezentë, që ti dogjën edhe ata vetë këto të gjetura. Sepse një arsyje ishte se për shkak që ka nderuar jetë një inapektor nga Covid – 19, shumica e punëve nuk janë kryer sepse ka qenë në detyrën e tije, mendoj se inspektor ka mjaftë dhe është dashur dikush të caktohet që të zëvendësojë këtë inspektor në mënyrë që të kryhen punët e gjysmë të mbeturë.

**Sead Rama –** Ajo që ja vlen të cekët është se, nga të gjitha mbledhjet që i kemi pasur këtë vite dhe nga të gjitha raportet a audituara që na kanë ardhur, i vetmi raport që ka të gjetura më pak dhe ato të gjetura që janë, janë më të vogla në krahasim me drejtoritë e tjera edhe pse ka vend përmirësimë.

**Përparim Krasniqi –** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, më vije shumë mirë që për herë të parë një raporte ka kaq shumë pak të gjetura dhe ai raporte është nga drejtoria ime. Do ju japë disa sqarime që janë shumë të domosdoshme për ju, drejtoria e shërbimeve publike sidomos tek taksat e të hyrave lidhet shumë me drejtorin e inspektoratit, ne si drejtori të gjitha dokumentacionin që kërkojnë kompanitë për shfrytëzimin e hapësirave publike ose objekte të pakohshme, ne si drejtori i ndjekim me rregulla dhe me afat të gjitha. Por puna na ngelet tek drejtoria e inspektoratit sepse nuk e zbaton vendimin, kur ne kërkojmë mbylljen e një objekti të përkohshëm atëherë drejtoria inspektuese duhet të dërgoj tek kompania për demolim ose largimin. Sa i përket menaxhimit të projekteve e pashë që është bërë një gabim në raporte edhe pse ne ja kemi kthyer komentet brenda 10 dite, këtu janë cekur dy kontrata që nuk kanë të bëjnë me drejtorin e shërbimeve publike.

**Mirsad Shala –** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do ja nisi nga fillimi, tek parathënia janë disa ligje dhe rregullore të cilat janë të shfuqizuara, pra nuk janë më në zbatim, nuk e di a është gabim teknik apo njësia e auditimit të brendshëm nuk e ka marr parasysh. Ligji i procedurës administrative 02L/28, është shfuqizuar,


tani kemi ligjin e ri, pastaj Rregullorja për vendosjen e objekteve komunale e kemi te renë e cila është aprovuar në vitin 2014, pastaj ligji për menaxhimin e financave publike 02 L-16 është i shfuqizuar, është mirë që të shikohen këto ligje dhe rregullore. Përgëzoj drejtorin për raportin i cili i ka dalë ndër raportet më të mirë që kemi pasur deri më tani.

**Skender Hamza** – I nderuar kryesues mendoj se rekondimi dytë që ceket në këtë raport të jetë edhe si rekondim i ynë si Komitet i auditimit për drejtorin e inspektoratit, ajo që më bije mua më shumë në sy është taksa për demolim dhe gërmim të rrugëve. Shumë shpesh ne jemi duke parë që qytetar të ndryshëm bëjnë demolim të rrugëve, këta qytetar a marrin ndonjë leje në komunë apo jo, prandaj mendoj se puna e inspektorëve në teren është që të verifikojnë këta qytetar nëse nuk kanë leje atëherë të i gjobisin, e ceste sepse kjo e gjetur nuk duhet të jetë në drejtorin e shërbimeve publike, por në drejtorin e inspektoratit.

Shtojcë; të bashkëngjitur gjeni katër procesverbalet e seancave të mbajtura të Komitetit të Auditimit.

Rahovec, 11.03.2021

Sead Rama, Kryesues i Komitetit të Auditimit





Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.04.2020 miraton këtë:

### V E N D I M

#### **Për bartjen e rezervave të investimeve kapitale**

1. Miratohet vendimi për bartjen e mjeteve rezervë në kuadër të investimeve kapitale në shumën prej **265,000.00€** (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë euro).
2. Mjetet rezervë të cekura në pikën 1 të këtij vendimi dë të barten si në vijim si në vijim:

**2.1.Në programin Shërbimet Publike (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).**

2.1.1.Ndërtimi i kanalit për ujëra atmosferik dhe ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni në fshatin Zatriq, Grandi (10) në shumën prej **34,000.00€**.

Të hyrat vetanake (21) në shumën prej **20,000.00€**.

**Gjithsej: 54,000.00€**

**2.2.Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360), kodi funksional (0620).**

2.2.1.Ndërtimi i shtratit të përroit në lagjen Kelmendi në Kramovik, Grandi (10) në shumën prej **6,000.00€**.

Të hyrat vetanake (21) në shumën prej **65,000.00€**.

**Gjithsej: 71,000.00€**

**2.3.Në programin Shëndetësi (737), nën programi Shëndetësi (73700), kodi funksional (0721).**

2.3.1.Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec, Grandi (10) në shumën prej **140,000.00€**.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

01 Nr.       /21  
Datë: 29.04.2021

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



**Komuna Rahovec**  
**Opština Orahovac/Municipality of Rahovec**



Date/Datum/Date:	21.04.2021
Për/Za/To:	<b>z.Afrim Dina: Kryesues i Kuvendit të Kuvendit Komunal Rahovec</b>
Përmes/Preko/Through:	<b>z.Smajl Latifi: Kryetar i Komunës</b>
Nga/Od/From:	<b>z. Afrim Limani: Zyrtar Kryesor Financiar</b>
Subjekti/Predmet/Subject:	<b>Propozim për bartjen e rezervave të Investimeve Kapitale</b>

**Të nderuar,**

Me anë të kësaj shkresë po ju dërgojmë bartjen e mjeteve rezervë në kuadër të investimeve kapitale në shumën prej **265,000.00**

**1. Në programin Shërbimet Publike (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).**

1. Ndërtimi i kanalit për ujëra atmosferik dhe ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni në fshatin Zatriq, Grandi (10) në shumë prej **34.000.00 €.**

Te hyrat vetanake (21)në shumë prej **20.000.00 €.**

**Gjithsej: 54,000.00**

**2. Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360), kodi funksional (0620).**

1. Ndërtimi i shtratit të përroit në lagjen Kelmendi në Kramovik , Grandi (10) në shumën prej:**6000.00**

Te hyrat vetanake (21)në shumë prej **65.000.00 €.**

**Gjithsej: 71,000.00**

**3. Në programin Shëndetësi (737), nën programi Shëndetësi (73700), kodi funksional (0721).**

1. Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së, Rahovec, Grandi (10) në shumën prej:**140,000.00**

**Ju faleminderit**

---

**KOMUNA E RAHOVECIT**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënieve në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë:29.04.2021 merr këtë:

**V E N D I M**  
**Për dhënen në shfrytëzim afatshkurtër**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës 02 Nr. 293/21 i datës 08.04.2021 dhe merret vendimit paraprak për dhënen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur Przhina e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-05864-0 në emër të Komuna e Rahovecit, me kulturë Arë i Klasës 5, në sipërfaqe të përgjithshme prej  $2031\text{ m}^2$  (dy mijë e tridhjetë e një metra katror).
3. Qëllimi i dhënieve në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe dhënia e mundësisë qytetarëve për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen.
4. Afati kohor për dhënen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej \_\_\_\_\_ vite.
5. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/2020 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
7. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

#### KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr- \_\_\_\_/21  
Me datë: 29.04.2021

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
Opština Rahovac/Municipality Rahovac  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor  
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 293 Nr. i faq/Br.str./No.pg 194  
Data/Datum/Date 8 / 4 / 2021  
RAHOVEC / GRAHOVAC



